

Bashkia Shkodër  
Biblioteka “Marin Barleti”

# Gegnia

*e përkohshme kulturore-artistike*

17 - 2022  
Vjeti VII i botimit,  
Shkodër

**Gegnia**

E përkohshme kulturore-artistike

17-2022

Vjeti VII i botimit,

Shkodër

**Redaksia:**

Maxhid Cungu, Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija

**Redaktor gjuhësor:** Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e Bashkisë Shkodër  
dhe Bibliotekës “Marin Barleti”**

**ISSN: 2519-73-91**

**Adresa e redaksisë:** Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

**E-mail:** info@bashkiashkoder.gov.al

info@bibliotekashkoder.com

**Shënim:** *Pikëpamjet e artikullshkruesve nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

## Përmbajtja

### ▪ Albanologji ▪

#### **Ernest MARKU**

Modeli fishtjan i angazhimit politik dhe atdhetar ..... 5

#### **Rafaela MARTETA**

Shantoja, prijës i opinionit publik ..... 30

#### **Arben PRENDI**

Lazër Shantoja publicist, prijës i opinionit publik ..... 34

#### **Alfred ÇAPALIKU**

Rimari i poetit Kolë Thaçi ..... 41

### ▪ Trashëgimi kulturore ▪

#### **Eduard GRISHAJ**

Kanuni, ligji i pashkruar i maleve ..... 47

#### **Gëzim H. JUKA**

Një monument i munguar për tre klerikë patriotë ..... 58

### ▪ Histori ▪

#### **Hamdi BUSHATI**

Lufta e Koplikut (1920-1921) (*Kujtime*) ..... 69

### ▪ Histori arsimit ▪

#### **Dr. Nikollë LOKA**

Hapja e internatit “Mirdita” në Orosh si nevojë e kohës ..... 78

#### **Bora LOGU**

Një pjesë historie e rëndësishme në fillimet  
e shkollës shqipe në Shkodër ..... 83

#### **Dieleta PERLLESHI, Ermira ALIJA**

Indoktrinimi i arsimit gjatë regjimit komunist. Tekstet  
e leximit të tetëvjeçares (1964-1986) në funksion të  
edukimit politik të nxënësve ..... 87

**▪ Letërsi ▪****Xhuljana GURI**

Poezi ..... 92

**▪ Projekti “Nxitja e talenteve tek të vegjlit” ▪**

Poezi ..... 102

**▪ Arkiv ▪**

Filip Kraja (1857-1933) Nji ba-mirs i harrum ..... 104

**▪ Bibliografi ▪****Olimpia KAKARRIQI**Bibliografi e librave të digjituara në fondin e librit të rrallë  
(Biblioteka e Universitetit “Luigj Gurakuqi”) ..... 106**▪ In memoriam ▪****Maxhid CUNGU**

Një vit pa Eduard Grishajn ..... 154

**Arben PRENDI**

Eduard Grishaj- profil i njeriut dhe studiuesit ..... 157

**Zenepe DIBRA**Jetëshkrimi i dr. Artan Boriçi (*vijon nga numrat e mëparshëm*).. 160**▪ Kronikë ▪****Maxhid CUNGU**Veprimtari të zhvilluara nga Biblioteka “Marin Barleti” gjatë  
periudhës dhjetor 2021- maj 2022 ..... 176

▪ Albanologji ▪

Ernest MARKU

**MODELI FISHTJAN I ANGAZHIMIT POLITIK DHE  
ATDHETAR**

Modeli fishtjan i angazhimit politik dhe atdhetar, në fakt, asht forma ma e koncentruar e mendimit të fretërve françeskanë, që do të kulmonte me Fishtën, por që do të përshfaqej edhe në aktivitetin politik e publik të plot figurave të tjera, si: Gjeçovi, Harapi, Palaj, Prendushi e deri tek Ernest Koliqi. Kjo trajtesë nis me Gjergj Fishtën si anëtar të Akademisë Mbretërore Italiane, duke vazhduar më tej me traditën e këtij mendimi te Anton Harapi si anëtar i Këshillit të Regjencës gjatë pushtimit gjerman dhe Koliqin dy herë Ministër të Arsimit; për t'u kthyer pastaj te rrënjët kulturore, shpirtërore dhe të traditës, që e krijuan, frymëzuan dhe konsoliduan këtë qëndrim, i cili mbështetet në një rregull të thjeshtë por mjaft fisnik: *“Të kontribuojmë për atdheun, në çdo kohë apo rrethanë, pa u shqetësuar për dëmin që mund t'i sjellim emnit dhe dinjitetit tonë personal”*.

Duket një e vertetë e thjeshtë për t'u kuptuar, por mjaft e vështirë për t'u besuar, nëse nuk do të kemi parasysh rrethanat në cilat ndodhej Shqipëria, shteti dhe shoqëria shqiptare, në gjysmën e parë të shekullit XX; por edhe karakterin, organizimin dhe veprimtarinë e françeskanëve shkodranë dhe të shkollave që ata hapën dhe administruan. Daniel Gjeçaj, Benedikt Dema, Pashko Bardhi, Pal Dodaj, Donat Kurti, Viktor Volaj e plot të tjerë, hedhin grimca drite në drejtim të evidentimit të

kësaj teze, të cilat, po të analizohen me kujdes, mund të përmbyllin “pazëllin” dhe të konsolidojnë mendimin për këtë model të angazhimit politik. Nga ana tjetër, duke studiuar më me hollësi natyrën e edukimit të Fishtës, rrafshin social dhe historik në të cilin u formua dhe krijoi personalitetin e tij, sidomos duke u mbështetur në të dhënat që sjell studiuesja Blerina Suta, për periudhën e jetës rinore të tij, kur ishte me studime në Bosnje; mund të kuptojmë ndikimin e Fishtës, në mes mes të fretërve më të shquar që ka pasur ndonjëherë Shqipëria. Vështirë të ndahet se kush ndikoi më tepër te kush: Fishta te fretërit e tjerë, apo ata te Fishta; por një gja asht e sigurt, si do të shprehej edhe Daniel Gjeçaj se: *“Fishta dhe fretërit, ishin një e të pa ndamë”*.

Gjithashtu edhe analizimi i kujdesshëm i veprës së Fishtës, i mesazheve që fshihen apo përshfaqen aty, na ndihmon akoma më tepër që të mbrojmë tezën e shprehur që në krye të këtij punimi. Jo vetëm te *“Lahuta e Malcis”*, por edhe te *“Mrizi i Zanave”*, te veprat satirike dhe sidomos te publicistika e tij, gjejmë mjaft shkëndija të këtij mendimi filozofik, sa vetëmohues e fisnik, aq edhe të pazëvendësueshëm për historinë Shqipërisë; i cili mund të buronte vetëm nga një mendje e një zemër plotësisht e përkushtuar ndaj trinomit: *“Për fe, atdhe e shpirt poetik”*.

### **Fishta akademik**

Viti 1939 për të gjithë patriotët shqiptarë, ishte një vit i vështirë. Më 7 prill, siç dihet, trupat italiane zbarkojnë në Shqipëri; pas pak ditësh, aq sa bën tanku të shkojë nga kufiri në kufi, vendi ynë ishte pushtuar plotësisht nga trupat fashiste të Musolinit. Më 12 prill, përfaqësuesit e dhjetë prefekturave të vendit tonë, u thirrën në Tiranë, për të legalizuar pushtimin “de facto”. Në këtë moment kritik për Shqipërinë, vetëm delegacioni i Shkodrës, ku bënë pjesë dhe kishin ndikim françeskanët, ngritën zërin kundër pushtimit fashist dhe kërkoi atë që vetë Musolini kishte premtuar: ndihmë ushtarake, por jo pushtim me trupa. Rrëzimi i Zogut nga pushteti dhe pushtimi i Shqipërisë, ishin dy çështje krejt të pavarura dhe nuk kishte pse njëra të kushtëzonte tjetrën. At Anton Harapi, jo nga mendja e vet, por i konsultuar me ipeshkvijt e Shqipërisë, me Fishtën dhe fretërit e tjerë; - shprehet Gjeçaj<sup>1</sup>, kërkoi fare qartë: *“Independencen absolute të Shqipërisë, me flamur të vet të paprekun, me*

<sup>1</sup> Gjeçaj, Daniel; *“Gjergj Fishta, jeta dhe vepra”*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2007, f.156.

*gjuhë, shkolla e zhvillim arsimuer; me administratë shtetnore të veten, ushtarake e civile; me perfaqsi para shteteve të hueja e me gjithshkaf asht në natyrë të një shteti e të një kombi Sovran, me racë, gjuhë, histori, tradicion e tagre të veta*". Dhe pikërisht ky frat trim, do të dënohej me vdekje nga diktatura më 1946, për tradhëti ndaj atdheut. Vlen të theksohet edhe një fakt tjetër; kur këshilli drejtues i françeskanëve, në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme, mbledhje në të cilën Fishta zinte gjithnjë kryet e vendit; mori vendim të dërgonte Harapin në Tiranë, duke e autorizuar për kërkesat e cituara më sipër, mori edhe një vendim tjetër të guximshëm: Nëse për shkak të fashizmit, ka për t'u shkrire krejt Provinca Françeskane e Shqipërisë dhe fretërit shqiptarë do të largoheshin nga toka e të Parëve; le të ndodhë, por në fushën e luftës dhe të mos na mbesë asnjë njollë tradhëtie në historinë e lavdishme të shtatë shekujve punë e sakrifica, në dobi e për të mirë e kombit shqiptar. Mirëpo, koha tregoi se nuk ishin të huajt, por bolshevikët shqiptarë, ata që do ta shkatërronin Provincën Françeskane Shqiptare. Edhe në këtë rast fretërit nuk e turpëruan emrin e tyre, duruan çdo torturë por nuk i tradhëtuan as vëllezërit, as idealin e tyre; vdiqën ashtu siç kishin vdekur të Parët e tyre, me besimin në Zot dhe me Shqipërinë në gojë.

Më 3 qershor 1939, Fishta emërohet anëtar i Akademisë Italiane. "*Që në këtë emnim, - shprehet Gjeçaj, - të jenë mëshehë qëllime politike, asht ma se e gjashme*"<sup>2</sup>. Por do të ishte gabim të mendohej se politika ishte i vetmi motiv; Fishta u emërua anëtar i forumit më të lartë akademik të Italisë, për vlerat e jashtëzakonshme të veprës së tij, pasqyrë e gjallë dhe përqsaje autentike e racës dhe gjenisë shqiptare. Fishta nderohej e respektohej në Itali, edhe para vitit 1939, ndërsa, për të treguar se sa e vlerësuan akademikët italianë, për talentin e tij të rrallë, për kulturën e gjerë dhe zgjuarsinë e kultivuar, dëshmon fjala e Presidentit të Akademisë Italiane, Luigi Federzoni, i cili, ndër të tjera thotë: "*Në një kohë, mjerisht të shkurtër, gjatë së cilës At Gjergj Fishta, ishte pjesë e Akademisë Mbretërore të Italisë; ai fitoi vlerësimin e të gjithë anëtarëve*".

Vetë Ati i Shenjtë, Papa Piu XII, të cilin, nuk besoj se do ta konsideronte kush fashist, në një audiencë të gjatë që i kushtoi Fishtës, duke e përgëzuar për emërimin e tij si akademik i Italisë, pasi u interesua gjerësisht për gjendjen kombëtare dhe fetare të vendit tonë,

<sup>2</sup> Po aty, f. 157

ndër të tjera i thotë: “ *Emërimi yt si akademik i Italisë, është nderim për Katolicizmin, Urdhnin e Shën Françeskut dhe për Kombin Shqiptar; prandaj, unë si Mëkëmbës i Krishtit në Tokë, kam pse të ndihem krenar prej teje, prej Urdhrit të Françeskanëve dhe prej Kombit tënd*”. Me të njëjtin entuziazëm dhe gëzim, e priti këtë emërim të Fishtës, edhe Gjenerali i Urdhnit Françeskan, At Leonard M. Bello, At Agostin Gemelli, themelues dhe rektor i Universitetit të Zemrës së Krishtit në Milano, për të mos përmendur këtu mjaft personalitete të tjera të Italisë dhe Vatikanit, që nuk kishin asnjë lidhje me fashizmin.

At Daniel Gjeçaj<sup>3</sup>, ka kujtime personale për të treguar, sidomos gjatë kohës kur Fishta udhëtonte për në Itali, me shenjën dalluese të akademikut, një konkardë e vogël dhe e rrumbullakët, me germën “A” në mes. Ai atëherë ishte i ri dhe për më tepër qe ish-nxënës i tij, dhe ruante një nderim e dashuri të pakufishme për Babain e Letrave Shqipe, si dhe për Atin e Provincës Françeskane, së cilës i përkisnin të dy. Ndonëse Gjeçaj druhej t’ia bënte atë pyetje, Fishta e kishte kuptuar dhe i ishte drejtuar me fjalët: “*Këqyr, bir’o, ndoshta ndokush tash apo ma vonë, kur unë s’kam për të mujtë ma me u mbrojtë, ka për të më fajisë për këtë “konkardë” që baj; gjoja - siç thonë Toskët - se unë u jam shitë italianëve, çka do të ishte edhe më zi, se unë jam bërë fashist: Dije se akademitë, edhe pse cilësohen me emën të atij kombi e të asaj qeverie, prej së cilës mbahen; janë gjithnjë e kurdoherë, katedra të përbotshme për dije dhe art. Svedia – shtonte - u ep çmimin “Nobel”, të gjithë dijetarëve e letrarëve, në shenj të botës dhe kurrkush s’thotë se i shpalluni “Nobel” asht ba svedez. Unë, me këtë shenj, që s’asht fashist dhe që për mue ban gërmen fillestare të Albania; sot për sot mund të viej për Shqipëri e Provincë ma fort se me çdo mjet tjetër. Në luftë s’të pëvetë kush se ç’fabrike janë armët, por se si i ke përdorë ato. Për burrë ç’do pushkë asht e mirë, mjaft t’i ndezë baruti; - thotë goja e popullit”.*

E njëjta gjë konfirmohet, pothuajse, edhe nga At Zef Pllumi<sup>4</sup>, i cili në kujtimet e tij për Fishtën, tregon se si kërkesës së At Mëhill Mirajt, Patër Gjergji i përgjigjet pak a shumë kështu: “*Ndigjoni o vllazën e bij të mi. Unë nuk kam ndërrue, por jam ai Patër Gjergj që kam kenë gjithmonë. Ju e dini mirë se sa e kam dashtë un Italinë këtu. Kaq gja*

<sup>3</sup> Po aty, f. 158-159

<sup>4</sup> Pllumi, Zef; “*Françeskanët e mdhaj*”. Botimet Françeskane, Shkodër, 2017. Kur u njoha me Fishtën, f. 13-14



*e kanë kuptue edhe fashistat vetë. Mos mendoni se këtë tillull ma kanë dhanë për me më nderue, por ma kanë dhanë për me më internue. Latinët kanë një aksiomë të vjetër të politikës së tyre: “Promoveatur ut removeatur” (t’i jepet një nderim ma i naltë veç për me e largue). Njashtu si po internojnë shumë shqiptarë tjerë, po duen me ba edhe me mue, përse në bazë të Statutit çdo akademik i ri e ka për detyrë me u sjellë për gjashtë muej tue mbajtë konferenca nëpër institutet e nalta të kulturës. Në këtë mënyrë ata duan punën e vet me e ba e njikohësisht me i hjedhë pluhën syve botës, popullit shqiptar ashtu edhe mue. Unë sot jam i plakun; sëmundja e zemrës më asht randue shumë në këta muejt e fundit. Ato mësimet e mia që ju kam dhanë dikur kishem me dashtë që ju sot t’i shtini n’veprim, ndërsa un nuk jam i zoti me përballue ma as burgun, internimin apo arratinë. Po unë u premtoj ju se kurrë nuk do ta përuli para të huejve rodin e shqiptarit. Me të vërtetë na kanë okupue, si dikur Roma Ilirinë. Por un ndër konferencat e mia do t’ua përsëris italianëve pa ja da se me të vërtetë që Roma dikur e ka pasë namin e madh, por legjionet ilire dhe perandorët e mëdhaj ilirjanë ishin ata që kishin në dorë fatet e Romës. U baj edhe një premtim tjetër se përnji që ato konferenca të kryejnë për gjashtë muej, siç e don rregullorja, unë menjherë do të kërkoj me ardhë në Shqipni”.*

Ndonjë vit më vonë, kur Koliqi kishte marrë propozimin për t’u bërë Ministër i Arsimit, në qeverinë e kryesuar nga Mustafa Merlika (Kruja) siç tregon ai në kujtimet e veta, kishte shkuar të konsultohej me Fishtën për këtë propozim. Patër Gjergji, pa e mbaruar tjetri fjalinë, i kishte thënë: “*Me shkue*”. Mirëpo, Koliqi, i shqetësuar për faktin se si do ta merrnin bashkatdhetarët e tij këtë akt, kërkon një vendim më të pjekur e më të studiuar. Fishta e kishte ndërprerë përsëri, duke i thënë: “*Me shkue, se kushdo tjetër qi t’shkoje, ka per t’ba ma keq se ti ... per shqiptarët!*” Ky është një arsytim që vjen prej një personaliteti, i cili nuk e ndan dot veten nga kombi; ai nuk mund të fshihet e të shpëtojë emrin e vet, sa kohë që kombi ka nevojë për të, qoftë edhe duke sakrifikuar emrin e vet.

Kujtesa popullore ruan edhe një variant të tretë të argumentimit të Fishtës, mbi motivet e pranimit të titullit akademik. Flitet të ketë thanë, pak a shumë: “*N’kyt moshë qi jam, s’mund t’i baj kombit tjetër sherbim, veç se t’i fali një akademik ... Edhe pse e dij se kan me m’sulmue, posaçe ndoj toskë me mendje prej Rusije*”. Ka shumë mundësi që të tre variantet të jenë të vërteta, pasi ky argument ishte temë e bisedave të shumta dhe Fishta kthente përgjigje sipas rastit apo nivelit të atyre

që e pyesnin. Nga e njëjta “shkollë” mendimi vinte edhe Patër Anton Harapi, i cili, disa vite më vonë, kur do të pranonte të bëhej anëtar i Këshillit të Regjencës, do të deklaronte: “*Ma mirë t’thonë: gabove, o Atë! sesa: Ku ishe, o Atë...?*”

“*Fishta si Akademik i Italisë, - kujton Injac Zamputi, - në konferencën që mbajti në kinema Rozafat, për s’e di se çfarë rasti përkujtimor, në vitin e fundit të jetës së tij, e solli fjalën te paralelizmi i pushtimit fashist me pushtimin romak të lashtësisë.*” [...] “*Dhe pati guxim, - vazhdon ai, - të fliste për rezistencën që romakët e lashtë gjetën ndër fiset dhe mbretëritë ilire, deri te kryengritja e organizuar prej Batos.*” [...] “*Të gjitha këto ndodhën, - do të përfundonte Fishta, sipas Zamputit, - sepse ilirët e panë menjëherë, se trupat romake po sillnin robërinë në vend të lirisë, të cilën mburreshin se po ia sillnin botës, bashkë me drejtësinë romake*”<sup>5</sup>. Aluzioni është i qartë. Nuk plasi skandali, por në fytyrat e të gjithëve lexohej habia e madhe për atë guxim. “*Ç’rrjedhim do të kishte pasur, nuk e di, - shprehet ai, - sepse, po në fund të atij viti, Fishta vdiq.*

Se sa *proitalian* ishte Fishta, kuptohet në një relacion<sup>6</sup> të qershorit 1919, të Provincialit Françeskan në Shkodër, Luiggi Paolozzi drejtuar Gjeneralit të Urdhrit në Romë, ku ai ankohet se At Vinçenc Prendushi dhe At Gjergj Fishta, kanë firmosur një protestë të dërguar në Konferencën e Paqes në Paris, kundër një protektorati të mundshëm të Italisë mbi Shqipërinë. Në gazetën e majtë “*Taraboshi*”, që kishte nisur të botohej në Shkodrën e atyre viteve, botohet një reportazh sarkastik, ku flitet për një komision, që ishte ngritur për të mikpritur Jakomonin në qytetin e mirënjohur të Veriut. Pjesë e këtij komisioni ishte edhe Fishta, i cili arrin me vonesë, duke iu kërkuar “ndjesë”, pasi kishte takuar një fshatar nga Reçi që i ishte djegur shtëpia. Ftesës së njërit prej pjesëmarrësve për të aplikuar në bashki për ndihmë, ai i përgjigjet duke shtuar se atij të varfrit, i ishte djegur edhe dhija e vetme; pas shprehjes “*robt shndosh!*”, Fishta u tregon sesi reçasi kishte varrosur edhe të ëmën e djegur. Duke u uruar “suksese” në punët e tyre, poeti u kërkon “leje” të largohet, pasi shpresonte të bënte diçka për atë qyqarin, ndryshe nga komisioni që kishte detyra “ma t’randësishme”.

Familjarët kujtojnë, se në ato vite, italianët ndërtuan rrugën Lezhë-Kallmet-Vau i Dejës. Kjo rrugë ishte kërkuar prej Fishtës, sepse,

<sup>5</sup> Zamputi, Injac; “*Fishta: Koha, Njeriu, Vepra*”, Pasqyra, 1993; f. 33

<sup>6</sup> AGOFM-Storico (Archivio Generale dell’Ordini dei Frati Minori), “Albania 10”, sc. 37, fol. 333 r.

përveçse lidhte Lezhën me Shkodrën nëpërmjet vendlindjes së tij, njëkohësisht bënte lidhjen e kishave katolike ma të randësishme të zonës: Nga Kisha e Fretërve në Lezhë, te Kisha e Kuvendit të Arbrit në Mërqi, Kisha dhe Rezidenca e Ipeshkëvit të Lezhës në Kallmet, Kuvendi i Françeskanëve në Troshan, Kisha dhe Qendra e Ipeshkvisë së Sapës në Nënshat dhe deri në Kishën Vaut të Dejës. Në një rast, në këto kohë, familjarët kujtojnë se një fshatar nga Laç-Qyrsaçi i Vaut të Dejës, njeri me autoritet në krahinë, kishte ardhur të ankohej te Patër Gjergji, pasi italianët po i thyenin tjegullat e shtëpisë, gjatë plasjes së minave për hapjen e rrugës. Fishta, i cili po merrej me një vepër letrare, ndoshta me *“Mbretneshen e Lulevet”* si e pa se ç’hall kishte fshatari, i kthehet me të ashpër: *“Hik pa merak se italjant tash t’i paguejnë tjegllat e shpisë një m’nji, po ti kqyr e merru me mdoj punë tjeter, se ata nuk janë administrata e Zogut.”*

Gjithë këto kujtime, dokumente apo dëshmi, i solla për të treguar sa më qartë se kush ishte Fishta, çfarë raporti kishte ai me italianët, Romën, Vatikanin, papët, françeskanët apo edhe me Duçen, Jakomonin, Çianon apo Melonin.

### **Rënjët e këtij modeli fishtjan**

*“Ndeja në Bosnje edhe edukimi fetaro-kulturor nga françeskanët boshnjakë, që në dukë e në vepra personifikojshin idealin e Shën Françeskut, ndjenjat e aspiratat e popullit të tyre, - shprehet At Daniel Gjeçaj<sup>7</sup>, - qenë një fat i madh për Fishtën.”* Gjendja e popullit kreshnik të Bosnjes e Hercegovinës, nën sundimin e osmanëve; luftërat e pandara, kryengritjet e vazhdueshme dhe heroizmi tyre, deri në kurorëzimin e lirisë më 1878, ishin të ngjashme me ato të viseve tona, që prej shekujsh ishin në robëri. Historia e françeskanëve në Ballkan e veçanërisht aty ku Fishta po studionte në atë kohë, në Sutiska e Livno të Bosnjes, popullariteti i fituar dhe dashuria e merituar, ndaj bijve të denjë të shenjtit nga Azisi, mbryjtën në mendjen dhe zemrën e djaloshit të ri prototipin e fratit shqiptar, që me aq madhështi hyri në historinë e popullit e të kulturës shqiptare. Gjatë periudhës së studimeve në Bosnje, në shpirtin e Fishtës u ndez ajo shkëndijë, e cila do të shpërthente më vonë, në një zjarr të madh dashurie e veprimi, për liri e përparim të atdheut, për lumturim të fesë e lartësim të kombit.

<sup>7</sup> Po aty, faqe 26

Studiuesja Blerina Suta<sup>8</sup> na sjell një informacion edhe më interesant në lidhje me këtë temë. Fishta dhe shokët e tij, kishin varur portretin e Skënderbeut, në murin përballë hyrjes së muzeut, gjest ky, jo fort i mirëpritur nga një pjesë e nxënësve boshnjakë, që përfundon me fshehje të portretit, siç vihet re në letrën e Čengić-it, i cili thotë: *“Besomëni At, që në 10 vjet mësimdhënie dhe edukim, nuk kam pasur kurrë degjenerime të gjithanshme, si këto të këtyre arnautëve dhe të disa rishtarëve. Sapo mbërritën, filluan të sulmojnë Krajinoviç-in, për shkak të karakterit të tij të butë dhe, nëse ai nxehej dhe përpiquej t’ju përgjigjej njëfarësoj, ata e sulmonin edhe më shumë. Gjithashtu arnautët, kishin vënë në kornizë një portret të Kastriotit dhe, duke dashur ta varin në murin përballë muzeut, në vend të fra ...; dhe nëse spostohej prej nxënësve tanë në një vend tjetër, ata e kthenin prap aty ku donin. Gjithsesi, meqë Fishta tallej dhe çfarë nuk thoshte për çdo gjë, si me tekstet liturgjike, ashtu edhe me rregullat etj.; një nga nxënësit tanë, e fshehu atë portret. Atëherë ata shpërthyen dhe krijuan një rrëmujë të paparë në mes të nxënësve. Meqë unë nuk dija asgjë për këtë ngjarje, kur ma treguan, i kërcënova të gjithë, që të tregonin kush e kishte fshehur portretin dhe atëherë, njëri prej tyre më tregoi se ku gjendej, por, meqë nuk mund ta tradhëtoja nxënësin, portreti ngeli edhe sot, aty në të njëjtin vend, kurse Fishta bashkë me një grup shokësh, vazhdonte të provokonte, siç bën edhe sot e kësaj dite. ... Nga ana tjetër, Fishta është një nxitës i keq shpirtërash, i padëgjueshëm e kokëshkëmb, që ndiqet nga shumë arnautë dhe biles, edhe nga ndonjë prej tanëve. Sillet në formën më të keqe të mundshme, saqë nuk arrij t’i rri dot mrapa, sidomos në Seminar, pasi, nëse provoj t’i them diçka, ai do të përgjigjet 50 herë më keq dhe do të mundohet të nxisë konflikt, gjithmonë nën frymën e kundërshtimit; nuk ka as besim as fe, me një fjalë, nuk vlen aspak.”*

Konflikti vazhdon edhe përgjatë vitit shkollor 1891-1892, siç dëshmojnë letrat e të dyja palëve, dërguar Urdhërit në shkallë lokale e më lart. Këtu, studiuesja Blerina Suta<sup>9</sup>, përmend letrën e 20 shtatorit 1891, me të dhëna interesante që konfirmohen edhe nga studiuesi tjetër, Tonin Çobani<sup>10</sup>, ku thotë se Fishta dhe shokët e tij deklarojnë se do të pranonin më mirë të kalonin në laicitet, sesa të njihnin si mësues lektorin

<sup>8</sup> Suta, Blerina: *“Hulumtime mbi veprën e At Gjergj Fishtës”*, Onufri, 2018; f. 19-20

<sup>9</sup> Po aty, f. 22-24

<sup>10</sup> Çobani, Tonin: *“Gjergj Fishta, fillimet letrare”*, Botimet Fishta, 217, f. 80-81

A. Čengiç; i cili sipas tyre, thellon hendekun midis grupit shqiptar dhe atij boshnjak:

*“I nderuar At.*

*Më 19 të këtij muaji, filluam mësimin dhe pamë se Čengiç, ishte sërish Magistro morum (mësues i sjelljes). Mirëpo, ai dhe Guardiani, na trajtojnë si të mos ishim anëtarë të kësaj familjeje religjioze. Prej tri javësh, Čengiç nuk flet me ne asnjë fjalë. Në mensë, ulen para nesh, që jemi të vitit të tretë të teologjisë, edhe ata që sapo kanë filluar teologjinë. Sapo nisi shkolla, thirri të gjithë boshnjakët për të parë muzeun, kurse për ne të tjerët tha: Ç’më duhen ata?! Tani, na ka përgojuar në të gjithë Bosnjën, aqsa një boshnjak kishte thënë se provinca nuk ishte e kënaqur pse mori shqiptarët. Për këto gënjeshtër e shpifje, ne Ju themi sinqerisht se, nëse Čengiç do të vazhdojë të jetë Magister morum, ne të gjithë jemi të gatshëm të kalojmë më mirë në laicitet, sesa të njohim atë për mësuesin tonë. Gjithashtu, jemi gati ta bëjmë këtë gjë, nëse provinciali do të lejojë ndarjen që Čengiç ka bërë, në mes nesh e boshnjakëve. Por, para se të arrijmë në këtë pikë, ne do të bëjmë gjithçka është e mundur, pranë Gjeneralit e Qeverisë, për ta rregulluar çështjen. Këtë do ta bëjmë edhe atëherë, nëse Ju do të hiqni dorë nga çdo përkujdesje atërore ndaj nesh (Zoti na ruajtë!). Në gjunjë, Ju lutemi të mos na braktisni në nevojën tonë. Nuk e shihni që na kanë braktisur të gjithë?! Provinciali ka përzënë nga ky kuvend, të gjithë boshnjakët që nuk kanë shkuar mirë me Čengiç-in. Nëse Ju na braktisni, nuk do të kemi tjetër mik në botë, përveç Zotit. Na lajmëroni menjëherë për mendimin Tuaj. Duke Ju përshëndetur sërish dhe duke Ju puthur dorën, Ju lutemi të tregoni durim me ne dhe të mos humbisni dashurinë Tuaj ndaj nesh, teksa po Ju themi të vërtetën.*

*Livno-Gorica, 20 shtator 1891.*

*Bijtë Tuaj në Krisht: Fr. Gjergj Fishta, Anton Lushaj, Pjeter Gjadri, Lorenc Mitroviç, Engjël Paliç, Bona(ventura) Gjeçaj.” Vlen të theksohet se shprehja: “të kalojmë në laicitet”, nënkupton të kaluarit në një degë tjetër në atë kuvend, ku nuk përgatiteshin fretërit e ardhshëm, por thjesht diplomoheshin në fusha të ndryshme të shkencës e kulturës. Nëse do të kalonin atje, nuk do ta kishin më lëndën mësimore “moribus”/(sjellje) pasi atë e bënë vetëm klerikët e ardhshëm.*

Episodi i fundit i përplasjes ashpërsohet si në tone, ashtu edhe në

përmbajtje, siç e tregon letra<sup>11</sup> e 4 majit 1892 ku të rinjtë shqiptarë me forcë drejtësie, mbi shpifjen që u është bërë, duke i quajtur “epikurianë” dhe “platonikë”; si dhe përgjigjja e Patër Çengiç, e datës 10 maj 1892 i cili vazhdon ta konsiderojë Fishtën si nxitësin kryesor të opinionit negativ mbi punën e tij. Pas shkëmbimit të letrave në nivele të ndryshme, deri edhe te qendra në Romë, Urdhri e zgjidhi çështjen me zëvendësimin e Çengiç, me një mësues të ri, Kataviç, i cili, me një letër të 23 majit 1892, të cituar nga historiani Vrgoc e interpreton shkakun e vërtetë të konfliktit, në mes të shqiptarëve dhe Çengiç-it, si: “një intolerancë reciproke, që u transformua në urrejtje e ushqyer nga pasioni”.

Ky incident është shumë domethënës, për të treguar ndjeshmërinë e Fishtës, ndaj një figure të rëndësishme kombëtare, që do të shfaqet më vonë në veprën e tij letrare. Skënderbeu do të jetë një figurë kyçe dhe qëndrueshme e idealit të lirisë për Fishtën. Nuk është e rastësishme që emri i pagëzimit “Josephus” (Zef) i 24 tetorit 1871, do t’ia lërë vendin emrit “Joannes” (Gjon) siç dëshmon një akt i 8 dhjetorit 1890; si dhe më pas, do të marrë solemnisht dhe përfundimisht emrin e shugurimit: “Georgius, Silvius, Aeneas; Gjergj, për nder të Gjergj Kastriotit dhe Enea-Silvio, në nderim të Enea-Silvio Piccolominit, Papa Pio II, i cili ndihmoi Skënderbeun në fushatat e tij anti-osmane.

### **Kultivimi i këtij modeli ndër vite**

Viti 1907 shënon në jetën e Poetit Kombëtar një periudhë me optimizëm të ulët dhe shumë demoralizuese. Shprehjeve pesimiste të mikut të tij Pal Dodaj<sup>12</sup>, i cili i shkruante duke e informuar për situatën e vështirë të kohës; Fishta u përgjigjej, me një trishtim në zemër e me “mollën e Adamit” në fyt: “... Kurrë si kto ditë, nuk m’kanë pushue n’shpirt mjerimet e atdheut; po provoj n’vedi, tanë idhnimin e atij qi gjindet para nji humnere, bash njashtu si jena na sod” dhe vijon: “... Persa m’perket mue, un po tham t’verteten, se sod per sod, jam tue u perpjekë me i asgjesue kto t’mendume ... por kishte me kenë baras, si t’andrrroshem nji gja t’pamujtshme; pse e pamujtshme asht, qi t’kena nji atdhe simbas idealit tone.” Se çfarë ishte ky ideal, për të cilin punoi edhe 33 vjet të tjera, e tregoi me shkrimet dhe veprat që botoi në të ardhmen; ai donte një Shqipëri të lirë e të pavarur, të bashkuar, të drejtë

<sup>11</sup> Suta, Blerina: “Hulumtime mbi veprën e At Gjergj Fishtës”, Onufri, 2018, f. 25-26

<sup>12</sup> Gjeçaj, Daniel; “Gjergj Fishta, jeta dhe vepra”, Botimet Françeskane, Shkodër, 2007, f. 47

e të përparuar, ku Fe e Atdhe, të përbënin dy kokat e së njëjtës shqipe; të cilën, Skënderbeu si fillim dhe Ismail Qemali më pas, e përdorën si simbol të kombit.

At Pashk Bardhi<sup>13</sup> tregon se, pas fjalimit të Fishtës në Kongres, Valiu i Manastirit, i pranishëm në kuvend, u ngrit dy herë t'i shtrëngonte dorën, kurse një hoxhë filozof u ngrit ta përqaftonte me lotët nëpër faqe nga mallëngjimi. I njëjti, në një letër që i drejtonte At Shtjefën Gjeçovit, më 5 dhjetor 1908, ndër të tjera, thotë: *“Dom Ndre Mjeda, ... kishte ba një fjalim ... kundra shoqnis s’Bashkimit. Por, ne nesret, i ishte pergjegjë Pater Gjergji me një fjalim fort t’permallshem, me t’cillin kishte ba me kja shum kongresista; e mbas fjalimit, një hoxhë toskë, e ka marrë ngrykë e me lot per faqe”*<sup>14</sup>.

Nëntëmbëdhjetë dhjetori i vitit 1911 për françeskanët e Shqipërisë, është një datë për të mos u kaluar në heshtje, pasi shënonte plot një gjysëm shekulli veprimtari në fushën e arsimit, në tokën arbërore; pesëdhjetë vjet edukim shpirtëror dhe edukim kombëtar, nuk ishin pak. *“Drejtori i shkollës fretnore edhe autori i Lahutës malore, do të ishte shpirti i krenimit që po përgatitej”* - kujton Gjeçaj<sup>15</sup>. Nuk ishte gjë e lehtë dhe pa rrezik, që në ato kohë të ashpra të xhonturqve në pushtet, të shfaqësh, si në një apoteozë publike, Shqipërinë e lirë, shqiptarin e qytetëruar, të zotin të jetojë më vete, të vetëqeveriset, të përparojë në liri e demokraci, gjëra këto, që deri atëherë, vetëm sa i kishin ëndërruar shqiptarët. Kërkohej guximi i Fishtës, solidariteti i sivëllezërve të tij, që të mund t'i hyhej një pune të tillë, të vështirë e tejet të rrezikshme.

Ditën e krenimit, në salonin e teatrit ishin të pranishëm: Valiu i qytetit, kryekomandanti i ushtrisë turke dhe krejt ajka e banorëve të Shkodrës, së bashku me të gjitha autoritetet fetare e civile. Nga këta të fundit, binin në sy: Arqipeshkvi i Shkodrës, Imzot Jak Serreqi, me të pesë Ipeshkvijt e tjerë sufragane, përfaqësuesit e konsullatave të huaja, zotërinj fort të nderuar myslimanë, ortodoksë e katolikë; pastaj fretër e priftërinj dhe gati i gjithë populli, të mëdhenj e të vegjël. Melodrama, siç dihet, niste me shprehjen e guximshme emfatike: *“Shqyptar un jam ...”*, tri fjalë që paraqisnin një program, një ideal, një dyluftim në mes të Golisë vigan, të

<sup>13</sup> Dema, Benedikt; *“At Gjergj Fishta o.f.m., 1871-1940”* Botimet Françeskane, Shkodër, 2010, f. 25.

<sup>14</sup> Gjeçaj, Daniel; *“Gjergj Fishta, jeta dhe vepra”*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2007; f. 57.

<sup>15</sup> Po aty, f. 78

më të madhes perandori dhe Davidit të vogël, por me të drejtën njerëzore me vete, me trimëri e guxim në zemër. Në skenën e teatrit françeskan, përfaqësuesi i jeniçerëve të frikshëm osmanë, takohet në fushën e betejës me përfaqësuesin e Gjergj Elezave të Maleve Shqiptare, që për armë e parzmore kishte vetëm fjalët: “*Shqyptar un jam*”.

Shfaqja ishte një triumf për Fishtë, brohoritjet ishin të pareshtura dhe në mes tyre, rridhnin lot malli e gëzimi. Gjaku i shqiptarit, së bashku me vajtimin si një shkrim zie, u bashkuan edhe një herë, duke riformuar simbolin e flamurit kombëtar, në të cilin shqiponja kombëtare valonte e zezë mbi mëndafshin kuq si gjaku, pa yll as hanë, pa sëpatë liktori apo kryq të thyer mbi kokë. Apoetoza e Fishtës u kthye në apoteozë të Shqipërisë. Poeti, siç dëshmon At Justin Rrota, gramatikan i njohur i gjuhës shqipe, i cili, në raste shfaqjesh teatrale, përgatiste pjesët muzikore dhe drejtonte korin e shkollës; e ndjeu veten aq të lodhur emocionalisht dhe kaq të mallëngjyer, saqë, menjëherë pas shfaqjes zuri shtratin. Atyre që i rrinin te koka e krevatit dhe mundoheshin t’ia lehtësonin dhimbjet e zemrës, u thoshte: “*Edhe n’deksha, po des konkend per punt e Shqypnisë, tash qi ia mrrijta me ia rritë jeten, nder sy t’pashës turk*”.

Ishte pikërisht Hasan Riza Pasha, i cili, duke mos qenë shqiptar, i kërkoi Fratit të Madh, që të shkruante një himn-marsh për ushtarët shqiptarë që bënin pjesë në radhët e ushtrisë së tij. Poeti ia plotësoi dëshirën, kurse Pashai ia shpërbleu me të holla, që shkuan për fëmijët e varfër të shkollës së qytetit. At Justin Rrota<sup>16</sup> kujton se, kur e ngacmonin për shpërblimin e majmë që i dha pashai i Shkodrës, Fishta ua kthente: “*E keni keq! Kqyrni, Hasan Rizaja, aj ua ka dijtun vleren vjershavet të mija: M’i ka pague strofë e lirë turkut, ari të kulluet*”. At Justini vazhdon më tej në kujtimet e tij, duke treguar se Fishtës i bëhej zemra mal, kur dëgjonte ushtarët shqiptarë, pjesë e ushtrisë turke, të këndonin shqip përgjatë Fushës së Çelës, në Shkodër.

Me ndihmën e Fishtës e të fretërve françeskanë, Riza Pasha, i rrethuar nga të katër anët e në pamundësi për të marrë ndihma nga jashtë, arriti të lidhej me At Pal Dodajn, që në atë kohë rrinte në Rubik. Kuvendi françeskan këtu, falë veprimtarisë së Dodajt, ishte kthyer në një shtatmadhori të lëvizjes së shqiptarëve për liri, ku mblidheshin prijës të Lezhës, Kurbinit, Bregut të Matës e të krejt Mirditës. Pretendimet

<sup>16</sup> Dema, Benedikt; “*At Gjergj Fishta O.F.M.; 1871-1940*”, Botimet Françeskane, Shkodër, 2010; f. 144



territoriale të serbo-malazezëve i kërcënonin rëndë territoret e shtetit shqiptar të sapoformuar, ndaj prijësit e zonave të larpërmendura e ndienin rrezikun pranë. Në këto situata të turbullta që po kalonin, ata e dinin mirë se shpëtimi i Shkodrës nga rreziku malazez, do të thoshte të shpëtonin edhe viset e tyre nga aneksimi sllav, po ashtu, siç përkonte edhe qëllimi i Hasan Riza Pashës me atë të françeskanëve, të lironin Shkodrën, duke u rënë pas shpine trupave të Krajl Nikollës, me çetat e Malësisë së Madhe. Në shenjë të bashkërendimit të veprimeve, komandanti turk i trupave të rrethuara në Shkodër do të ngrinte flamurin shqiptar në kështjellën e Rozafatit, duke zëvendësuar atë të Perandorisë Osmane, që për pothuajse 450 vjet, ishte valëvitur mbi bedenat e kalasë së mbretit Gent. Me këtë gjest simbolik, ushtritë osmane do t'i linin vendin ushtrisë shqiptare, të paktën formalisht.

Ky plan, i studiuar dhe i përgatitur me kujdes nga të dyja palët, do të dështonte pikërisht atëherë kur Hasan Riza Pasha do të lajmëronte Fishtë: *“Nesër do të ngrihet flamuri i Shqipërisë në kala.”* Ishte nata e 29 janarit të vitit 1913 dhe ky ishte testamenti i mikut të Fishtës dhe të gjithë Shqipërisë; pasi, në terrin natës së 30 janarit, Riza Pashai do të vritej nga tre të panjohur.

Sapo hyri në Shkodër autoriteti i pesë Fuqive të Mëdha Ndërkombëtare, u duk se tashmë do të merrte frymë lirisht; por as me ndërkombëtarët nuk do t'i zgjaste shumë paqja. Më 12 qershor, pra afërsisht një muaj më vonë, pikërisht natën e Shën Antonit, Fishta bashkë me fretërit e tjerë të Gjuhadolit, ngritën, kundër vullnetit të Sër Cecil Borney-t, në atë kohë administrator i qytetit, flamurin e Shqipërisë në këmbanoren e kishës, pikërisht në atë këmbanore që sistemi totalitarist do ta shembte përdhe, disa vite më vonë. Flamuri i qëndisur me dashuri nga duart e arta të Motrave Stigmatine, ishte pothuajse gjashtë metra i gjatë. *“Më 13 qershor, - shprehet Zamputi<sup>17</sup>, - ende qëndronte në ballë të zyrës postare stema e Malit të Zi, sepse ndokujt nuk bënte dora ta hiqte, në pritje se si do të vendoseshin punët përfundimisht”.* Pikërisht atë natë, ndërsa këmbanat po binin si asnjë herë tjetër, plot me gëzim e hare, kurse simboli kombëtar po valëvitej krenar, i rrahur prej erërave flladitëse të Cukalit e Maranajt; vjen urdhëri zyrtar, për ta ulur flamurin e për ta thyer shtizën. Françeskanët nuk binden. At Gjergji nuk fjeti gjithë natën, shkroi një letër të gjatë e deri diku mjaft të fortë. Në të

<sup>17</sup> Zamputi, Injac; *“Fishta: Koha, Njeriu, vepra”*, Pasqyra, 1993; f. 39

zbardhur ia dorëzoi zyrës kompetente, për admiralin. Letra bëri efektin e vet. Admirali anglez nuk mori mundimin të përgjigjej, por vetëm, nuk e çoi ushtrinë për të ulur flamurin me forcë. Në një letër drejtuar Pal Dodajt, Fishta do të shprehej për admiralin: *“Ky budallë pra asht zemrue fort, pse na fretnit, ditën e Shna Ndout, kena ngritun flamurin shqyptar mbi kumbanoren e kishes s’onë”*.

Me këtë rast, Poeti kombëtar, i frymëzuar nga valëvitja e palëve të flamurit dhe për më tepër nga gufimi i zemrës, shkroi himnin klasik, të kënduar deri vonë si himn kombëtar:

*“ Porsi fleta e ejllit t’Zotit,  
Po rreh flamuri i Shqypnisë ...”*

*“... dhe të muzikuem nga Lec Kurti, simbas një arie rumune, mbas gjase, hymen që mbushi me gëzim të mëdhaj e të vogjël në qytet e kudo, - shprehet Gjeçaj<sup>18</sup>, - mrrijti me shpejtësi vetime në të gjithë Shqipninë.”*

Fishta, si çdo meshtar tjetër katolik dhe, për më tepër, si ndjekës i shenjtit të paqes, Shën Françeskut; ishte dhe mbeti njeri para së gjithash, pastaj shqiptar, së pari frat e pastaj luftëtar. *“Edhe para anmikut në vuajtje, - shprehet Gjeçaj<sup>19</sup>, - ai preket në zemër e mëshiron.”* Ja si shprehet Fishta, në një letër drejtuar At Pal Dodajt: *“... jetojmë, gadi si n’kohen e Atilas ase t’Vandalvet. A s’asht fjala qi bie, terhjekja e serbjanvet qi t’ban me mendue perjudhen e Gotve e t’Ostrogotvet? Aq m’dhimben kah i shof, kta ushtarë t’shkretë e t’vuejtun n’atë mndyrë, sa jam he he, kah jau fali t’mallkuemit e nacionalizmen, atdhenë, kulturen e s’dij se shka tjetër. Thohet se gorilla-majmun, asht shtaza ma e eger qi njifet, e besoj, asht shtaza q’i ngjet ma fort njirit ...”*

Nuk ishte mbushuar akoma viti nga themelimi i revistës, kur në korrik të 1914-ës, në numrin e dhjetë të saj, drejtori i *“Hyllit të Dritës”* botoi artikullin fatal *“Nji komedi e panderëshme e XX qindvjetë”*; e për pasojë, ky organ do të mbyllej nga autoritetet ndërkombëtare. Dhe megjithë mend, nuk ishin të ëmbla për veshët e tyre, fjalët e artikullshkruesit: *“... Gjaku i shqyptarit derdhet rrëkajë, gjaja e shqyptarit hupë nder thoj t’ma t’fortit; e Mkamsit e Evropës, kur t’mos kenë ngatrrue ndoi pshtjellim “polizzash” e “faturash” së veta; pa fare kujdesit rrijnë, a tue rrshitë me rrakela neper lame çementeje,*

<sup>18</sup> Gjeçaj, Daniel: *“Gjergj Fishta, jeta dhe vepra”*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2007; f. 89

<sup>19</sup> Po aty, f. 99.

*a tue luejtë dojkë e topash me femna, kush e din se çfarë nderet ...*"; dhe pastaj, në fund të artikullit: *"Marre e turp per Evropë! Por Evropa nuk din shka asht marrja, ndera e burrnija ... Ah! Po, këjo dishmon qi Evropa nuk ka nderë e burrni; dishmon qi shoqnia njerzore n'Evropë, asht teper e rame e e poshtnueme e se diplomacia evropjane, asht vetë faqja e zezë e marrja e turpi i krejt njerzimit"*.

Në një letër të 18 qershorit 1914, drejtuar Pal Dodajt, ai do të pohonte: *"Vshtirsitë qi po na bahen nga organet zyrtare, po na ngushtojnë me e pezullue botimin e Hyllit të Dritës, pse nuk po na lejojnë me pasë makinen e shtypshkrimit, qi e patem porosinë"*<sup>20</sup>. Ashpërsisë së artikullit, me pasoja të rënda për drejtorin e revistës, i shtoheshin edhe padi të shumta, të bëra nga kundërshtarë të brendshëm e të jashtëm, që i ishin dërguar autoriteteve fetare në Romë. Ndërsa këta të fundit po gjykonin rastin, koloneli anglez G. Philips, në atë kohë Guvernator i Përgjithshëm dhe Komandant i Përgjithshëm i trupave ndërkombëtare në Shkodër e "dënoi" Fishtën me 20 muaj mërgim në Maltë; vendim ky i marrë me shpejtësi, pa gjyq dhe pa prezencën e të paditurit. Patër Gjergji, sapo dëgjoi për këtë dënim, si e kishte shpërndarë me shpejtësi numrin e *"Hyllit të Dritës"*, së bashku me sivëllaun e tij, At Justin Rrota, u largua fshehtas nga qyteti dhe u strehua fillimisht te Gjeçovi në Gomsiqe, pastaj te Bardhi në Vig dhe së fundmi në kuvendin e Troshanit, pranë At Pal Dodajt dhe fretërve të tjerë të vendosur aty.

Në 1915, sipas At Donat Kurtit<sup>21</sup>; mandati i Domenik Facit përfundon dhe në vend të tij zgjidhet Padre Luiggi Paoluci, që kishte si sekretar At Zef Gicin. Për shkak të Luftës së Parë Botërore, meqë u shkëputën lidhjet *"Kurien e Shenjtë"* e Gjeneralin e Françeskanëve, me largimin e Padre Luiggit, ai delegoi si zëvendës sekretarin e vet dhe "de fakto", në këtë periudhë françeskanët drejtoheshin nga shqiptarët. Më 1916, më në fund, - shprehet Zamputi, - fretërit e Shkodrës, prej nga vareshin të gjithë pjesëtarët e këtij urdhri, të shpërndarë ndër famullitë e ndër kuvendet e tjera, qenë çliruar nga drejtimi tradicional i elementëve të huaj dhe u hap mundësia për themelimin e Provincës Françeskane Shqiptare. Po sipas Zamputit, Fishta do të shkruante në ditarin e tij: *"8 korrik 1916 – Puntë e mira n'Shqypni, vijnë disi kadalë e rrshanë. Ata Misionarë, nuk janë nisë me 6 t'korrikut, por me 8 - Allah smardhaduk*

<sup>20</sup> Po aty, f. 95.

<sup>21</sup> Kurti, Donat; *"Provinca Françeskane Shqiptare"*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2019, f. 52

( Në dorë t'Zotit – *shënim i IZ*)”<sup>22</sup>.

Edhe “*Posta e Shqypnisë*”, sikurse “*Hylli i Dritës*”, pas numrit të 89 të saj, në vitin e dytë të botimit, me 23 nëntor 1918; në të cilin At Gjergji do të shkruante dy artikuj të ashpër, “*A qafa a nafaka*”, së bashku me tjetrin edhe më të ashpër, “*Shqypnija e shqyptarvet*”, ku ky i fundit përfshinte edhe një “Memorandum” të fiseve të Hotit e të Grudës, që kishin mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë, mbyllet përdhunshëm nga Guvernatori francez i Shkodrës në atë kohë, Bardy de Fourton. Me sa duket, Memorandumi u dogji francezëve, si përkrahës të përhershëm që ishin të interesave shoviniste të serbëve e malazezëve. Kështu, përfaqësuesi i Francës, duke i rënë ndesh parimit të kombit të vet: “*Liri-Barazi-Vëllazëri*”, dha urdhër që të mbyllej “*Posta e Shqypnisë*”, që në atë kohë ishte zëri më mprehtë në mbrojtje të të drejtave të njeriut, në përgjithësi dhe të drejtave të shqiptarëve në veçanti. “*Posta e Shqypnisë, armë lufte e log beteje, nuk duel ma. - shprehet Gjeçaj, - Ra edhe ajo në ballë të luftës, tue djegë ma të mbramin fishek, që luftëtari i pathyeshëm, At Gjergj Fishta, ia kishte shti në konak.*”

Edhe në vitin 1917 Fishta së bashku me Arqipeshkvin e Shkodrës, Imzot Jak Serreqin dhe Ipushkvin e Lezhës, Imzot Bumçin, do të shkonte sërish në Podgoricë, si ndërmjetësues për paqen. Me 28 nëntor 1918 pikërisht në ditën e festës së flamurit, në Shkodër, bëhet një demonstratë e madhe popullore, në mbrojtje të viseve shqiptare të mbetura jashtë kufirit politik dhe në shenjë proteste për mbylljen e gazetës së Fishtës. Çështja e parë ishte temë e Konferencës së Paqes në Paris, kurse për të dytën nuk lëshuan pe autoritetet franceze të Shkodrës. Duhet pasur parasysh që protesta e malësorëve të Hotit e Grudës, për të mos mbetur jashtë kufijve të shtetit shqiptar, ishte organizuar dhe udhëhequr nga françeskanët.

Po ashtu, në vitin 1921, krerët e Hotit, Grudës e të Kastratit<sup>23</sup>, si përfaqësues të trojeve shqiptare të mbetura në Malin e Zi, kërkojnë ndihmën e shtetit shqiptar, për mbrojtjen e të drejtave të tyre, duke iu drejtuar kryeministrit të kohës me një promemorie, ku, ndër të tjera, i kërkojnë që pjesë e një delegacioni që mund të dërgohej për këtë qëllim, të ishte edhe At Gjergj Fishta, i cili ishte marrë gjithnjë me këto çështje, por edhe njohja prej tij e gjuhës dhe e kulturës së sllavëve të jugut,

<sup>22</sup> Zamputi, Injac; “*Fishta: Koha, Njeriu, vepra*”, Pasqyra, 1993, f. 37-38

<sup>23</sup> Arkiva e Shtetit Shqiptar. Fonde Personale. Gjergj Fishta, dosja nr.88.

si dhe emri që ai ka në rrethet kulturore italiane, e bëjnë atë njeriun më të përshtatshëm dhe më me ndikim, për t'u shërbyer mbrojtjes së interesave të tyre.

Si pjesë e delegacionit për në Konferencën e Paqes në Paris, në një mision kaq të lartë dhe kaq të rëndësishëm, kur fati i Shqipërisë vendosej sërish në diskutim, nuk kishte si të mungonte Frati i Madh. Dhe vërtetë, Patër Gjergji, në fillim si ekspert e më pas si sekretar i Bumçit, pasardhës i Turhan Pashës në kryesimin e delegacionit; mori pjesë e bashkëpunoi, me të gjitha fuqitë e veta, në një çast kaq delikat për fatet e vendit tonë. Gojëdhëna popullore thotë se Imzot Bumçi, përdori një taktikë interesante që ta përfshinte Fishtë në delegacion. Ai ngriti pretendimin se, duke qenë Ipeshkëv, nuk mund të udhëtonte vetëm. *“Para nisjes së tyre për në Francë, - shprehet Kurti<sup>24</sup>, - qeveria italiane, me pasaportat e së cilës do të udhëtonte përfaqësia, nxori probleme për emnat e Bumçit e të Fishtës, që njiheshin prej tyre si pro-austriakë.”* Vetëm për shkak të At Gjergjit, u vonua nisja me dy javë, por prania dhe kontributi i tij në Konferencën e Paqes, e justifikon këmbënguljen për ta patur pjesë të delegacionit.

Gjatë udhëtimit për në Francë, Fishta dhe Bumçi u ndalën në Romë. Në “qytetin e përjetshëm”, ata u takuan me kryetarin e Urdhrit të Françeskanëve, At Serafino Cimino, ku siguruan një audiencë me Papa Benediktin XV. Nuk duhet anashkaluar ndikimi i këtij Pape dhe i këtij takimi, për shpëtimin e Korçës dhe Gjirokastrës, që, sipas takimit të fshehtë Tittoni-Venizellos, duhet t'i kalonin Greqisë. Imzot Bumçi, në takimin me Papa Benediktin e XV natën e ndërrimit të viteve 1919 dhe 1920 mori prej tij premtimin se: *“... do të bëj ç'është e mundur për të ndihmuar në këtë drejtim”*. Kujtesa popullore thotë se, ndërsa Bumçi po priste në Vatikan kohën e përshtatshme për mundësimin e këtij takimi me Papën, vjen Fishta dhe e bën rrëmujë gjithë Selinë Papnore, duke iu drejtuar mikut të tij me fjalët: *“... nuk pret puna per ceremoni; sa t'vijë ty audiencia, e morën grekët Gjinokastren”*.

Qëndrimi në Amerikë i vlejti Fishtës, jo vetëm për të krijuar njohje vetjake me autoritete të larta të shtetit më të fuqishëm të botës, ku mund të veçojmë takimin me senatorët katolikë, por edhe për të ndihmuar çështjen shqiptare apo njohjen e Shtetit Shqiptar nga USA. Me rekomandimin e At Gogfried Shilling, françeskan shumë i njohur dhe i

<sup>24</sup> Kurti, Donat; *“Provinca Françeskane Shqiptare”*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2019, f. 55

vlerësuar në Washington, Fishta i pati dyert e hapura në Departamentin e Shtetit. Me aftësitë e veta oratorike, erudicionin dhe magjinë e komunikimit, ai arriti të bënte pro çështjes shqiptare, njerëz që, as nuk e kishin dëgjuar fjalën Shqipëri dhe as që e dinin se ku binte; shumica kujtonin se shqiptarët ishin një popull autokton i Afrikës, i Azisë së Largët apo i ndonjë ishulli të panjohur në Oqeanin Indian. Sidoqoftë, më 8 maj 1922 Fishta i shkruante Pal Dodajt: *“Ktu n’Uashington, jam pjekë (kam takuar – shënim i E.M.) me një senator katolik dhe e kam lutë t’interesohej te qeverija e tij, qi kjo ta njoftoj Shqypnin, porsì shtet t’mosvarun. Ky, n’tjetren anë, ka folë me senatorin Lodge dhe sot na lajmnoi, qi kjo gja mund t’rregullohet. Prandej, asht mirë qi Qeverija e Tiranës, t’i dergojë një shkresë Nensekretarit t’Ministris s’Jashtme t’Shteteve t’ Bashkueme, tue i kerkue zyrtarisht ket njohje”*. Gjithashtu Fishta do të takohej edhe me Kardinalin Mercier, për të cilin, në një nga letrat e veta, sipas kujtimeve të At Marin Sirdanit, shprehet: *“Atij t’i thuesh prelat! Nji burrë sa Pater Bonë Nikaj i naltë, i thatë por i bashem n’shtat, me do sy të kjarët, me një hije burri sa me t’u knaqë zemra tue mendue, se asht Prelat i Kishës Katolike. Kardinali e muer per zemer çashtjen t’onë e tha se, ka me i shkruë mbi ket punë Balfurit, Kardinalit të Londonit, Mareshallit Fosh, Dechanelit, Milerandit...”*<sup>25</sup>.

*“E vërtetë se Fishta, - shprehet Gjeçaj<sup>26</sup>, - s’që çue në Amerikë, drejt per drejt porsì mis i qeverisë shqiptare, as s’që ngarkue veçanërisht prej saj me një mision të posaçëm, ad hoc; por prejse e mira e e mbara e Shqipnisë, s’ishte vetëm detyrë e shtetit, por e të tanëve e e çdo qytetarit e, nga ana tjetër, mbasi: kush asht msue s’rrin pushue, At Gjergji s’mundi kurrsesi mos të kujdesohej për vendin e vet, sido e kudo t’i paraqitej rasti.”* Ndoshta, autoriteti dhe prestigji i Henry Cabot Lodge (1850-1924) i njohur jo vetëm brenda Partisë Republikane, të cilën ai përfaqësonte, por edhe në të gjitha qarqet diplomatike botërore, si një autoritet politik dhe mbrojtës i të drejtave të popujve për vetëvendosje, sipas parimeve Willsoniane, po ashtu edhe ndihma e senatorëve katolikë, bënë që Fishta të mund t’i shkruante gjithë gëzim, mikut të tij Dodaj: *“... nderkaq vizita jeme n’Washington, ka pasë si perfundim, njoftjen e Shqypnis prej Shteteve t’ Bashkueme të Ameriks. Te tana perpjekjet e*

<sup>25</sup> Dema, Benedikt; *“At Gjergj Fishta O.F.M.; 1871-1940”*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2010, f. 42.

<sup>26</sup> Gjeçaj, Daniel : *“Gjergj Fishta, jeta dhe vepra”*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2007, f. 122.

*maparshme, si ato të “Vatres”, s’kan pasë sukses ... Kienë senatorët katolikë, t’cillve jau paçë parashtrve çashtjen, sidomos n’pikpamjen fetare; ata qi, me nderhymjet e veta, xueren njoftjen e Shqypnis prej qeveris amerikane”.*

Sipas At Daniel Gjeçajt<sup>27</sup>, At Anton Harapi, duke qarë hall një ditë me Fishtë, për shpërdorimet pa kriter të disa nëpunësve të shtetit, gati krejt i demoralizuar, i thotë: “ *Pater Gjergj, shporru Shqypnijet, perse në t’vertetë, Shqypni s’ka !*” Poeti e ndjeu veten të prekur dhe të zemëruar, por pa e prishur terezinë i shpjegon bashkëfolësit se punonjësit e administratës së shtetit, nuk janë Shqipëria për të cilën punonte ai dhe të gjithë shqiptarët e vërtetë. Atëherë Harapi, duke i treguar Poetit Kombëtar se i pranonte argumentet e tij, kthehet e i thotë: “*Eh! More zotni ... na vetem prej teje e kena nxanë se shka asht Shqypnija ... Por per ditë na asht ngatarrue nper kambë një Shqypnije tjeter, qi nuk i giet kurrkund asaj Shqypnis t’ande, qi ti na ke msue me dashtë ...*” Në fakt At Anton Harapi<sup>28</sup>, në kujtimet e veta tregon se kjo bisedë u zhvillua në praninë e tij, në mes të Patër Gjergjit dhe një plaku që po ankohej për abuzimet që bënte administrata e shtetit.

Asnjë vit të plotë nuk zgjati ëndrra e asaj qeverie, te e cila shpresuan e për të cilën punuan Fishta e bashkëpunëtorët e tij. Ahmet Zogu, i ndihmuar nga Beogradi, në krye të mecenarëve të tij, më 24 dhjetor 1924 rrëzoi qeverinë e Nolit dhe u rikthye në pushtet. Dom Ndoc Nikaj ishte ndoshta nga të vetmit klerikë shqiptar dhe mik i Fishtës, që e kritikonte angazhimin e tij dhe të tjerëve si ai në politikë. Frati i Madh u ishte përgjigjur kundërshtarëve të tij, duke ju argumentuar se çfarë ishte ky angazhim, pse nuk mund t’i shmangeshin dhe deri ku do të shtrihej ai; mirëpo kësaj rradhe, veprimtaria e tij po gjallonte në zonën gri të kufijve të së drejtës. Ai do ta kuptonte shpejt këtë gjë dhe do të tërhiqej në jetën e tij shpirtërore, letrare e mësimdhënëse, por fjalimi mbi varrin e Avni Rustemit, ka mbetur si një dëshmi e gjallë e ëndrrës së lirisë apo e orës së të vërtetës, që i kap njerëzit e mëdhenj kur fillojnë të besojnë se erdhi dita e shumëpritur.

*“Konop e gjak përdoroi Zogu, - shprehet Gjeçaj, - edhe pse në masë e numër ma të vogël; plumb e gjak përdoroi Enveri, tue tha landë e*

<sup>27</sup> Po aty, f. 127-128.

<sup>28</sup> Dema, Benedikt; “*At Gjergj Fishta OFM, 1871-1940*”, Botimet Françeskane, Shkodër, 2010, f.51.

*tue djegë gjithkund, deri barin e Shqipnis*”<sup>29</sup>. Nëse në të parën, litari dhe gjaku ishin masa të tepruara ndëshkuese, në të dytën, plumbi e gjaku ishin elementë esencialë të diktaturës staliniste. Gjatë sundimit të Zogut, kush nuk ishte përkrahës i tij, mundi të mbijetonte në varfëri dhe harresë, por, prapëseprapë, kishte mundësi ta shijonte ajrin e kulluar dhe dritën e diellit në tokën e vet, kurse, pas 1944-ës, kush nuk ishte komunist apo përkrahës i tyre, ishte i gjykuar, i dënuar me vdekje apo i lidhur me pranga në duar gjithë jetën, aq sa ta merrte malli për dritën e diellit. Noli e Gurakuqi e lanë Shqipërinë për të mos e parë më. Edhe Fishta u largua nga vendi, për të pritur kohë më të mira; ideali i tij u shkel, por nuk u përkul.

Natyrisht që periudha e mërgimit, ndonëse Fishta ishte figurë e mirënjohur dhe e nderuar pranë qarqeve civile dhe kishtare italiane, nuk ishte një periudhë pushimi e as lumturie. Me trup ai ishte në Itali, por me zemër e shpirt ishte në Shqipëri, në atë Shkodrën e tij, në mes të njerëzve e bashkëpunëtorëve të tij; për ta dhe krah tyre, dëshironte të punonte e të luftonte, siç kishte bërë deri në atë kohë. *“Fishta do të ketë menduar të heqë dorë përfundimisht nga politika aktive, - mendon studiuesi Tonin Çobani, - sidomos pas vrasjes së mikut të tij, ndër më të mirët, Luigj Gurakuqit, në varrimin e të cilit nuk ishte lejuar as të bënte kryq e jo më të mbante një fjalim të merituar, siç dinte t’i bënte vetëm ai”*<sup>30</sup>. Në këtë gjendje shpirtërore të shqetësuar, në kushtet e një Shqipërie që nuk e kishte gjetur ende qendrën e vet të gravitetit, në rrethanat e vështira që po kalonte Provinca Françeskane Shqiptare, të cilën ai e donte si sytë e ballit; po të mos llogarisim poezinë *“IDbuemi”*, mund të themi se Muza e tij do të heshtte, ashtu siç kundërshtarët e tij do ta bënin të heshtë edhe armën e tij paqësore, *“Hyllin e Dritës”*.

Fishta u kthye në Shqipëri, duke iu përgjigjur ftesës së Zogut, por shumë shpejt regjimi i tij, do të mbyllte edhe gjimnazin *“Iliricum”* të cilit po i kushtonte vitet e tij. Në zbatim të urdhërit të ministrit, Fishta mblodhi nxënësit në oborrin e shkollës dhe në praninë e trupës pedagogjike, i prekur thellë në shpirt e pothuajse me lot në sy, në fjalimin e lamtumirës, ndër të tjera thotë: *“Bij të dashtun, ç’me sod shkoni nder shpia tueja e nder shkolla të shtetit, mbasi Shqypnia nuk po e don ma*

<sup>29</sup> Gjeçaj, Daniel; *“Gjergj Fishta, jeta dhe vepra”*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2007, f. 130.

<sup>30</sup> Çobani, Tonin; *“Gjergj Fishta, fillimet letrare”*, Botimet Fishta, 2017, f.88-89.



vepren tone. Por ani: *Shqypnia rrhoftë ene pa ne!*”<sup>31</sup>. Fjalë të denja për një njeri të madh, për një idealist, për një atdhetar e për një profet, i cili qysh atëherë e parashikonte katastrofën që vinte, duke shqiptuar ato fjalë, që do t’i deklaronin shumë françeskanë para pushkatimit: “*Rrhoftë Shqypnia edhe pa freten!*”. Askush nuk e mendonte në ato kohë, se këto fjalë do të përsëriteshin, prej nëndrejtorit, At Anton Harapit, atëherë kur me gjakun e vet dhe të sivëllezërve të vet, do të shkruante mbi tokën e të Parëve, mbi plisat e varrit të Fishtës, apo në Tiranën e djegur dhe në Shkodrën e shkretuar, të njëjtat fjalë: “*Shqypnia rrhoftë edhe pa ne!*” - tha Fishta i përbotur para nxënësve; “*Shqypnia rrhoftë ene pa françeskanë!*” - tha Harapi para plumbit të pushkatimit.

Shkolla e At Gjergjit u mbyll me 25 prill 1933; ishte ora 17<sup>00</sup>. “*At Gjergji, - shprehet Zamputi - nuk ishte kundër mbylljes së shkollave të huaja, por ai nuk mund ta mendonte se si kishin guxuar të mbyllnin gjimnazin e tij, për të cilin kishte të drejtë të mburrej, se ishte i pari gjimnaz në Shqipëri, që kishte qenë themeluar me gjuhën shqipe për të gjitha lëndët e mësimin, përpara se të themeloheshin shkollat e mesme shtetërore*”<sup>32</sup>. Fratit shkrimtar e patriot, i mbeti në dorë vetëm pena dhe katedra e “*Hyllit të Dritës*”.

Gjatë vitit 1937 pati një nismë të re për të bashkuar rezultatet e dy gjimnazeve, të françeskanëve dhe të jezuitëve. Përparimi i madh intelektual në Veriun e Shqipërisë, me një kuotë të ulët analfabetizmi në raport me pjesën tjetër të vendit, si dhe me një ndikim të lartë kulturor, rrit frikën dhe xhelozinë e pakuptimtë të qeverisë shqiptare, e cila, megjithatë, nuk kërkonte të prishej me Italinë. Nuk dihet se si u afrua një ekspert italian, një farë Montanelli, gjoja asnjans, por që do të armiqësohej shumë shpejt me Fishtën. Nën ekspertizën e Montanelit, u përgatit një projektligj, që synonte të ndalonte gjimnazin si formë shkolle; “*Kultura e naltë per shqyptarë, asht gja e teprueme. Shqypitari ka kenë e do t’jese, puntuer e zejtar.*” Sipas këtij projektligji, për një milion shqiptarë, mjaftonte një gjimnaz klasik shtetëror në Tiranë dhe një gjimnaz real në Shkodër, shtetëror edhe ky. Shkollat e tjera do të ishin profesionale, si: pedagogjike, teknike, bujqësore etj. Qëllimi ishte sërish i njëjti: mbyllja e dy gjimnazeve “*katolike*”. “*Për këtë qëllim, Ministri i Arsimit, dërgoi të negocionin me Gjergj Fishtën, - shprehet*

<sup>31</sup> Gjeçaj, Daniel; “*Gjergj Fishta, jeta dhe vepra*”. Botimet Françeskane, Shkodër, 2007, f. 147.

<sup>32</sup> Zamputi, Injac; “*Fishta: Koha, NJeriu, Vepra*”. Pasqyra, 1993, f. 29.

Peters - *italianët e mëposhtëm: Ambasadorin Francesco Jacomoni, Konsullin e Përgjithshëm në Shkodër, Salvatore Meloni, sekretarin e tij, Babuscio, dhe ekspertin e “pavarur”, Montanelli*”<sup>33</sup>. Përveç Fishtës, si Provincial i Provincës së Françeskanëve në Shqipëri, në takim ishte dhe Monsinjon Vinçenc Prendushi, Ipeshkëv Françeskan i Sapës, si dhe At Frano Kiri, Drejtor i Liceut “*Illiricum*”. Në fillim të takimit, Montanelli qëndroi jashtë derës së kuvendit, për të mos provokuar dhe nxehur Fishtën; por prapëseprapë, At Gjergji do të shpërthente, sapo mori vesh qëllimin e takimit: “*Ket nderë e kena prej jush. Na po e shofim se ju doni qi katolikt e Shqypnis, megjithse një grusht njerzish, t’jesin vorbaxhi e teneqexhi. E pra, na kena mendue, se do t’kishim prej jush një grimë perkrahje, si katolikë qi jena.*” Fishta, duke parë rrezikun e mbylljes së shkollës sërish, propozon që françeskanëve, t’u mbetej të paktën një shkollë normale (*pedagogjike – shënimi i E.M.*). Në këtë moment thirret në takim Montanelli, që po priste jashtë, mirëpo ai, as këtë propozim nuk do ta pranonte. Takimi përfundoi pa rezultat, por edhe projektligji nuk kaloi në Parlament; ndoshta Meloni u pendua e ndryshoi qëndrim. Por edhe kjo është e vështirë të besohet, pasi më 1938-ën, qeveria do të ndërpriste subvencionet për shkollat e françeskanëve dhe ndërhyrjes së fretërve për këtë problem, ai do t’u përgjigjej me fjalët: “*Hiqni provincialin dhe të gjitha ndreqen !*”

### **Modeli fishtjan në veprat e Fishtës**

Shqipëria është në rrezik dhe Ali Pashë Gusija bëhet gati për luftë. Duke dalë nga shtëpia, ka këto amanete për nënën e për nusen:

*“Pa ndigio, mori ti loke,  
Banmu nderë miqve e shokve,  
Banmu nderë, kush t’jetë per nderë,  
Mos len t’vobeg me t’kja n’derë...  
... Por ne kje se Mali i Zi,  
Erdh’ e ra kurr në Gusi,  
Der sa t’jetë djali kerthi,  
Pasha njatë Zot, qi ta ka falë,  
Ma ndigio ti grue një fjalë:  
Bane zemren gur e krep,  
Premja djalit kryet n’djep...”.*

<sup>33</sup> Peters, Markus W.E.; “*Përballjet e Historisë së Kishës Katolike në Shqipëri, 1919-1996*”. Shoqata Jezuite, Tiranë 2010, f. 103.

Te shkrimi publicistik me titull: “*Kur do t’perbashkohen shqyp-tartë?*”, Fishta tregohet i drejtpërdrejtë, i qartë dhe befasues:

*“Sod nuk asht besimi qi ndan zemrat e nierzvet n’shekull, por asht kultura e ndryeshme qi nuk i len me u bashkue. Prandej, t’gjith ata qi e kanë per detyrë, si edhe ata qi i a kanë vndue vedit per detyrë me organizue jeten shoqnore e t’qytetnueme n’Shqypni, per n’daçin pernjimend perbashkimin e kombit shqypnar, pa t’cillin bashkim nuk mund t’perbahet kurr nji shtet i qytetnuem, ma sparit t’caktojnë se mbas cilles kulturë duen me e organizue kombin shqypnar, e masendej, me ligj, me punë e me kohë, t’mundohen me i ba shqypartë qi t’mendojnë e t’veprojnë mbas parimesh t’asaj kulturet, tue mbajtë parasysh etnologjinë, psikologjinë e ndiesitë besimtare t’tyne”.*

Ndërsa te “*Fjala e At Gjergj Fishtes n’dekë t’Avni Rustemit*”, para se të qajë fatkeqësinë e Avniut, folësi qan gjendjen në të cilën ka rënë Shqipëria, për t’i lidhur pastaj të dyja fatkeqësitë në një:

*“Edhe kshtu sod, qi lulet janë tue shperthye mbi dhe, ky, n’ma t’miren lule t’djelmnis s’vet lule po hyn me u kalbë nen dhe. Pse? Pse pati dashtë Shqypnin? Kercuna, mori nana e vet, qi ktij petritit t’Libohovs, dhanë i paska nji zemer bujare, fisnike; pse po zemer satrapi, tyrani ajo t’i kishte dhanë, sod s’do ta kishte martue me token e zezë, por me ndonji zojë vashet shqyptare... I ziu more, pedagogu i tij, qi mbrenda ledhevet t’shkolles, dikue i paska t’gjith at njoms i ndiesijet ndaj vyrtytit t’burrnis, beses, njerzis; pse po ta kish’ msue ay se me kalem e leter, mund t’shkelen popujt e mund t’pihet gjaku i tyne, sod vorfnue s’do ta kish Libohoven nji qytetas i ndershem... Po, të mos e kishte dashtë ky djalë Shqypnin, sod nuk do t’ishin shkrehë burrat e dheut prej shkambit t’Pejes e deri n’kulm t’Kepit t’Stillos, per me derdhun lot mbi varrë t’tijna t’pasherueshme...”.*

Blerina Suta, në studimin me titull: “*Hulumtime mbi veprën e At Gjergj Fishtës*”, botuar nga Onufri, më 2018, shpreh:

*“... Por, ndërsa autorët sllave, e njëjtësojnë veten me kryqin, në funksion anti-islamik dhe kombëtar, Fishta refuzon njëjtësimin e fesë me etnosin, duke ia nënshtruar këtij refuzimi, edhe vetë zhgunin - të paktën, në fazën e redaktimit fillestar të veprës - kur*

*ishte i detyruar t'i konsideronte, pjesë të një kampi të vetëm, shqiptarët e krishterë dhe myslimanë, përballë kampit kundërshtar të ortodoksve malazezë ... Kur flet për "fe", Fishta i referohet fesë së gjithë luftëtarëve, si të krishterë ashtu edhe myslimanë. Zoti i përbashkët në qiell dhe Kanuni, janë përbërësit kryesorë të "lirive jetike", në emër të të cilave luftojnë luftëtarët e Lahutës."*

A mund të shprehet më bukur se kaq, dashuria për atdheun?!:

*"N'ty mendoj kur agon drita,  
Kur bylbyli mallshem kndon,  
N'ty mendoj kur soset drita,  
Terri boten kur e mblon...".*

Në fund të poezisë ai bën premtimin madhështor, si të ishte para altarit, duke u lidhur përgjithnjë me Shqipërinë, në kurorë:

*"Deri sa t'mundem me ligjrue  
E sa gjallë me frymë un jam,  
Kurr, Shqypni, s'kam me t'harrue,  
Edhe n'vorr me t'permendë kam...".*

### **Përfundim**

Poet sa veç shpirti i Tij e dinte, patriot si Ai e kërkush tjetër, por edhe prift i devotshëm; duke lëvizur gjithnjë në zonat gri në mes të këtyre të triave, duke rrezikuar të qenit frat, patriot apo shpirt i lirë, por kurrë pa e humbur orientimin dhe sensin e masës; rebel 360 gradësh, dashnor i së bukurës dhe i së mirës, gjithnjë në luftë me padrejtësitë. Ai nuk qe kurrë satelit i askujt, por vetëm një planet i lirë, që rrotullohet rreth një dielli: "*Për Fe Atdhe e Shpirt Poetik*".

Kur shqiptarët kërkuan një poemë kombëtare ku të frymëzoheshin me ndjenjën e atdhedashurisë, ai u dha "*Lahutën e Malcis*"; ndërsa, kur pa rrezikun e rritjes së krenarisë boshe ndër shqiptarë, ai i fshikulloi pa mëshirë me kamxhikun e sarkazmës së tij, tek veprat "*Anzat e Parnasit*", "*Gomari i Babatasit*", si edhe te shumë poezi të tjera.

Kur pa rrezikun e humbjes së identitetit të shqiptarëve, duke e kuptuar mjaft mirë, se ndryshe nga fqinjët e tyre, shqiptarët e kanë ruajtur dhe do ta ndërtojnë kombin e tyre, vetëm duke u mbështetur tek gjuha shqipe; ai luftoi si luan për futjen e kësaj gjuhe në shkollat françeskane të administruara nga fretërit e huaj, si dhe për t'i bindur prindërit e fëmijëve për domosdoshmërinë e mësimit të kësaj gjuhe.

Kur ndjeu urinë e të rinjve shqiptarë për teatër, u ul të shkruante apo të përshtaste mbi njëzet drama; ndërtoi vetë skenën, bëri piktorin, skenografin, kostumografin e deri edhe regjisorin skenik. Bëri arkitektin e pjesës më të madhe të kishave katolike shqiptare, të kuvendeve françeskanë apo atë motrave stigmatine, deri te bibliotekat, teatrot e sallat e konferencave.

Kur kuptoi se shqiptarët ngandonjëherë i duan gjërat troç, përveshi mëngët dhe iu fut publicistikës, duke na lënë sot një arkiv të pasur me mbi njëqind artikuj kritikë, njëri më interesant se tjetri, në të cilët trajton problematika të ndërtimit dhe përparimit të shtetit shqiptar, të emancipimit të shoqërisë shqiptare, të zhvillimit të arsimit e kulturës e deri tek problemet sociale dhe kronika e zhvillimeve politike të ditës, të cilat, në shumicën dërrmuese të tyre, fatkeqësisht, nuk e humbin aktualitetin, as si mesazh apo mendim kritik, as si problematikë social-politike të cilën shoqëria shqiptare, edhe pse kanë kaluar gati njëqind vjet, nuk po arrin ta kapërcejë dot.

Kur ndjeu se po i vinte fundi dhe nuk kishte më kohë t'i përfundonte të gjitha projektet e tij, i dha shoqërisë shqiptare një Akademik, anëtar të Akademisë Mbretërore Italiane, edhe pse e dinte se do të sulmohej si profashist, duke e shfrytëzuar katedrën akademike për të promovuar lashtësinë shqiptarëve, ndjenjën dhe parimet e së drejtës mbi të cilat ata kanë konceptuar jetesën e tyre, si dhe frymën proevropiane të shqiptarëve.

Deri në muajt e fundit të jetës punoi me *“Jerinën, Mbretëreshen e Lulevet”*, që t'u linte shqiptarëve një poemë dramatike të nivelit të lartë estetik, të rangut botëror.

**Rafaela MARTETA**

## **SHANTOJA, PRIJËS I OPINIONIT PUBLIK**

Lazër Shantoja ishte angazhuar hershëm qytetarisht e politikisht në shtypin e kohës. Zgjedhja e tij për të ndikuar nëpërmjet këtij instrumenti ishte një thirrje organike, e bashkëlindur me të. Prandaj edhe krijimtaria publicistike e Shantojës ishte origjinale e format që ajo merrte ishin paraprijëse për kohën. Kështu fillon rrugëtimi i «famullitarit të pianofortit», apo sipas fjalëve të tija e «*fletorarit të tharbët, pena e të cilit u nryete n'ufull, n'esence ufulle*». Ai e tërhiqte interesin e opinionit duke veçuar dhe paraqitur në mënyrë të thjeshtuar tema nga debati më i gjerë publik.

Sot, një person i tillë do të quhej lider opinionit, një figurë e aftë për të ndikuar dhe për të orientuar opinionet dhe sjelljet e publikut të masës. Shantoja në kohën e vet ishte me të vërtetë një prijës i opinionit publik. Përmes shkrimeve të tij siguronte një shtresëzim në komunikim kur krahas produkteve për elitën që kishte qasje në lexim, por edhe në kuptim, krijonte modele alternative për të përfshirë në komunikim edhe shtresa të tjera të shoqërisë. Rubrikat e tilla si *Kodra mbas bregut* apo *Kumbona bie per me ndie* ishin shprehje stilistike e një mendimi avangardë për të alfabetizuar lexuesin e shtresës popullore me mjetet e komunikimit.

Krahas temave të thjeshta e të kapshme me efekt edukues dhe ungjillëzues, Shantoja e përdorte shtypin për të paraqitur çështje me

interes politik dhe shoqëror; angazhimi i tij për përfshirjen e publikut ishte një veprimtari politike, pasi synonte të afronte sa më shumë kolektivitet në çështje të natyrës politike dhe të qeverisjes së punëve të vendit. Krahas shpërndarjes së ideve nuk e kursente kritikën ndaj autoritetit qeveritar duke diskutuar publikisht çështjet që ishin të papërputhshme me interesat konkrete të popullit për një qeverisje demokratike të vendit.

(...) e ftojme opinionin publik me na dhanë shkoqitje të kjarra, t'holla e të mjaftueshme. Opinioni publik, thonë, e nuk rrën kurrë: na nuk jemi në ket opinjon, por na nuk perbâjm opinjonin publik! Na diejm njikaq: se opinionin publik, kuer rrënë, nuk â opinjon publik, porse rrënë publike, asë mâ për shkurt: Rrepublikë!.

Shantoja demaskon orientimin e opinionit që bëhet për synimet dhe interesat e qeverisë. Mjaft herë e kishte shprehur shqetësimin tij për nevojën e përgatitjes dhe të formimit të zgjedhësve, për nevojën e përmirësimit të sistemit burokratik; për të gjitha këto problematika publicisti kishte bindjen se shtypi jo vetëm ndihmonte qytetarët të qëndronin të përditësuar me punët politike dhe burokratike të vendit të tij, por edhe të mësonte të drejtën për të mbajtur nën mbikëqyrje punën e qeverisësve. Kjo mënyrë e të trajtuarit të opinionit publik dëshmon një qasje tejet të emancipuar të Shantojës sa i përket marrëdhënies mes zgjedhësve dhe qeverisësve. Ai nuk mbetet në pozicionet e një kritiku të ndriçuar, pjesë e një rrethi të ngushtë intelektualësh; në të kundërt përshfaq idenë se afrimi i publikut në çështje që lidhen drejtpërdrejt me interesat e menjëhershme të vendit është faktor ndërtues dhe në të mirë të ngjizjes së një bashkësie që merr përzemër përmirësimin e së përditshmes së vendit.

Vërtet Shantoja ishte prijës i opinionit publik dhe dëshmitar në vetë të parë i shpërthimit të shoqërisë së masës dhe i mjeteve të komunikimit të masës, pasi udhëtonte në rrugë detare për në Misir, komunikonte përmes radios me diasporën shqiptare, përdorte shërbimet postare për dërgimin e materialeve në redaksitë shqiptare, udhëtonte me tren, frekuentonte kinemanë, shkruante i nxitur prej reklamës. Ky përjetim i revolucionit të telekomunikacionit të Nëntëqindës ka gjurmë në publicistikën e gjerë të Shantojës.

Pasi bën një rezyme të forcës së shtypit nëpër botë dhe rolit të tij vendimtar në çështje politike dhe me ndikim shoqëror, nuk ngurron të

kthejë sytë dhe të shtrojë pyetje për gjendjen e shtypit shqiptar: «Nuk është prandej për t'u bënë se edhe Shqypnija, qi don me kë në një gjymtyrë nonsë tepër e vogël e e vonë e trupit shoqëruer të gjytetnuem, e pau nevojën e një zgjimi më të madh në lamën e shtypit. Si gjindena na me shqypin komtar?».

Gjendja e shtypit, çështja e receptimit të tij në publik janë tematika që Shantoja i analizon duke kritikuar, siç shprehet edhe vetë, jo anën teknike e cila varet prej mjeteve dhe financave në dispozicion, sa punën e atyre që merren me pasurimin (me shkrime) të faqeve të Fletores. Gjejmë një kritikë të ligjërit të përdorur për trajtimin sipërfaqësor të çështjeve të rëndësishme nga njerëz me aspak aftësi në çështje të Fletorizmes, term me të cilin përmbledh gazetarinë e shtypur. Ai denoncon militantizmin dhe gazetarinë me pagesë që shtyhet nga interesa politike, sjellje për të cilat kusurin e paguan opinionin publik me keqinformim: «Ç'farë edukatet mûndet me i dhanë popullit t'onë një shtyllë mbajtun në kambë me mistrecat e pëndës shumë herë të shitme e partizane?».

Prapë nuk reshtin përpjekjet e Shantojës për të vetëdijësuar, por edhe për të informuar lexuesin (popullin) për rreziqet e shtypit të blerë dhe partizan, duke i bërë thirrje arsyes së publikut dhe jo levave psikologjike që lidhen me epokën apo me kohën dhe influencën e “ipse dixit”. Nisur edhe nga ndihmesat e sivëllezërve të tij e kishin krejt të qartë se çfarë mund të bënte shtypi, që nga 1900 ishte konsoliduar si një forcë brenda shoqërive: një forcë efektet e së cilës duhej të mbaheshin parasysht për një të ardhme nën shenjën e demokratizimit të vendeve.

Fenomenit të fletorizmes, në veçanti, i duhet vlerësuar roli në krijimin e një kulture opozitare, siç është rasti i *Ora e Maleve*: «Në kjoftë se me fitimin e Opozitës sot puti despotik qi quhet “Qeverrië” gjindet i tronditun per mos me thanë fare i rrxuem, gjithkush e din se të shtyemen më të madhe e më të furishme në lāmë të fletorizmes e ka pasë prej “Orës së Maleve».

Këtu flitet për rolin vendimtar që pat kjo fletore e që pas rikthimit të Zogut në qeveri - si ngadhënjimtar me pushtet e ngadhënjimtar mbi lirinë, sidomos atë të shtypit - u censurua vetëm sepse garantonte një dritare informacioni për opinionin publik; me fjalët e Shantojës: «Fletorja qi kishte luftue më rreptesisht se kurrnji tjetër Ahmed Zogun e rregjimin e tij».

Në një kontekst të brishtë sikurse ai shqiptar, ku shpëtimi qëndronte




në format e veprimit të përbashkët në të mirë të çështjes kombëtare, Shantoja i ndërgjegjshëm për forcën përhapëse të ideve përmes shtypit, me zgjedhjen e tij dhe me përzgjedhjen e lëndës së tij, i përgjigjet një thirrjeje personale të brendshme, por edhe një thirrjeje të bashkëvëllezërve të tij në fe e ide. Më së pari Fishta, të cilin Shantoja e vlerësonte së tepërmi, kishte shkruar:

E lypë puna pra, që të gjith intelektualt privat të Shqipnís – mbas të kryemit të mbar detyrve – të perkujdesen, me sjellje të mbarë e me msime e me shkrime t’veta, me permirsue moralin e me zhvillue sa mâ mirë kulturën kombtare në gjí të popullit shqiptár; pse ndryshe Atdheu s’perparon as lumnon, e shqiptarët kan me mbetë gjithmonë një kalem-kusúr në dorë të diplomacís s’Europës, për me mbyllë ajo me ta ndoj hesap bataqilleku.

Anton Harapi në *Njísimi kombtar dhe ideali kombtar*, kur flet për «nji idealogji shqyptare», mirënjeh forcën e shtypit si instrument për identifikimin dhe vënien në dukje të një ideje përbashkuese mbi fate të Shqipërisë. (Harapi, 1997, 42).

Shantoja e lartëson me një hov më tepër detyrën e shtypit në rimëkëmbjen e atdheut, sepse i sheh çështjet kulturore dhe politike si rezultat i praktikave shoqërore. Për realizimin e tyre lipset një marrëdhënie e ndërsjellë dhe e besueshme mes publikut dhe trajtimit të gjësë publike: «Lypset qi perbâsat e opinjonit publik të bashkohen më nji lidhje shêjte per me pshtue popullin nga krizja mâ e rrezikshme neper të cilen po pershkohet në ket kohë, d.m.th. nga krizja morale shpirtnore e cila e bân të deshprojë në Shqipnìn, në frytin e mundshem të sa vetvet e të sa vjetvet, në bimën e lagun me gjakun e sa deshmorvet.

## Arben PRENDI



### LAZËR SHANTOJA PUBLICIST, PRIJËS I OPINIONIT PUBLIK

- Mbi punimin “Publicistika e Lazër Shantojës paradigmë shqiptare e mendimit modern” Tiranë, 2021 të autores Rafaela Marteta -

Monografia “Publicistika e Lazër Shantojës, paradigmë shqiptare e mendimit modern” me autore studiuesen e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Akademia e Studimeve Albanologjike në Tiranë, dr. Rafaela Marteta, ka meritën se bën objekt studimi një pjesë të veprës së njërit prej autorëve të rëndësishëm në kulturën shqiptare të gjysmës së parë të shek. XX i cili për arsye ideologjike është lënë në harresë, jo vetëm gjatë periudhës së regjimit komunist, por edhe pas rënies së tij, me sa duket, për shkak të të njëjtit paragjykim. Autorja e punimit në studimet

tona letrare, së pari, po e hedh tej me guxim dhe profesionalizëm paragjykimin që rëndon nga historiografia e kaluar shqiptare, në rrethanat e mjedisit tonë ende të politizuar dhe së dyti, sepse në fakt ajo po i qaset objektivisht vlerave të veprës së Shantojës, si tekst me vlera domethënëse, veçanërisht në publicistikën e viteve '20-'30.

Pra, autorja dr. Rafaela Marteta ka vënë në fokus të punimit, publicistikën e Shantojës si pjesë, por edhe si shprehëse dhe ushqyese idesh e konceptesh në kontekstin e kulturës shqiptare të gjysmës së parë të shek. XX.

Punimi shoqërohet me një parafjalë që ka për autor prof. dr. Tomor Plangaricën, parafjalë në të cilën vihen në dukje vlerat dhe rëndësia e monografisë mbi publicistikën e Shantojës. Ndërsa punimi është konceptuar në disa çështje:

*Preambulë autoriale*

*Lazri, një bir i shekullit të ri;*

*Nën yllin e Nëntëqindës;*

*Palca e intelektualit modern;*

*Ndihmesa e shtypit në ngritjen e çështjes shoqërore;*

*Shantoja prijës i opinionit publik;*

*Aspekte strukturore të publicistikës shantojane;*

*“Mos me u komprometue” etika e veprimit politik;*

*“Rrita e egër” e gjuhës shantojane;*

*Poetika e jetës dhe e vdekjes: motive të Leopardit të Shantoja;*

*Jehona e preludit humanist;*

*Bibliografia.*

Në çështjen *Lazri, një bir i shekullit të ri* skicohet jeta, formimi, veprimtaria dhe fati tragjik i autorit, i cili u dënua me vdekje dhe me ndalim të veprës, si shumë bashkëvllëzër të klerit katolik në regjimin komunist.

Ndërsa në çështjen *Nën yllin e Nëntëqindës* trajtohet gjendja sociale-ekonomike dhe kulturore në të cilën vendoset vepra e Shantojës dhe ndikimi i lëvizjeve kulturore dhe filozofike evropiane mbi kulturën shqiptare. Në këtë çështje, theksohet roli i shtypit shqiptar të këtyre viteve në formësimin e opinionit shoqëror, ku një rol të veçantë luajti edhe publicistika e Lazër Shantojës.

Kurse në çështjen: *Palca e intelektualit modern* përshkruhet përfshirja e Shantojës në grupin e intelektualëve të kohës që besojnë në

forcën e shtypit si mjet për përhapjen e ideve dhe ndikimin tek shoqëria. Shantoja, siç shprehet Koliqi, bëhet pjesë e “të rijve” që vijuan rrugën për studimin e psikologjisë së popullit shqiptar dhe u dhanë zhdrivillim problemeve të gjalla shpirtërore të jetës së përditshme. Në këtë çështje vihet në dukje ndikimi i Shantojës nga letërsia, filozofia dhe kultura evropiane, gjë e cila bën që ai të përpiqet ta shohë kulturën shqiptare duke operuar me instrumentet e kulturës evropiane. Siç vëren studiuesja R. Marteta, për Shantojën është esenciale që të përcaktojë rolin e intelektualëve në jetën shoqërore shqiptare dhe kush e meriton këtë emër. Studiuesja spikatë kthjelltësinë intelektuale të Shantojës për të kapur thelbin e problemeve që ka shoqëria shqiptare mbas shpalljes së pavarësisë dhe domosdoshmërinë që zgjidhja e këtyre problemeve të prihet prej intelektualëve të kohës.

Tema e rolit të intelektualit dhe e shtypit në shoqëri, është e pranishme, siç vë në dukje studiuesja, në të gjithë publicistikën e Shantojës.

Kjo plotësohet edhe në këtë studim me çështjen e katërt: *Ndihmesa e shtypit në ngritjen e çështjes shoqërore* ku trajtohet ndihmesa e shtypit të gjysmës së parë të shek. XX në trajtimin e çështjeve me karakter shoqëror, të cilat do të ndihmonin në kultivimin e mendjes dhe shpirtit të popullit shqiptar duke ndjekur postulatit të Fishtës që thoshte: “Tash që u ba Shqipnia, duhen përba shqiptarët” duke nënkuptuar se ndërtimi i një shoqërie shqiptare mbi vlerat e lirisë e të moralit të shëndoshë, mbas afro pesë shekuj robëri, ishte një detyrë fort e vështirë.

Me këtë rast në punim është cilësuar roli i disa fletoreve, si: *Ora e Maleve*, *Bashkimi* dhe *Illyria* ku Shantoja botoi shumë prej artikujve të tij publicistikë.

Më tej, në çështjen *Shantoja prijës i opinionit publik* studiuesja e cilëson me të drejtë Shantojën “prijës i opinionit publik” duke vënë në dukje se ai e përdor shtypin për të paraqitur çështje të rëndësishme me interes politik dhe shoqëror. Është me interes hipoteza e studiueses se publicistika e Shantojës ndikohet veç të tjerash edhe nga zhvillimet e vullshme të mjeteve të telekomunikacionit të fillimit të shekullit të XX. Ndërkohë studiuesja ka argumentuar se Shantoja bëhet frymëzues i një shtypi opozitar që punon për interesin e publikut dhe rimëkëmbjen e atdheut dhe jo për interesa të ndonjë regjimi apo ideologjie të caktuar.

Ndërsa në çështjen *Aspekte strukturore të publicistikës shantojane* i gjithë fokusi i studimit është përqendruar në aspekte strukturore të publicistikës së Shantojës, veçanërisht tek rubrikat: *Kodra mbas*

*bregut; Kumbona bie për me ndie; Prej fjalorit; As në qillë as në tokë.* Në këto rubrika janë shqyrtuar dhe interpretuar shumësia e ideve dhe koncepteve, larmia tematike dhe mjeshtëria e shkrimit të publicistikës së Shantojës, por edhe ndikimi te publiku i këtyre viteve.

Sipas studiueses, në *As në qillë as në tokë* përveç vuajtjeve të jetës së kaluar në mërgim si kundërshtar i Ahmet Zogut, shprehet edhe keqardhja që një pjesë e elitës intelektuale gjendej jashtë vendit dhe pa mundësi për të organizuar ndonjë veprim politik, por ironizon edhe me faktin që ndoshta për Shqipërinë ishte më mirë që edhe për arsyen e mësipërme të mos bëheshin eksperimente utopike sipas mendjes së secilit.

Ndërkohë në rubrikën tjetër *Kodra mbas bregut* autorja ka veçuar nga publicistika e Shantojës shqetësimet për pastërtinë e gjuhës shqipe dhe qartësinë e komunikimit me publikun. Kurse në rubrikën *Kumbona bie për me ndie* Shantoja, sipas studiueses, përpiket të përfshijë besimin fetar në stilin e ri të jetës së shek. XX. Siç vihet re këtu, shkrimet e kësaj rubrike, sjellin në vëmendje të publikut, nevojën për ruajtjen e traditës në çështje të besimit dhe në praktikat laike.

Ndërsa në rubrikën: *Prej fjalorit* autorja ka veçuar teknikën që përdor Shantoja duke zgjedhur disa fjalë kyçe në përdorimin e përditshëm të kohës dhe për secilën prej këtyre fjalëve kyçe zgjedh të trajtojë argumentet që i interesojnë atij vetë, por edhe lexuesit. Siç vëren me të drejtë studiuesja: Shantoja është mjeshtër fort i guximshëm, sepse krijon një divergjencë mes faktesh që janë para syve të të gjithëve dhe opinionit të tij për të njëjtat fakte, duke u bërë *prijës opinionit*.

Duke shqyrtuar shkrimet me temë nga psikologjia dhe pedagogjia, në këtë studim është vënë në dukje qëndrimi i Shantojës ndaj çështjes së edukimit dhe rolit të arsimit, prindërve dhe klerit, duke inkurajuar dialogun dhe besimin e ndërsjelltë mes mësuesit e nxënësit në liri, dhe sigurisht, duke hedhur poshtë edukimin përmes ndëshkimit dhe dhunës. Janë diskutuar këtu pikëpamjet e Shantojës për këto tema të rëndësishme atëherë dhe tani.

Siç vë re studiuesja në këtë punim, në artikujt e Shantojës ka një vend të veçantë edhe për gruan shqiptare, për rolin dhe vendin e saj në shoqëri. Në këtë rast është vënë në dukje guximi i Shantojës për të bërë pjesë të debatit publik edhe këtë temë duke e konsideruar si element të rëndësishëm për emancipimin e shoqërisë së kohës.

Larminë tematike dhe kompleksitetin e publicistikës së Shantojës,

që vë në dukje studiuesja në këtë studim, e plotësojnë udhëpërshkrimet dhe portretet publicistike kushtuar figurave të ndryshme të këtyre viteve.

Në çështjen tjetër "*Mos me u komprometue*" etika e veprimit politik studiuesja Rafaela Marteta, thekson nevojën për një trajtim objektiv ndaj veprës dhe qëndrimit të Shantojës ndaj fashizmit, duke e parë veprimtarinë e tij kulturore dhe politike jo si fryt i "periudhës fashiste", por si shpalosje e vijimësi e veprimtarisë së tij të mëparshme, duke përfshirë këtu edhe pesëmbëdhjetë vitet e mërgimit si kundërshtar i regjimit të Zogut. Pajtohem me qëndrimin e studiueses se "bashkëpunimi" me Italinë fashiste për të cilën akuzohet me të madhe duhet vendosur në kontekstin e rrethanës historike, në të cilën kjo veprimtari pati si emërues vetëm interesat e atdheut të tij dhe në asnjë rast kjo veprimtari nuk solli ndonjë viktimit apo dhunë ndaj bashkëatdhetarëve të tij apo ndokujt tjetër, madje as artin e tij Shantoja nuk e vuri në shërbim të ndonjë regjimi apo ideologjie, aq më pak të fashizmit.

Studimi monografik "Publicistika e Lazër Shantojës, paradigmë shqiptare e mendimit modern" i autores Rafaela Marteta mendoj se ka edhe këtë vlerë mbiletrare: hedhjen poshtë të etiketimit të Shantojës si kolaboracionist me fashistët dhe vënien në vend të dinjitetit të veprës dhe personalitetit të tij në kulturën shqiptare. Çka duhet të themi ne sot për shkrimtarët dhe studiuesit "kolaboracionistë" me regjimin komunist?! Mendoj të njëjtën gjë si për Shantojën: nëse veprimtaria e tyre kulturore dhe politike nuk ka prodhuar dhunë dhe viktima, atëherë të vlerësohen objektivisht për ato vlera që i sjellin kulturës sonë kombëtare dhe jo për simpatinë ndaj regjimit komunist etj. Studiuesja ka argumentuar me objektivitet këtë çështje përmes shtjellimit të aktivitetit dhe ideve të shpalosura nga Shantoja në publicistikën e tij.

Edhe në çështjen "*Rrita e egër*" e gjuhës shantojane i është kushtuar rëndësi përkthimeve nga Shantoja të kryeveprave letrare nga gjuhët evropiane, ndikimit që patën ato në krijimtarinë origjinale të tij, por edhe qëllimit që kishte Shantoja, sikurse Noli më vonë, të sillte në letërsinë shqipe modele të kryeveprave të letërsisë evropiane. Ky qëllim merr kuptim edhe për faktin se në këtë periudhë, në letërsinë shqipe u ndie ndikimi i qartë i rrymave moderne evropiane në veprën letrare të Poradecit, Migjenit, Koliqit, Kutelit, Spasses, V. Kokonës etj. Studiuesja ka mendimin se përkthimet e Shantojës janë në fakt pjesë e një programi intelektual me mision kombëtar ngritjen kulturore të vendit. Madje, siç na e paraqet studiuesja, Shantoja temën e ndikimeve

kulturore në letërsi apo në artet tjera e trajton edhe në disa artikuj të tij në mënyrë më teorike. Me këtë rast, është vënë në dukje ndikimi nga letërsia italiane, si në krijimtarinë letrare të Shantojës ashtu edhe në letërsinë shqipe të kësaj periudhe.

Raportet e këtyre ndikimeve janë analizuar më tej në *Poetika e jetës dhe e vdekjes: motive të Leopardit te Shantoja* duke shqyrtuar marrëdhëniet e poezisë së Shantojës me poezinë e poetit romantik italian, Xhakomo Leopardit. Mund ta shohim këtë kapitull si shembull të suksesshëm të qasjes krahasuese që argumenton procesin në fjalë. Megjithëse shkëputemi nga publicistika, prapëseprapë ndriçohet një çështje e trajtuar edhe në publicistikën e Shantojës. Përqasja mes poezisë së përkthyer *Silvjes* nga Leopardi dhe *Vorr i harruem* të Shantojës është mjaft interesante dhe na zbulon misterin e ndikimit të një vepre letrare nga një vepër e një gjuhe, kulture dhe kohe tjetër. Një pikë mbështetëse për këtë trajtim është bindja e studiueses se bashkëndarja e temave të njëjta që vijnë nga realitete të ndryshme na zbulon universalitetin e gjendjes njerëzore, ndërsa për evidentimin e analogjive të fushave leksikore/semantike është marrë tërësia e njësive leksikore veçanërisht në marrëdhënie paradigmatiche/asociative.

Nga fushat semantike të poezive, prej studiueses, janë zgjedhur tre fjalë kyçe që kanë rol përfaqësues të këtyre fushave: *kujtesa*, *rinia* dhe *natyra*. Megjithëse nuk ka qenë objekt i temës, do të ishte shumë me interes, që çështja e ndikimeve në poezinë e Shantojës, të mund shtrihej edhe me ndikime të tjera, përveç Leopardit, duke sjellë me këtë rast edhe zgjerimin interpretimeve për poezinë origjinale të Shantojës.

Në çështjen e fundit të këtij studimi *Jehona e preludit humanist* është ritheksuar roli i shkrimtarëve dhe publicistëve të viteve '20-'30 në përcjelljen e modeleve kulturore dhe ideve që vijnë si ndikime nga kultura evropiane, ku një rol të rëndësishëm, siç shtjellohet edhe në këtë rast, pati vepra e Lazër Shantojës, vepër e cila edhe përmes kësaj monografie sintetike të studiueses Rafaela Marteta po i rikthehet kulturës sonë në mënyrë dinjitoze, përmes një qasjeje interesante dhe profesionale.

Kjo monografi, e vetmja deri më tani, ka meritën se vendos në vendin e duhur veprën dhe personalitetin e Lazër Shantojës, përmes një studimi objektiv dhe interpretimeve interesante të studiueses dr. Rafaela Marteta, e cila, me siguri është përballur me mungesën e një bibliografie të shumtë për autorin në fjalë, por edhe me paragjykimin e kësaj vepre

gjatë regjimit komunist dhe me gjasë do t'i duhet të përballet ende me paragjykimin e atyre që vijojnë të shohin te Shantoja ashtu si tek Fishta, Harapi, Koliqi e deri te Martin Camaj “poliagjentët” dhe “armiqtë e popullit”.

Punimi priret drejt studimit sintezë dhe përshkohet nga një ligjëratë e zhërvjellët e cila operon me terma kritikë korrektë, duke lënë anash çështje që nuk i përkasin studimit dhe realizuar thelbin e vënë në fokus: publicistikën e Shantojës si përçuese e mendimit dhe ndjeshmërisë moderne në rrethanat e formësimit të vetëdijes sociale dhe kulturore të shoqërisë shqiptare të gjysmës së parë të shek. XX.



Alfred ÇAPALIKU

## RIMARI I POETIT KOLË THAÇI

“Gzoju, gzoju, o Shqyptari,  
Per ket Flamur e Liri.”

Kolë Thaçi

Rimari vibrues poetik i muzës së Kolë Thaçit (Shkodër 1886 - Tiranë 1941) ndjek sistemin e vjershërimit silabiko - tonik, të nisur në poezinë shqipe qysh nga Pjetër Budi më 1618. Rimari i larmishëm thaçian bën pjesë në traditën e shprehësisë letrare kombëtare të vargëzuar. Në fundin e vargjeve të metruara autori përzgjedh e thadron rimat e përpikta emërore, foljore, mbiemërore, ndajfoljore, përemërore. Leksikologu Ferdinand Leka në një fjalor terminologjik përcakton: “**RIMË - A, - AT** (nga *gr. rythmos* - lëvizje e njëtrajtshme). Është barazia e plotë e një ose më shumë rrokjeve fundore të një fjale me ato të një fjale tjetër, duke filluar nga zanorja e theksuar fundore: shqipt - *are*, buj - *are*, *yllë*, *mbyllë*, *lir - i*, *lumtur - i*.”<sup>1</sup>

Në poetikën e Thaçit ekziston lidhja e brendshme e fjalëve në fund të çdo vargu, e cila përmes të rimuarit organizon tërësinë kuptimore në strofat e vjershës apo në këngët e poemës. Vazhdimisht ndër sinkopat e lëvizjeve të rimave dyshe, treshe, katërshe Kolë Thaçi sjell forma të reja me kumbime të papritura, përmes rimave të kryqëzuara, të puthura, të mbyllura. Poeti neoklasicist iu shmanget efekteve të rimave të brendshme. Ai kombinon çiftet e *rimave mashkullore*, ku theksi

<sup>1</sup> Ferdinand Leka: “RIMË - A, - AT”. Fjalor i termave të letërsisë. Tiranë, 2013, f. 332.

përputhet muzikalisht në rrokjen fundore: “Shqyptari - liri” dhe ato të *rimave femërore*, ku theksi bie harmonikisht në rrokjen e parafundit: “Arbnore - hyjnore”. Në gdhendjen e sistemit rimor poeti kujdeset edhe për shenjimin e theksit. Aparati mjeshtëror i rimimit të Kolë Thaçit është faktorizues i rolit semantik të fjalëve të zgjedhura në mbarim të vargjeve. Në hapësirën e poeticitetit ai realizon eufoninë e plotë rimore, ndjekur edhe me ndonjë asonancë të mjaftueshme. Kompleksiteti i rimave në vjershat e në poemat origjinale, si dhe në shqipërimet e tij poetike, shpalos një lojë kombinatorike përmes variacioneve befasuese fundore në fundin e vargjeve rimuese dhe ritmuese. Rimari i Thaçit shfaq pasurinë e 610 (gjashtëqind e dhjetë) rimave të papërsëritura, qoftë edhe një herë. Autori krijoi edhe me vargun e bardhë, ku rima mund të ndeshet krejt rastësisht. Poeti klasikegjant Kolë Thaçi është përfaqësues i denjë i shkollës letrare shkodrane të jezuitëve. Originaliteti i mjeshtërisë së tij rimuese mbart diçka nga arketipi i përsosur gjer në detaj i vjershërimit klasik të Ndre Mjedës. Atë rimar melodik që funksionon si zemberek, e ka lexuar kritikisht dhe e ka analizuar me skrupolozitet studiuesi Shaban Sinani, i cili shprehet: “... *mbisundon rimëformimi prej fjalës, për dallim nga rimëformimi prej trajtës, rendi poetik mbi rendin gjuhësor, ritmi dhe theksat poetikë mbi ritmet dhe theksat gjuhësorë.*”<sup>2</sup>

Këto karakteristika përgjithësisht i gjejmë të reflektuara dhe në dyshet rimore të krijuara nga mendja dhe nga dora e poetit Kolë Thaçi, gjithnjë të përpunuara sipas mënyrës së tij dhe pa rënë në imitim.

**A:** *Anmiku - rreziku; anmikun - çelikun; ap - prap; Arbnë - shkri; Arbnore - hyjnore - ndore; Arbnuer - nduer; ardhë - fatbardhë; atdhë - fé - ré - ké; Atdheut - Orfeut; Atme - hallakatme.*

**B:** *Bâa - qurâa; bāj - ulāj; ball - njall; ban - kan; bâni - zâni, banorë - kunorë; barbare - shqyptare; bardha - lumbardha; Bardhanjorë - kunorë; bashkarisht - trimnisht, bashkove - lshove; beja - reja; besë - jetesë; bima - hyjplima; bje - shtje; bjerrun - tjerrun; bota - fuqieplota - plota - rrota; botë - kotë - thotë; britë - pritë; bujare - kombtare; bulon - galdon - shterngon - pson - vron; burija - ushtriya; Burri - turri; burri - lumni; buta - luta.*

<sup>2</sup> Shaban Sinani: “*Ikja prej rimës gramatikore si ikje prej rapsodisë*”. Përmbledhja studimore “*Mjedologji. Botime Mjedologjike*”. Lezhë 2017, f.63

**C:** *Cenë - skenë; cillen - drandofillen - siellen - qiellen; coptoj - gabo.*

**Ç:** *Çarkore - prore; çeta - zhgjeta; çetë - perpjetë - tretë.*

**D:** *Dalin - ndalin; dàm - shkàm; dashtni - Shqipni - dlirni; dashtun - drashtun; Dedëgjoni - zakoni; dej - rrmej; dergueme - kullueme; dermore - qillore; dersot - Zot; Diellit - qiellit; dihet - shtihet; dije - shije; ditë - brohoritë - perkitë - pritë - shetitë; dishiri - Epiri; dishrueme - lirueme; ditë - shetitë; Djelmnija - Arbnija; do - kundrò; dora - kunora - bora - ora; dore - mizore; doke - toke; don - mlon; drandofillen - qiellen; droni - mendoni; due - prendue; duej - ruej; durim - galdim; dvue - xhixhillue.*

**DH:** *Dhà - là; dhânë - lânë; dhé - idhé - ré - rrfé - prè; dhee - jee; dheu - leu; dhimet - bimet; dhunija - lumnija.*

**E:** *Edhé - bjé; eja - rrféja; ejllore - arbnore; elektrikut - anmikut; êmi - trêmi; empiri - dishiri; Empirit - hirit - dishirit; Epirit - ethirit; epshime - gzime; erândshme - kândshme, ethirit - birit.*

**F:** *Fajtorit - gjallnorit; fali - ndali; falisi - nisi; fare - komtare; farmakueme - mallkueme; fatmjera - tjera; felgime - kujtime; fije - hije; fill - dill; fise - shise; fisit - lisit; fisnike - jetike; fitim - bashkim; fjala - hala - vala; fjalen - falen; fjalë - ndalë - valë; fjetë - fletë; flakët - pergjakët; flakroni - diftoni; flas - pas; flasin - hasin; flet - shndet; fleta - veta; fletë - perpjetë; flutrim - mashtrim; fllugen - rrugen; fmii - t'zì - shpiì; fron - sundon; froni - lmoni friga - vdiga; fryet - syet; fshâ - zâ; fuqì - Arbnì - njimì - shkri; fuqija - dashtnija; fusha - harusha; fushata - shpata; fushet - mbushet.*

**G:** *Gazmënd - vënd; gazmëndi - shpëndi; gazmëndit - shëndit; Gegë - degë; giasimi - ìmi; giasimin - mjerimin; gilatë - shpatë; gnjesa - kmesa - jetesa - shpresa; gojen - ulkojen; grima - jetima; grumbullonin - rreshtonin.*

**GJ:** *Gjak - sodak - plak; gjakatare - barbare; gjaksore - ndore; gjakut - hakut; gjamë - rropamë; gjatë - shpatë; gjergjef - shef; gjii - djegcù; gjikime - t'ime; gjithkuej - t'uej; gjithkund - tund; gjithkushi - mbushi; Gjyteti - njeti.*

**H:** *Hana-tana; harës-rrfès; harmonija - lenija; herë - poterë; hershmemndershme; histori - liri; hjedhë - mbledhë; hyjnore - Arbnore - qiellore; Hyjplime - nderime.*

**I:** *Idhnijet - Arbnijet; ika - dika; Ilirve - sinxhirve - martirve.*

**J:** Jèn - xèn; jet - qet; jeta - veta, jetë - mbetë; jetik - ilirik - besnik; jonë - thonë.

**K:** Kà - rà - shà; kaan - ban; Kaçanikut - çelikut; kaçuba - tuba; kalueme - bashkueme; kaluese - vinglluese; kàll - ball; Kastriotit - motit; kavaljete - Shtete; kè - Atdhè - hare; kénë - dhénë; keni - ktheni; kercnìm - nderìm - pikllìm - terbim - trim; kerkueme - prarueme; kndoni - kerkoni; kobit - robit; kodra - Shkodra; kputë - lutë; krahnorë - dorë; krânde - kânde; krejní - treni; kremtimit - Amshimit; kremtues - sundues; krepa - grepa; kreu - Atdheu; kreshnike - jetike; Kreshniku - fiku; krijova - shenjova; kronit - Elikonit; Krueje - rueje; kudò - veshtrò; kufi - fmi; kullon - fiton; kundrò - fitò; kuptue - heshtue; kurdoherë - poterë; kuturesen - jetesen; kuvënd - vënd; kuvise - fise.

**L:** Lahuta - buta; lajmue - krijue; lanë - nanë; lândoke - doke; largu - vargu; lavdurime - nderime; leta - sbeta; liga - friga; lindet - bindet; lire - hire; Lirija - burija; lot - mot; lshoj - uroj; luejt - ruejt; luftare - shqyptare; luftoni - diftoni; lulet - ngulet - ulet; Lumni - dobi; lumnon - guxon; lumnueshme - çmueshme; lurime - kujtime; luta - futa; lyrë - mirë.

**M:** Mâ - bâ - lâ; mal - termal; mali - ndali; marazi - shprazi; mari - Shqyptari; maresen - shpresen; marim - perparim; mâten - nâten; Mbreten - jeten; Mbreti - treti; mburron - fron; meje - rfeje; mek - rrek; mênde - vênde; mdhà - pà; mija - Arbnija; mizore - arbnore; mjedisin - gradisin; mjeri - mneri; Mjerija - Shqypnija; mjerime - idhnime; mllefi - Zefi; mnü - grü; mote - plote - lote; motit - Kastriotit - Zotit; motmot - Zot; motmote - fuqiplote; mrekkull - shekkull; msueme - mblueme; msýy - sýy - shtýy - ndrýy; mure - fugure; mushikore - arbnore; mytet - virtytet.

**N:** Nalcohet - kercnohet; Nalta - shkerbalta; naltue - poshtnue; Nanë - zanë; natyra - ftyra; ndaloj - filloj; ndaloni - trahthoni; ndë - mbrë - rë; Nderi - vleri; nderim - perparim; nderime - ime; ndershme - mndershme; ndeshkon - don; ndiesi - Shqyptari; ndrësin - fisin; ndryllet - mbyllet; ndryshim - Amshim; nesh - shesh; ngallnim - amshim; ngrânë - dhânë - lânë; ngjati - vikati; nieri - hiri; nise - vise; nisi - fisi, nomotisin - gatisin.

**NJ:** Njati - Shqyptari; njëni - mëni.

**P:** Pafaji - vaji; pagjamë - kamë; pàme - dàmë; paraqet - pret; parë - Shqyptarë; pari - Shqyptari; parit - Shqyptarit - mbarit; Parigji - Tamigji; pasunü - dhuntü; Perendija - Arbnija - Shqypnija; perhera

- mera - stera; perket - vet; permallohet - shtohet; perpjetë - jetë; pervujtnijet - Arabijet; pikllimit - idhnimit; plagosun - gjinosun; Plaku - gjaku; plot - Zot; polémi - jémi - çêmi; porosija - Shqypnija; potera - tjera - mjera - era; prâ - bâ; prâni - bibâni; prigue - fatue; prilli - qilli; prore - kuvendore; pshtim - trishtim; pshtë - do; pûlë - ngûlë; pushim - Amshim.

**Q:** Qesin - desin; qet - thrret; qetì - Shqyptarì; qetohet - egrohet; qetsi - ajri; qilli - prilli; qiell - siell; Qiella - Diella; qielli - kshilli; qiellit - diellit; Qiellore - Arbnore; qielluer - duer.

**R:** Rà - vrà; rànda - lànda; ré - dhé; rmove - sgjove; rob - kob; rojë - nevojë; Roma - njoma.

**RR:** Rrezen - ndezen; rreken - deken; rrenime - pikllime; rrefej - dej; rrefeja - reja; rruzullimit - Amshimit; rrymë - frymë.

**S:** Salvimit - Trimit; sgjohen - kohen; siell - diell; Skanderbegu - shtegu; Skenderbeu - Atdheu; Skenderbeut - dheut; sokola - fola; solli - ndolli; s'onë - thonë; sot - Zot - plot ; sosë - vendosë; stëja - dëja; sundimtar - Shqyptar; sye - shtye; sýy - shtýe - njýy.

**SH:** Shekull - mreku; shertimin - tingllimin; shife - kadife; shije - dije; shikjò - do; shkri - vrrì; shkâma - tràma; shkatrron - pershkron; shkencetare - barbare; shkri - gri; shmangen - kangen; shndritë - ditë; shpat - rropat; shperesa - rrnesa; shperthye - ngerthye; shprazen - vllazen; shpresa - gnjesa; Shqypnija - Perendija - mija; Shqyptarì - rì - lirì - persrì; Shqyptare - Kombtare; Shqyptarë - mbarë; Shqyptarija - ushtrijs, Shqyptarit - parit - arit; shqyt - vertyt; shtiullet - ndiullet; shtje - bjé; shtohet - amshohet; shtrue - urue; shuhet - shkruhet; shum - lum.

**T:** T'ânde - kânde; Shejtani - bâni; tejet - rrefej; Tepelena - krena; tela - vela; teper - neper; terkuza - buza; tingllon - zhvillon; tjera - mjera; tjetër - vjetër; tmérr - ndér; tmerrshem - pandershem; topa - Evropa; tregoni - thoni; trém - polém; trêma - gêma; treti - zateti; tretun - pàpermletun; trifare - bujare; trima - kelthima; trimi - nierzimi; trimneshë - njeshë; trishtimi - pshtimi; trup - hup; turbullime - pikllime; turr - kurr.

**TH:** Thanë - Zanë; thehet - prehet; themele - dele; themeli - ngeli; thonë - jonë; thotë - botë; thrret - vet - Gjytet - flet - shndet - Mbret - mbet - permlet - qet - njet - perket - pret; thue - rrethue - pshtue.

**U:** *Udhen - rudhen; uli - Berduli; ulen - perkulen; urdhnue - kndue; ushtrija - trija - mjerija - marrija - duhija - vrrija - mizorija - furija - lirija - kqija - drejtsija - nierija - plotsija - lenija - fuqija.*

**V:** *Vajin - fajin; valë - palë - dalë - fjalë; valle - halle; vallen - shkallen; vallxoni - harroni; vdiget - liget; vedi - dedi; vëhen - prëhen; vela - çuprela; vën - lën; vend - gazmënd; vepra - epra; veprimi - veshtrimi; véra - éra; vertyti - fryti; veshë - qeshë; vet - kerset - vret; veta - meta; vetim - terbin; vetima - jetima; vetme - papermletme; vija - naltsija; vikâma - gjâma; vjeta - jeta; vjetra - letra - kthetra, Vjosa - fatosa; vlon - pshton; Vlona - zakona - t'ona; vllazen - shprazen; vorre - shatorre; vshtira - mira; vullnetin - rretin, vûna - xûna.*

**X:** *Xeu - dheu; xûna - vûna, xûni - prûni.*

**Y:** *Ylberi - qemeri.*

**Z:** *Za - fsha; zâa - bâa - rra; zânin - ulanin; zakoni - Londoni; Zana - Kapitana - grrana - tàna; Zânë - ânë; zânit - Ballkanit; zateti - deti; zblon - mundon; zgjohen - kohen; Zot - lot - plot; zeza - ndeza; zì - bukurì - Shqyptarì.*

**ZH:** *Zhele - themele.*

Le të shijojmë rimat e puthura thaçiane, në mënyrë fragmentare, sesi bukurtingëllojnë në krijimin e fundit origjinal të poetit, te strofa e katërt e këngës së gjashtë të poemës liriko-epike “Njizetepësëvjetori i Lirës” (Shkodër 1937) :

*“O Ju shekuj qi **vallxoni**  
Hymnin t’ èm mos e **harroni**,  
T’ amlen kangë t’ Lirës s’ **Atdheut**  
Qi s’ja fala as gojës s’ **Orfeut**;  
Asht ma e bukra kangë në ket **botë**  
Per Atdhé, Zana ju **thotë.**”*

▪ Trashëgimi kulturore ▪

**Eduard GRISHAJ**

**KANUNI, LIGJI I PASHKRUAR I MALEVE<sup>1</sup>**

Tradita etnojuridike shqiptare. E drejta dokesore në karakterin e popullit shqiptar. Kanuni dhe Adriatiku i lartë kulturor.

Kanuni i Maleve, apo siç njihet ndryshe *e drejta dokesore e shqiptarëve* është, në radhë të parë, sigurisht një monument historik, dinamik i kulturës sonë etnike. Ai vlerësohet si Kodi, me parimet dhe normat e të cilit, rregullohej jeta e maleve, në kuptimin e njërive administrative dokesore, por në një kuptim më të gjerë, ai përfshinte të gjitha normat morale dhe etike të popullit shqiptar dhe i dha formë tipareve të dallueshme të shqiptarit përballë etnive të tjera. Krahas gjuhës amtare, së cilës rilindësit i njihnin rolin themeltar të njësisë kombëtare, ai ka ndikuar në ruajtjen e identitetit të shqiptarëve gjatë shekujve përballë kohërave pushtuese e asimiluese, veçanërisht gjatë sundimit gjysmë mijëvjeçar osman, kur errësira synonte të mbulonte çdo rreze drite të kulturës e përparimit të popullit tonë.

***Gjakmarrja***

Gjakmarrja është një sanksion ligjor në të drejtën dokesore shqiptare. Në një fazë historike të hershme të organizimit të bashkësive fisnore,

<sup>1</sup> Ky trajtim është shkëputur nga punimi E. Grishaj, “Gjakmarrja në prozën shqipe”. “Fan Noli” 2022, f.23-38.

ky fenomen duket se ka qenë universal, sepse gjendet tek pothuaj të gjitha etnitë e kontinentit në periudhën para shtetërore<sup>2</sup>. Por me veprim deri në ditët tona, në kombet e qytetëruara ndeshet rrallë. Në të drejtën tradicionale shqiptare, gjakmarrja përbën aspektin penal më kapital të saj, siç vërehet në kodin dokesor të maleve të njohur me emrin e Kanunit të Lekë Dukagjinit<sup>3</sup>, një kod që ka ardhur i përcjellë gojë më gojë deri në fillim të shekullit njëzet, kohë kur kleriku patriot At Shtjefën Gjeçovi e mblodhi me interesim dhe kujdes shkencor, duke realizuar një përmbledhje thujtë plotë, me çka ai tejkaloi një varg studiuesish vendas dhe të huaj, të cilët, gjer më atëherë kishin regjistruar vetëm në mënyrë të pjesshme lëndë kanunore. Vetë termi *kanun* na jep të kuptojmë që kemi të bëjmë me drejtësi, pra me ligj. Zanafillën termi e ka nga terminologjia bizantine, por studiuesit janë të mendimit se në gjuhën shqipe ka hyrë bashkë me okupimin osman. Fishta<sup>4</sup> qe ndër të parët që u mor me këtë çështje. Interpretimi i tij ishte vetëm në rrafshin etimologjik: Kanon – masë, rregull, vijë e drejtë. Por përcaktimi i saktë i burimit kërkonte të dhëna historiko-juridike të tjera. Siç pohon Valentini<sup>5</sup>: “*Para shekullit të kaluem nuk pashë kund, se xehet në gojë ndër të shkrueme Kanuni i Lekës; due me thanë me këtë emën. Tash quhet fjesht Kanuni i Malevet, o Kanuni i Lekës ose Kanuni i Dukagjinit; a u quejt që ma parë edhe Kanuni i Lekë Dukagjinit, a po asht ky nji kontaminacion burimi kulturor, nuk mund e vërtetova. Mua, as fjala Kanu nuk diej, a ka him në shqipet drejt për drejt nga byzantinja “Kanon” o “Nomokanon” a por me anë të turqishtes*”. Me këtë çështje u mor edhe Hasluck në veprën e saj *The unwritten law in Albania*<sup>6</sup>.

<sup>2</sup> Shih më gjerë: Cozzi, Ernesto.; *Marrja e Gjakut në malet e Shqipërisë së Epërme*. (La vendetta del sangue nelle Montagne dell Alta Albania, “Anthropos” revue, internationale d’ethnologie e de linguistique, Wien, tome V, fasc. 4, 1910, f. 655 - 687. Ky autor e sheh në radhë të parë gjakmarrjen tek të gjitha fiset dyndëse: gjermanët, keltët, sllavët etj. Ai thotë se gjakmarrja në romanë i përket burimit gjerman. Nisur nga ky fakt, meqë Iliria nga pikëpamja ligjore ishte e romanizuar, nuk përjashtohet që gjakmarrja të jetë rifutur për shkak të këtyre dyndjeve, në formë retrograde.

<sup>3</sup> Siç dihet Kanuni i Lekë Dukagjinit, mbledhë e kodifikue nga At Shtjefën Gjeçov, u botua si vepër postume nga etërit françeskanë në Shkodër 1993, por fillimisht nisi të botohej në faqet e Hyllit të Dritës.

<sup>4</sup> Fishta, Gjergj. Parathanie. Në: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër, 1933, f. XXVI.

<sup>5</sup> Valentini, Giuseppe: Studime dhe tekste juridike, Plejad, 2009, Tiranë, f. 265.

<sup>6</sup> Hasluck, Margaret: *The unwritten law in Albania*, Cambridge, University press,



Ajo pohon se: “Botuesi (i kanunit të Lekë Dukagjinit) me të drejtë e jep prejardhjen e termit nga greqishtja *Kانون* (rregull), por nuk e jep burimin interesant të këtij termi. Fjala *kanun* nuk rrjedh drejtpërdrejt prej greqishtes, sepse Shqipëria e Veriut nuk ka pësuar kurrë ndikim nga greqishtja, por nga turqishtja dhe arabishtja. Sipas profesorit H. A. R. Gibb, *kjo fjalë nga greqishtja është futur shumë herët në arabisht si qânûn, shumsi qawânîn. Juristët islamikë e përshtatën për të emërtuar një rregullim administrativ, për ta dalluar nga Ligji i Shenjtë (Shari’a), ndërsa shumë shekuj më pas Sulltanët Otomanë e përshtatën këtë term si kornizë për dekretet e tyre legjislativë. Arsyeja e futjes në përdorim të këtij termi ishte të mos përzihesh me Ligjin e Shenjt dhe të mos e modifikonte këtë të fundit. Pas pushtimit të Shqipërisë, zyrtarët turq të vendosur në këtë vend e quajtën kodin e Lekës në mënyrë të natyrshme si *kanun*.”<sup>7</sup> Një term tjetër i përdorur po aq shpesh, zakon, vjen nga sllavishtja që do të thotë ligj. Termi më i saktë e më kuptimplotë ngjan të jetë ai i përdorur nga Fishta *ligje dokesore*<sup>8</sup>. Edhe Martin Camaj mendon se termi i vjetër shqip ka qenë *dokë* nga *dukem*, dhe se *doket* (në shumës) do të thotë një përmbledhje e ligjeve të cilat përcaktojnë mënyrën e sjelljes me të afërmit dhe të huajt<sup>9</sup>. Megjithatë askush nuk mund të thotë me saktësi nëse kodi i ligjeve dokesore shqiptare i atribuohet me të drejtë autorësisë së Lekë Dukagjinit të III, një prijës bashkëkohës i Skënderbeut. Mbi këtë pikë, Fishta vëren se “nji palë thonë se quhet i Lekë Dukagjinit, për arsye qi ky Leka e paska mbledhë e kodifikue i pari... nji palë, se Kanuni quhet i Lekë Dukagjinit, jo pse ka kenë kodifikue prej Lekë Dukagjinit, por pse ka kenë zbatue ndër «Lekë» e «Dukagjin»”<sup>10</sup>, çka është në kundërshtim me këmbënguljen e traditës gojore që ndeshet shpesh në trajtë verdikti edhe në vetë*

---

1954; botimi shqip: Margaret Hasluck, Kanuni (ligji i pashkruar shqiptar) Enti botues Lisitan, Tiranë, 2005, përkthyer nga Leka Ndoja.

<sup>7</sup> Hasluck, Margaret. vepër e cituar, f. 25.

<sup>8</sup> Fishta, Gjergj: *Parathanie*. Në: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, përmbledhë e kodifikue nga A. Shtjefën Konstandin Gjeçov, O.F.M., Shtypshkroja françeskane, Shkodër, 1933, f. XXIV

<sup>9</sup> Camaj Martin: *Foreword*. In: *Kanuni i Lekë Dukagjinit* (The Code of Lekë Dukagjini), Gjonlekaj Publishing Company, Translated with an introduction by Leonard Fox, New York, 1989, f. XIII.

<sup>10</sup> Fishta Gjergj: Po aty f. XXVI-XXVII.

kanun, siç e la Leka. Lambertz<sup>11</sup> parashtron një hipotezë që nuk mund të mos merret në konsideratë: “Unë mendoj se në qytetet bregdetare të Shqipërisë së Veriut në sh. XIII-XV e drejta e zakonshme është quajtur nga noterët venedikas dhe nga venedikasit e tjerë që kishin të bënin me punët e së drejtës “*Lex Dukagjin*”, d.m.th. e drejta e vendit e bashkësisë fisnore ose e krahinës së Dukagjinit, siç thuhet edhe për lex Salica, Lex Burgundium, Lex Visigothorum. Pasuesit e tyre që nuk e dinin latinishten e morën emëroren *Lex* të latinishtes si gjinore të emrit shqiptar aq të zakonshëm për ta *Lekë-Leka*, d.m.th. *Lekës*”<sup>12</sup>. Kjo hipotezë mbetet për t’u vërtetuar. Edhe pse ka të dhëna për ekzistencën e një të drejte jo urbane, në territoret jashtë qyteteve në hapësirën shqiptare ende nuk ka dokumente që mund të vërtetonin hipotezën e Lambertz. Por, çështja mbetet e ndërlikuar. Argumentet etnologjike e lidhin domosdoshmërisht hartimin e një kodi ligjor të pashkruar me një autoritet imponues, të jashtëzakonshëm, me një ndikim përtej bashkësisë, të cilin mund ta ketë vetëm një “plak” i shquar për urtësi, gjykim të shëndoshë, dhe me mundësi udhëtimi të sigurve, që siç thotë Hasluck “*ky përjashtim është ligjvënësi antik Lek Dukagjini, i cili është kaq i shquar, saqë thëniet e tij janë kaq të shenjta sikur Bibla e Shenjtë për malësoret e Mirditës dhe të mbarë fiseve të veriut duke përfshirë këtu edhe territoret e fiseve që në vitet 1912-1913, iu trupëzuan padrejtësisht Jugosllavisë*”<sup>13</sup>. Pa përjashtuar argumentin etnologjik të Hasluck, duke mbajtur gjithnjë të padiskutueshëm domosdoshmërinë e një autoriteti, mendoj se në anën tjetër qëndron më bindës argumenti politiko-juridik, dhe këtu gjej me vend të theksoj atë që Valentini shtroi rreth një dekadë më parë se të dilte *Unwritten law* se “*thelbi i Kanunit të Malevet... asht pjesa kushtetuese ose statuore, rrajësisht e pandryshueshme republikane, përkundra sundimi i Dukagjinëve qe një sundim autokratik*”<sup>14</sup>. Rolin e autoritetit e luante kuvendi i maleve që me vendimet e veta ua kishte deleguar strukturave zbatuese pushtetin e administrimit ligjor të jetës së bashkësive. Në mbështetje të këtij pohimi, sipas Shuffaj, qëndrojnë

<sup>11</sup> Lambertz Maximilian.; *Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe emri Lekë në gjuhën shqipe*. Studime për nder të Prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit, Akademia e Shkencave e R.P.S.Sh., Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1986, f. 429 -431.

<sup>12</sup> Lambertz Maximilian. Artikull i cituar, f. 431.

<sup>13</sup> Hasluck Margaret, vepër e cituar, f. 23.

<sup>14</sup> Shih më gjerë: Valentini, Zef.; *Studime dhe tekste juridike*. Plejad. Tiranë, 2009, f. 279; 284 - 308.

*prova të qarta*<sup>15</sup> historike të kuvendeve shqiptare dhe të organizimit të bashkësive fisnore në njësi hierarkike shtetërore.

Sikundër dihet, kodi të cilit i referohemi nuk ka qenë i vetmi që ka funksionuar në hapësirën shqiptare. Në zona të ndryshme të vendit ka pasur edhe kode të tjera të cilat kanë vepruar deri në hyrjen e shariatit në fuqi, ndërkohë që gjatë pushtimit otoman në disa zona të tjera kemi edhe kompromise mes shariatit dhe së drejtës dokesore vendase siç është rasti i Kanunit të Skënderbeut që zbatohet deri vonë në Krujë, Mat e Kurbin e Dibër. Edhe ky kanun e ka njohur dritën e botimit, mbledhur dhe kodifikuar nga një tjetër klerik katolik, imzot Frano Ilia<sup>16</sup>. Variante krahinore të së drejtës dokesore<sup>17</sup>, vazhdojnë të dalin në dritë nga studiues të tjerë. Gjithashtu njihet edhe ekzistenca e disa kodeve të tjera si Kanuni i Sulit, etj. që duhet të kenë pushuar së qeni në fuqi aty nga fundi i shekullit XVIII ose fillimi i XIX, dhe shkak i është pikërisht sheriati. Në përgjithësi, kur bie fjala për të drejtën dokesore, studiuesit, pohojnë se kanuni është një, Kanuni i Maleve, dhe se emërtimet kanë të bëjnë me variantet krahinore<sup>18</sup>. Gjithashtu, studiuesit i referohen Kodit të Lekë Dukagjinit, meqenëse influencat e ligjeve të huaja në të ngjajnë më të kufizuara se në kodet e tjera të vendit.

<sup>15</sup> Šufflay, Milan. *Srbi i arbanasi*. Serbët dhe shqiptarët. Botimet Toena. Përkthyer nga Hasan Çipuri. Tiranë, 2004, f. 78 - 85.

<sup>16</sup> Ilia, Frano.; *Kanuni i Skanderbegut*. (Mbledhë e kodifikue nga Dom Frano Ilia) Editrice La Rosa. Milot 1993. f. 225.

<sup>17</sup> Si botime më të rëndësishme mund të përmenden: Xhemal Meçi, “*Kanuni i Lekë Dukagjinit - varianti i Pukës*”, Tiranë 1996; idem: “*Kanuni i Lekë Dukagjinit në variantin e Mirditës*”, Tiranë 2002; Shefet Hoxha, “*Instituti i kuvendit në Lumë - punim etnologjiko-historik*”, Tiranë 2002; Xhafer Martini, “*Kanuni i maleve të Dibrës*”, Tiranë 2003; idem, “*Kanuni i Dibrës*”, Tiranë 2007; ibidem: “*Gjakmarrja: komente, raste, situata*”, Tiranë 1999; Ismet Elezi, “*E drejta etnozakonore e Labërisë*”, Tiranë 2002; idem: “*Kanuni i Labërisë*” - “*Kanuni i Papa Zhulit*”, Tiranë 2006; Fadil Mehmeti, “*Kanuni i Malësisë së Madhe e të Malësisë së Lezhës*”; Haxhi Goci, “*Kanuni i Çermenikës, Martaneshit, Bendës*”; Shahin Zharri, “*Kanuni i Çermenikës ose kanuni i Musë Ballgjinut*”; Pal Doçi, “*Vetëqeverisja e Mirditës: vështrim etnologjik e historik*”, Tiranë 1996. Shih më gjerë: Doçi, Pal.; *Për Kanunin*. GEER. Tiranë. 2003. f. 86. Nga ky autor shih edhe: *Studiues pak të njohur të së drejtës dokesore shqiptare*, Kultura popullore, 1-2 1992, (A. Sh. R.Sh, I.K.P.), f. 111 - 117.

<sup>18</sup> Shih më gjerë: Doçi, Pal.; *Për Kanunin*. GEER. Tiranë. 2003. f. 86. Nga ky autor shih edhe: *Studiues pak të njohur të së drejtës dokesore shqiptare*, Kultura popullore, 1-2 1992, (A. Sh. R.Sh, I.K.P.), f. 111 -117.

Studiuesit mendojnë se disa nga doket e përshkruara në kanun mund të datohen nga periudha e hershme e antikitetit, se e drejta dokesore shqiptare burimin e ka në ligjet e vjetra të vendit dhe se në rrjedhën e historisë ka ardhur duke u modifikuar e evoluar. Kësisoj, ata kanë vënë re shtresa të ndryshme kohore, por edhe ndikime të kodeve të huaja, përkime me kodet e tjera, dhe padyshim, edhe ndikime të së drejtës pozitive. Në formën e trashëguar kanuni paraqitet si një gërshetim mes së drejtës agrare të fshatit mesjetar dhe elementeve të së drejtës së lashtë të katundit shëtitës baritor. Sipas Shufflajt, faza kur ka ndodhur kjo shkrimje daton “nga shek. XIV, kur filluan të prisheshin që nga themeli organizimet shoqërore të centralizuara të shtetit bizantin e serb; kur në shek. XV turqit fshinë dinastitë e vogla; kur qytetet shumë të vjetra vdiqën prej vdekjes filektike, - atëherë ra ora e fshatit të bariut, që kishte trashëgiminë e kohës së lashtë, i armatosur me hobe, me një shkop të trashë dhe me një shigjetë helmuese, i shtytur nga instinkti për vetëmbrojtje; me hakmarrje, me besë dhe me lidhje gjaku (vëllamë). Ai fshiu fshatrat e buta në fusha dhe së bashku me to, organizimet juridike bizantine e serbe”<sup>19</sup> “Kështu, duke përfshirë katundi fshatra të fuqishme të luginës, ai mori me vete dy elemente të reja, një element ushtarak dhe tjetrin ligjor.”<sup>20</sup> Kjo përkon me lindjen e brezit të tretë të fiseve shqiptare. Pra, janë rrethanat historike të pas pushtimit otoman të vendit që duke shkatërruar strukturën demografike të popullsisë, rendin dhe organizimin qytetar, rendin dhe organizimin e fshatit të kulturuar të fushës, diktuan një raport të ri në këtë strukturë. Duke gjetur ndër male kështjellat natyrore për qëndresën antiosmane, popullsia shqiptare u transformua në një popullsi më së shumti malësore. Pashko Vasa, tek “Bardha e Temalit”, shumë kohë më parë se Shufflaj të formulonte këtë tezë, duke përshkruar qëndresën antiosmane pas pushtimit të Shqipërisë shprehet në këtë mënyrë: “ *Malësorët, numri i të cilëve ishte rritur prej fusharakëve që iknin nga sundimi turk, nuk deshën ta njihnin pazarllëkun e bërë midis Dogjit të Venedikut dhe sulltanit. Të nxjerrë jashtë ligjit, të bllokuar atje në shkrepat ku kishin zatetur, ata s’u përkulën kurrë, por qëndruan burrërisht; qëndresa e tyre që këmbëngulëse, dhe ata e vazhduan luftën gjersa qeveria otomane u dha si shpërblim për pajtimin e tyre njëfarë vetqeverisje, e cila, duke*

<sup>19</sup> Shih Šufflay Milan.; *Srbi i arbanasi*, Botimi shqip Serbët dhe shqiptarët, Toena, Tiranë, 2004, Përkthyer nga kroatishtja Hasan Çipuri, f. 76 - 77.

<sup>20</sup> Šufflay, vep. e cit. f. 79.

ua njohur të gjithë të drejtat e njerëzve të lirë, i ruante nga ndjekjet dhe padrejtësitë e ngadhnjimitarëve dhe i shpëtonte nga poshtërimet që u bënin turqit, në ato kohë barbare...”<sup>21</sup>. Ky përshkrim i jep të drejtë përkufizimit të Pal Doçit se “mali ka qenë njësia themelore administrative dokesore e votrave të qëndresës antiosmane”<sup>22</sup>. Ajo që vihet re së pari nga vlerat e të drejtës dokesore në rrafshin historik, është të ushqyerit e pandërprerë të disa tipareve etnoidentitare shqiptare: ndjenjën e lirisë, guximin, nderin, besnikërinë dhe shpirtin e flijimit. Pa këto virtyte asnjë popull nuk mund t’u mbijetojë vërshimeve tragjike të historisë. Sado që mund të tingëllojë romantike, për fat, është e vërtetë.

---

<sup>21</sup> Vasa, Pashko.; *Bardha e Temalit*. (Vepra 2.) Tiranë, 1987, f. 22. Titulli i origjinalit *Bardha de Temal. Scenes de la vie albanaise*. Përkthyer nga Sotir Caci.

<sup>22</sup> Doçi, Pal.; *Për kanunin*. GEER, 2003, f. 10.

### ***Kanuni në duart e studiuesve të huaj***

Kanuni ka tërhequr që herët dhe vazhdon të tërheqë vëmendjen e shumë studiuesve seriozë shqiptarë dhe të huaj. Hahn<sup>23</sup>, Hecquard<sup>24</sup>, Cozzi<sup>25</sup>, Talloçzy<sup>26</sup> Durham<sup>27</sup>, Nopça<sup>28</sup>, etj.<sup>29</sup> Këta ishin kryesisht Noca vrojtues, mbledhës dhe botues të lëndës dokesore në terren, por edhe interpretues të përpiktë që pasuruan mendimin shkencor albanologjik në fushën e studimeve të traditës etnojuridike shqiptare. Si studime me vlerë të rekomanduara për të gjithë të interesuarit në fushën kërkimore të së drejtës dokesore shqiptare veçohen tri vepra: Zef Valentini «La

- <sup>23</sup> J. G. V. Hahn.; *Albanisische studien*, Jena, 1854. (Botimi shqip: Studime shqiptare, Tiranë, 2007, Kreu i shtatë: Kushtetuta e fiseve të Malësisë në Ipeshkvinë e Shkodrës, f. 237 - 249).
- <sup>24</sup> Louis Hyacinthe Hecquard.; *Histoire et description de la Haute Albanie ou Guegerie*, Paris, f. 364 - 372. Botimi shqip (Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së Epër ose i Gegërisë, Plejad, 2008, përkthyer dhe pajisur me shënime nga Oriana Tamburi, f. 520).
- <sup>25</sup> Ernesto Cozzi.; *Marrja e Gjakut në malet e Shqipërisë së Epërme*. (La vendetta del sangue nelle Montagne dell Alta Albania, "Anthropos" revue, internationale d'ethnologie e de linguistique, Wien, tome V, fasc. 4, 1910, f. 655-687. Për lehtësi, materiali gjindet edhe në shqip, përkthyer nga Willy Kamsi, në bibliotekën françeskane Shkodër. Lëndën juridike të mbledhur nga Ernesto Cozzi, më 1944, e botoi Zef Valentini, duke kodifikuar në tre libra: I) E drejta civile (familja, miqtë, prona); II) E drejta penale (kundrime paraprake, krime kundër njeriut, krime kundër pronës, ligje të posaçme vendore, procedurat); III) Struktura politike (fisi, bajraku, qeverisja e fisit e bajrakut dhe nëndarjet). Për Marrja e gjakut në Malet e Shqipërisë së Epër, do t'i referohemi përkthimit në dorëshkrim (të daktilografuar) të Willy Kamsit.
- <sup>26</sup> Ludvig v. Talloçzy.; *Kanuni i Lekës*, "Illyrisch-Albansche Forschungen" 1, München und Laipzig, 1916, f. 409-459
- <sup>27</sup> M. E. Durham: *High Albania (Shqipëria e epërme)*. London, 1909, f. 19-38. Gjithashtu: *Some tribal origins and customs*. London, 1928.
- <sup>28</sup> Nopcsa, F.; *Die herkunft des nordalbanisch Gewohnheites Rechtes*. Në: "Zeitschrift für Vergleichende Rechtswissenschaft" XL Band, Berlin; Gjithashtu: *Albanian, die Bergstämme nordalbaniesns und ich Gewohnheitrecht*, Manuscript, në: AIH, dosja E -1-40, f. 316. (Përkthimi shqip i dorëshkrimit i përket arkivit të Etnografisë së Institutit të Kulturës Popullore).
- <sup>29</sup> Për më tepër informacion shih: Kahreman Ulqini, *Kundrime etnologjike*, Camaj-Pipa, shkodër 2007, kap. "Orvatje për sistemimin dhe botimin e korpusit të së drejtës popullore shqiptare, f. 7-23. Shih gjithashtu edhe Pal Doçi, *Studiues pak të njohur të së drejtës dokesore shqiptare*, Kultura popullore, 1-2 1992, A. Sh. R. Sh., I. K. P., f. 111-117

famiglia nel Diritto Tradizionale» in Annali Leteranensi, vol IX, 1945 fq. 9 - 212<sup>30</sup>; Zef Valentini «Il diritto delle comunita nelle tradizione giuridica albanese». Firenze: Valecchi 1956<sup>31</sup>; Margaret Hasluk<sup>32</sup> “The Unwritten law in Albania”, Cambridge University press, 1954. Kahreman Ulqini sugjeron që në këtë rang të merren edhe “kërkimet shkencore të Ernesto Cozzi, misionar katolik me vëzhgime të përqendruara në krahinat e Malësisë së Madhe, Dukagjinit, Postribës dhe Rranxave”<sup>33</sup>. Kohët e fundit ka tërhequr vëmendje vepra e studiuesit japonez Kazuhiko Yamamoto<sup>34</sup>. Konkluzionet e këtij studiuesi, rezultat i një analize të gjatë e të thellë krahasuese, përmbliidhen në idenë se kanuni është shembull i aftësisë së një shoqërie për t’u organizuar në kushtet e mungesës së një rendi të mirëfilltë shtetëror. Përpjekje janë bërë edhe në drejtim të përkthimit të kanunit në gjuhë të huaj, një sipërmarrje shumë e vështirë, për shkak të gjuhës specifike që ka lënda dokesore. Megjithatë, edhe në këtë aspekt ka pasur suksese. Camaj<sup>35</sup> vlerëson dy përkthime të arrira: ai i vitit 1941, në gjuhën italiane, dhe tjetri nga studiuesi Leonard Fox, përkthyesi i kanunit në gjuhën angleze. Ky përkthyes e ka shoqëruar botimin e vet me shënime mjaft të vlefshme të përmbledhura në hyrjen (introduction) e librit. Së fundmi, Kanuni është përkthyer edhe në gjuhën japoneze. Ekziston edhe përkthimi i këtij kodi edhe në rusisht. Pal Doçi shprehet se “Megjithëse kanuni ynë paraqet vështirësi të madhe për t’u përkthye nga një krahasim i shpejtë me tre të tjerët (është fjala për përkthimet në italisht, gjermanisht dhe anglisht), mund të thuhet se përkthimi në gjuhën ruse, asht në nivelin e

<sup>30</sup> Valentini, Giuseppe (Zef).; “La famiglia nel Diritto Tradizionale”. Në: Annali Leteranensi, vol. IX, 1945, f. 9 - 212.

<sup>31</sup> Valentini, Giuseppe (Zef).; “Il diritto delle comunita nelle tradizione giuridica albanese”. Firenze: Valecchi, 1956. Bot. Shqip. “E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare”. Plejad. Tiranë, 2007. Përkthyer nga Dritan Thomollari.

<sup>32</sup> Huslock, Margaret.; Vep. e cituar.

<sup>33</sup> Shih: Ulqini, Kahreman.; *Kundrime etnologjike*. Camaj - Pipa. Shkodër, 2007, f. 25 - 35.

<sup>34</sup> Kazuhiko Yamamoto.; *The ethical structure of Kanun and its cultural implications* (Struktura etike e kanunit dhe nënkuptimet e saj kulturore (përktheu dr. Selahedin A. Velaj, 2005, mars, U.S.A). Gjithashtu: *Gjakmarrja*, Albanian highlander’s “Blood Feud” as social obligation”, Tiranë, 2005.

<sup>35</sup> Camaj, Martin.; Foreword. Vep. e cit., f. XIV - XV.

përkthimeve në gjuhët e tjera të Europës”<sup>36</sup>.

Sigurisht, jo gjithmonë, të huajt, udhëtarë, reporterë apo eksploratorë, të cilët, kanë pasur një kontakt me botën dokesore shqiptare në terrenin e gjallë, janë shprehur me objektivitet shkencor. Valentini, do të shkruante jo pa indinjatë: *“Prandej tham, se gabohen në mënyrë të shëmtueme ca publiqista qi, mbas nji udhtimi të shkurtën e nji studimi sypërfaqer të botës karakteristike shqiptare, nyejnë pendën e i paraqesin Europës, Kanunin e Malevet si hiç gja tjetër, por vetëm si kodifikimi katil i gjakmarrjes”*<sup>37</sup>.

Po çka përmban kanuni dhe cila është pjesa që zë gjakmarrja në të? Kanuni përmban të gjitha rregullat dhe ligjet, mbi të cilat mbahej shoqëria tradicionale shqiptare, të përcaktuara në 1263 paragrafë të formuluar në trajtë nenesh që përcaktojnë normat e sjelljes e të marrëdhënieve njerëzore në bashkësi, të drejtat dhe detyrimet, çështjet e pronësisë dhe çështje të tjera civile, kryesisht ato që rregullojnë marrëdhëniet brenda familjes, ekonomike, trashëgiminë, martesën etj. Në kanun janë të përcaktuara edhe strukturat që gjykojnë mbarëvajtjen apo shkeljet në këto marrëdhënie, duke vendimuar sipas rastit edhe dënimet përkatëse të parashikuara sipas kanunit. Gjakmarrja bën pjesë në ndëshkimet që parashikon kanuni, që fillon me gjobën deri tek dëbimi apo djegia e shtëpisë. Studiuesit shqiptarë e kanë përkufizuar gjakmarrjen si penalitet, natyrisht si dënimi më i rëndë që parashikon kanuni, me funksion të qartë të kufizimit të vrasjeve, meqenëse jeta e njeriut është vlera më e çmuar në tokë. Ata janë përpjekur të bëjnë dallimin mes gjakmarrjes si penalitet dhe hakmarrjes si akt barbar. Gjakmarrja trajtohet kryesisht në kreun 22 të kanunit. Në të është përcaktuar se kur bie në gjak një familje dhe kur dënimi është më i lehtë. Në gjak një familje bie kur një pjesëtar i saj ka vvarë një individ jashtë gjakut (fisit). Megjithatë, në të vërtetë, është fyerja ajo që e shkakton ndezjen e dhunës shpaguese. Hecquard, pati vërejtur se “Rrëmbimi, përdhunimi, ose joshja e një vajze të re konsiderohen si një çnderim shumë i madh që familja nuk mund ta falë dhe ai që e ka kryer këtë duhet herët a vonë ta shlyejë me gjakun e tij”<sup>38</sup> Dënimet më të lehta jepen atëherë kur kemi të bëjmë vetëm me plagosje. Por gjoba është e parashikuar të paguhet

<sup>36</sup> Doçi, Pal. Vepër e cituar, f. 61.

<sup>37</sup> Valentini, Zef.; *Studime e tekste juridike*, f. 289.

<sup>38</sup> Hecquard, Louis Hyacinthe. Vepër e cituar, f. 339.



edhe në rastet e vrasjeve. Në këtë kapitull është përcaktuar edhe besa, një institucion shumë i rëndësishëm, e cila u jepet për një afat të caktuar familjarëve të ngjuar të gjakësit (vrasësit), madje edhe vetë vrasësit nëse ai e ndjen të shkojë në funeralin e të vrarit. Kanuni në këtë kapitull, më saktë në paragrafët 969 – 972 ka përcaktuar mënyrat e pajtimit, ku rol luajnë dashamirët e familjeve në gjak, famullitari, krerët e fiseve, bajraktarët (flamurtarët). Pajtimi mbyllet me një drekë ku marrin pjesë burrat e familjeve në gjak dhe ndërmjetësuesit bashkë me garantët apo dorëzanët e pajtimit.

Interesant është se në ditët e sotme, megjithëse nuk ekzistojnë struktura të mirëfillta kanunore që garantojnë pajtimin apo marrëveshjet mes palëve në gjak, misionarët që merren me pajtim, nuk kanë raportuar raste të shkeljes së besës dhe të pajtimit, ndërsa rituali i ceremonisë zhvillohet me përpikëri. Ndoshta, duhet pranuar se e drejta dokesore ka gdhendur thellë psiken dhe karakterin e popullit tonë, saqë i ka të dukshme ende gjurmët e veta aty edhe tashmë kur ka kaluar një shekull nga anulimi i statusit ligjor të saj.

**Gëzim H. JUKA**

## **NJË MONUMENT I MUNGUAR PËR TRE KLERIKË PATRIOTË**

Në historinë mijëvjeçare të qytetit të Shkodrës ndeshemi me qëndrime të ndryshme në vite ndaj disa ngjarjeve e personazheve politikë e historikë. Veçanërisht me rëndësi është interpretimi e qëndrimi ndaj këtyre ngjarjeve pas shpalljes së pavarësisë, pra nga 1912 e deri më sot. Si referencë këto kohë të fundit përdoret truku “Në anën e duhur të historisë” duke patur në plan të parë Luftën e Dytë Botërore dhe forcat partizane komuniste. Pasi nuk kanë asnjë mundësi të mburren me periudhën e komunizmit ku përveç luftës së klasave dhe vrasjeve të komunistëve me njëri-tjetrin, ku Shkodra mbeti pa asnjë figurë historike komuniste atëherë po mbahemi tek Lufta e Dytë. Kështu që mbahen pas “Në anën e duhur të historisë” duke evidentuar që forcat komuniste e partizanët ishin aleatë të anglo-amerikanëve dhe rusëve të cilët fituan luftën.


Po qyteti ynë Shkodër a ka një qëndrim të tijin për historinë?! Ose si ka reaguar në vite?! A ka qenë në anën e duhur të historisë?!

Në tetor të vitit 1912 filloi Lufta Ballkanike kundër Perandorisë Osmane. Në një shikim të parë do themi që shqiptarët kanë realizuar sa kryengritje kundër Turqisë. Jemi mburrur me kryengritjet e Malësisë mbi Shkodër dhe figurat drejtuese të saj. Sipas kësaj del që Shkodra duhej të bashkohej me Malin e Zi dhe Serbinë dhe të ishte në “anën e

duhur të historisë” kundër pushtuesit shekullor osman. Jo, nuk mund të ndodhte kështu prandaj ne mburremi me rezistencën shtatë mujore kundër serbëve e malazezve. Rrethimi i Shkodrës është historia dhe qëndresa jonë. Hynë në Shkodër banorët e fshatrave rrotull dhe zunë vend në shtëpitë e shkodranëve. Erdhën nga Shijaku e zonat përreth një numër ushtarësh “ Redifë” nën komandën e Esat Pashë Toptanit. Ushtria e turkut e komanduar nga Valiu Hasan Riza Pasha. Të gjithë sëbashku në luftë kundër malazezve. Edhe kur u vra Hasan Riza Pasha përsëri rezistenca vazhdoi me sukses gjer kur erdhi lajmi që Europa e la brenda kufirit shqiptar Shkodrën.

Në Luftën e Parë Botërore përsëri Shkodra në shumicë ishte me Austro-Hungarinë e cila ishte aleate me Gjermaninë etj. Nuk harrohej roli i Austro-Hungarisë në krijimin e shtetit shqiptar. Epo Anglia, Franca, Rusia në aleancë me Serbinë e Greqinë duke patur aleat Esat Pashë Toptanin fituan luftën dhe janë në “anën e duhur “ të historisë. Shkodra përsëri mendoi që ana e duhur është këndeje.

Mora vetëm këto dy shembuj nga fillimi i shtetit shqiptar. Nisur nga sa më sipër desha të referohem në fundin e Luftës së Dytë dhe a jemi në “anën e duhur” të historisë! Për këtë gjithnjë më ka ngacmuar kujtesën se çfarë përfaqësonin tre emrat që po trajtoj në vazhdim. Për Patër Anton Harapin, Patër Lekë Lulin e Dom Luigj Picin janë shkruar me dhjetra punime bile shumë cilësore. Ndërsa unë në vazhdim do bëj një prezentim të shkurtër të tyre dhe si e mendoj unë se çfarë përfaqësojnë për ne, në Shkodër.



### *Patër Anton Harapi*

Atë Anton Harapi OFM lindi në Shirokë të Shkodrës me 5 janar 1888. Shkollën fillore e kreu po aty ndërsa gjimnazin në Kolegjin Françeskan në Shkodër. Mësimet e larta i kreu për teologji në Austri. Kthehet në atdhe si meshtar i Shën Françeskut deri në 1920. Shërbeu si famullitar në Grudë që sot është në Mal të Zi. U emërua drejtor i Kolegjit Françeskan e më

pas drejtor i gjimnazit “Iliricum” ku dha lëndën e filozofisë. Në vitet 1923 – 1924 ishte pjesëtar i ekipit të gazetës opozitare të asaj periudhe

“Ora e Maleve”. Provincial i Françeskanve në vitet 1941- 1944. Në periudhën tetor 1943 – 1944 iu kërkua dhe besua udhëheqja e shtetit shqiptar si anëtar i Këshillit të Naltë ( Regjenca) detyrë që e filloi në janar 1944 kur erdhi leja nga Vatikani dhe qëndroi gjer në 23 tetor 1944. Pas lufte u arrestua dhe u dënua nga një gjykatë speciale me pushkatim paradoksalisht si kriminel lufte. Vendimi u zbatua me 20 shkurt 1946.

Duke qenë klerik ai pranoi të vinte emrin e tij në sakrificë për atdhe. Atë Anton Harapi asnjëherë nuk ishte perkrahës i mbretit Zog por me pjesëmarrjen e tij në Këshillin e Naltë që ishte organ që zevendësonte mbretin paraqiti impenjimin e tij për shtetformin dhe vazhdimësinë e shtetit shqiptar të para luftës.



### ***Patër Lekë Luli***

Patër Lekë Luli (Aleksandër Luli) lindi në mars 1908 në Kastrat. Mbaroi Kolegjin Françeskan në Shkodër dhe Kolegjin e Shna- Ndout në Romë. Docent në Gjymnazin “Illyricum” dhe për një kohë drejtues i Shoqërisë Antoniane. Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia në 7 prill 1939 angazhohet në pjesëtarët e rezistencës. Arratiset në Jugosllavi në fund 1939 dhe dorëzon në Legatën Angleze në Beograd një perkujtesë që është akuzë ndaj pushtuesit. Pas pushtimit të Jugosllavisë në prill 1941 nga Italia e Gjermania internohet në Itali. Pas kthimit nga internimi angazhohet në krah të forcave monarkiste me Abaz Kupin. Zgjidhet Sekretar i Legalitetit (OKLL) në shtator 1943. Në 7 dhjetor 1943 do jetë në grupin perfaqësues të Legalitetit në takim me Nacionalçlirimtaren. Do jenë Abaz Kupi, Patër Lekë Luli, Jahja Caçi, Dr. Shefqet Ndroqi. Nga ana e Frontit ishin Enver Hoxha, Ymer Dishnica, Nako Spiro, Fetah Ekmekçiu. Në takim nuk u ra dakord për vazhdimin e luftës së përbashkët. Me 19 dhjetor 1943, pas katër viteve zogistët u larguan nga Fronti. Në korrik 1944 do të shoqëronte sëbashku me shokë e tij një grup oficerësh aleat anglo-amerikan. Në Tropojë u bë një takim i disa forcave luftarake. Në fjalën e tij Patër Lekë Luli është shprehur kundër komunizmit. Pas largimit nga anglezët, sëbashku me një shoqërues, është nisur në drejtim të Shalës. Aty janë vrarë nga efektivet e batalionit

“Perlat Rexhepi”. Në fillim nuk dihej se si u vranë, por më vonë ish-komandanti i batalionit partizan Rexhep Haka në kujtime të tij jep të dhënën që u vranë dhe iu gjetën kushtetuta e vitit 1928, 53 sterlina angleze dhe sende personale. Konsiderohet i pari klerik katolik i vranë nga komunistët. Vrasja ndodhi me 16 korrik 1944.

Në ilustrim të veprimtarisë tij:

Jepet shkresa e Ministrisë të Brendshme mbi reagimin pas arratisjes së Patër Lekë Lulit:

*Mbretëria Shqiptare*

*Ministria e Punëve të Brendshme*

*Spektori Politik*

*Tiranë me 25.11.1939*

*Prefekturës Shkodër*


*Informohemi që keni dhanë me shkresë tuaj nr. 200 res. dt. 20.11.1939 ka një randësi e karakter urgjent prandej e donte të ishte transmetue në kohën e duhur. Përveç kësaj lajmërimi është i metë pse nuk perman as datën e arretisjes as cirkostancat në të cilat Patër Lekë Luli ka mundur të përftojë arratisjen nga Leshi në Jugosllavi. Të porositet nënprefekti i Leshit që këtyre ngjarjeve t’u japi rëndësi të veçantë në mënyrë që të mos ngjasin të tilla arratisje e kur vertetohen të lajmërojë menjëherë e telegrafisht. Na njoftoni prandej se ku qëndron gabimi.*

*Ministri  
Maliq Bushati*


(AQSH. F. 152, V. 1939, D 29, fleta 209)

Pas lirimit nga internimi Patër Lekë Luli kalon në mal tek çetat zogiste.

Shkresa më poshtë shpreh shqetësimin që Patër Lekë Luli sapo u lirua nga internimi kaloi në anën e rebelëve.



Shkresë e kryeministrit Mustafa Kruja mbi lirimini nga internimi të Patër Lekë Lulit  
 “.....pak ditë mbas kthimit të tij i nalt-përmenduni kaloi në anen e rebelve ku asht tue zhvillue veprimtari aktive sovversive... Ministria e P. të jashtme mbasi u informua mbi sa më sipër ka ngarkuar këtë Delegatë t'i terheqë vretjtjen asaj qeverije mbi ngjarjen.....”.

  
**MBRETNIA SHQIPTARE**  
**KUËSTURA MBRETNORE E SHKODRËS**

-1AGG...  
 -1AGG/3 XXI  
 ZONJEN CENTRALE

Nr. 0755. i Prot. Shkodër, 30/7/1943/XXI  
 Gjegje e shkresës Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_  
 Lidhje copë \_\_\_\_\_

LANDA: Manifestime të hedhura në ket gjytet ma daten 27  
 mejit vazhdues, të shkrueme prej Françeskanit Lek  
 Luli qi gjindet i aratisun.


DREJTORIS BERGJITHSHME POLICIS.  
TIRANË.  
 e, p, nje, PREFEKTURES MBRETNORE.  
K E T U.

Me daten 27 vazhdusit ndërë orët e para të mëngj  
 esit janë gjetun të hedhura nën dyert e banesave  
 të Katolikve në lagjen Rus të këtij gjytetit  
 manifestime me karakter Nacionalist, ku janë të f  
 firmueme prej Françeskanit Lek Lulit.  
 Ktu ju bashkaxjesim ka një kopje.

Janë marrë masat e duhuna për shtimjen në  
 dorë të guximtarit, ku deri tash kanë shauua për  
 fundime negative.

### Njoftim i Kuestures Shkoder me 30 korrik 1943

*Me daten 27 të vazhduesit në orët e para të mëngjesit janë gjetur të hedhura nën dyert e banesave të katolikve të lagjes Rus të këtij qyteti manifestime me karakter nacionalist ku janë të firmume prej Franceskanit Lekë Lulit.*



Përmyllja e manifestit të Pater Lekë Lulit drejtuar Rinisë Katolike dhe shpërnda në lagjen Rus 17 korrik 1943 viti V i robnisë .

Në vazhdim: Shkresë e Drejtorisë së Policisë në korrik 1944 ku pershkruhet se një grup oficerësh anglo-amerikanë të shoqëruar nga Patër Lekë Luli nga Kastrati, Ndue Pjetër Prenga nga Kodër Spaç, Mark Jak Bajraktari nga Kashnjeti, Pashko Curri nga Fushë Arrësi, Ymer Bardhoshi nga Puka me rreth 30 vetë e me kuaj kanë kaluar nga Selita e Matit nëpër Orosh e në drejtim të Tropojës dhe janë ka mbledhin vullnetarë për luftë etj.



0065I Res. 31 KORRI 1944

Mbi udhëtimin e Oficerave të Anglezë e Amerikanë në Qarkun e Shkodrës dhe formimin e qetave të armatosuna.-

P. T.  
**MINISTRITË P. TË MBRENDËSHME**  
 - Zyra e Politikës - TIRANË

Për dijeni kemi marrë me ju njoftue tekstualisht shkresën e Komiserisë Policie të Shkodrës.-

" Parashikojmë se me datën 17 të k.m.ardhur prej Selitës së Matit një numër prej 15 Oficerave të Anglezë e Amerikanë, midis tyre një Kolonel, një Major, një Kapiten e dy Togera të Anglezë, t'udhëqen prej t'arratisunvet politikë Shqiptarë:-

- 1) Patër Lek Luli nga Kastrati i Shkodrës.-
- 2) Ndus Pjetër Prenga nga katundi Koder Spaç e Komunes Qendres Mirditë.-
- 3) Mark Jak Bajraktari nga Kashnjet i Komunes Kalivaq.-
- 4) Pashko Curri katundi Fushë e Arrësit Komunes Spaçit.-
- 5) Ymer Bardhoashi nga Puka; kanë pasqë edhe 30 persona shqiptarë e disa e disa kuaj tue kalue në Orosh kanë qendruer një natë në Oborr e qelitë Ipeshkvisë atyshm (në rrethet e Ipeshkvisë i cilli ndodhëj në Shkodër).-

Prej Mirditës kanë marrë drejtimin për Tropojë.-

Mbas lajmërimit të nënprefektit të Mirditës, personat Shqiptarë që u shënuen ma nalt, në këto ditë t'afërme kanë fillue e rregjis-trojnë vullnetarë për me formue qeta të armatosuna, tue u pratur pagimin e rrogës me lira Sterlina (sasia e rrogës nuk dihet).-

Tuhet se këtu fuqi do e kanë nën komandë:  
 Pashko Curri Fusha Arras  
 Pjetër Prenga në rajonin Koder Spaç  
 Mark Jak Bajraktari në Kashnjet të Komunes Dibrit

Nënprefekti i Mirditës shton se këto qeta mund të shtohen të shtytun nga gjendja e keqe ekonomike e popullit atyne visevet.-

Mbi qeshtjen Prefektura ka vënë në dijeni Ministrinë e P. të Mbrendëshme:-

Nga organet e Sigurimit Publik të Qarkut nuk asht marrë ndonjë masë, e, për këto nevojitet të shkojë në vend një detashment me ba ndjekjet-

DREJTORI PËRGJITHSHEM I POLICISË  
 ( Tahir Kolgjini )

Q.S.H. 157

Shkresa e sipercituar ku Patër Lekë Luli ka shkuar në Tropojë.




### ***Dom Luigj Pici***

Dom Luigj Pici, i lindur në Ulqin me 17 mars 1907, kreu shkollën teologjike në Padova. Në vitin 1926 do shugurohej prift dhe do fillonte veprimtarinë në Malin Kolaj. Në 1930<sup>ën</sup> do kalonte në famullinë e Reçit. Dom Luigji jepte mësim shkrim e kendim djemve të Reçit pa dallim besimi fetar. Në ditët e pushtimit të 7 prillit Dom Luigji, në krye të malësorëve, protestonin tek nënprefektura në Koplik duke kërkuar armë. Që atë ditë Dom Luigji do ishte një luftëtar i rezistencës. Me 27 prill 1943 u krijua Këshilli Provizor i Luftës Nacionalçlirimtare, ku Dom Luigj Pici do të ishte një nga të zgjedhurit në kryesi krahas kryetarit Hysen Draçini e sekretarit Shaban Arra, me pjestarë Dom Luigj Pici, Sadik Bekteshi, Zija Dibra, Mark Ndoja, Selfixhe Broja, Qazim Kapisyzi, Shyqyri Hafizi, Pop Llazar Jovani, Sabri Gjilani.

Ndërsa me 12 tetor 1943 u zhvillua Konferenca e Dytë ku u zgjodhën: Riza Dani-kryetar, Jorgji Karamitri-n/kryetar, anëtarë: Shyqyri Hafizi, Dom Luigj Pici, Pop Llazar Jovani, Sadik Bekteshi, Mark Ndoja, Selfixhe Broja, Kolë Prela, Zija Dibra, Sabri Gjilani, Hysen Draçini, Ramadan Reçi, Qazim Kapisyzi, Rexhep Haka, Shaban Arra.

Pas lufte, Dom Luigj Pici do jetë në kryesi të Frontit Demokratik. Me fillimet e gjyqeve kundër klerit dhe shumë figurave nacionaliste nuk do të ishte dakord dhe do të dilte dëshmitar në mbrojtje të klerikëve katolikë. Më 10 prill 1946, në gazetën “Bashkimi” shkruhej që “Në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik përjashtohen për dëshmi në gjyq politik në favor të të pandehurve Hysni Peja e Dom Luigj Pici”. Më 10 nëntor 1946, do gjindej i vrarë në një rrugë të Malësisë. Më 6 qershor 1947, në gazetën zyrtare do të shkruhej: i hiqen dekoratat “Me urdhën të flamurit” Gjergj Kokoshit, Dom Luigj Picit dhe Rexho Plakut.

Nuk ka nevojë për më shumë argumente kjo histori, por një prift katolik nuk mund të vazhdonte më tej me komunizmin.

  
**MBRETNIJA SHQIPTARE**  
**KUESTURA MBRETNORE E SHKODRËS**

Nr. 0718 i Prot. Shkodër, 11.VII.1943.XXI°-  
 Gjegje e shkrësës Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_  
 Lidhje copë \_\_\_\_\_  
 LANDA: Dom Luigj Pici Famulltar- Req- Lohe -

Drejtorisë Partizane të Policisë Mr. I  
 P. M. 22  
 Prefekturës Mbretnore  
 K e t u .

Prej kohësh kje informue kjo Zyrë se Don Luigj Pici, favorizonte strehimin e Çetës Komuniste të Gjovalin Lukës, dhe Llesh Marshit, mbi të cilin kishim disponue zhvillimin e hetimevet tue e pasë nën sorveljancë.-

Me datën 31/5 k.w. ajo Prefekturë i drejtonte shkr. Nr.221 Res. Dt. 3.5.1943.XXI°- Komandës Çarkut dhe asaj të IV. Legjionit të M.F.SH. që ishte drejtue prej Komandës Divizionit Firenze, për pas-trimin e zonës së Reçit, nga çeta Komuniste që udodhej prej ditësh atje, në të cilën shkrësë përshkruhet dhe i nëltë përmenduni Dom Luigji.-

Me dt. 6 të k.m. një repart'i Milicisë shkon në ndjekje të Çetës, n'atë Zonë dhe Dom Luigji për t'ju shpëtue ndjekjevet shkon zbrer në kët Qytet, ku mbi lajmërimin e Komandës IV. Legjionit u ndalua nga kjo Zyrë i cili u vue nën pyetje së bashku me 17 persona të tjerë të ndaluem n'atë Zoë si favorizatorë.-

Nga hetimet e zhvillueme ~~rezultuan se~~ Dom Luigj Picit, asht simpatizues i Çetave Partizane dhe nuk ka ba asnjë propagandë në popull, kundra tyre sa do që kanë qëndruar herë mbas herë n'atë Zonë, tuej mos lanë gjurmë, për ndihmën e dhanë, Dom Luigji, e për kët në mungesë të provavet konkrete, me datën e sotëshme u la i lirë mbassi nënshkruejti procesin e leçisë.-

REGJENT I KUESTURËS  
 ( M. ... )

*Shkrësë e Kuesturës Mbretërore Shkodër drejtuar Drejtorisë Policisë dhe Prefekturës Shkodër ku njofton që Dom Luigj Pici favorizon strehimin e çetave të Gjovalin Lukës e Llesh Marshit etj.*

***Një monument për tre klerikët***

Tre klerikë të nderuar secili në llogore të ndryshme por me besim se vepra e tyre ishte në dobi të Shkodrës por edhe Shqipërisë. Tre klerikë të nderuar që paradoksisht dhe duke qenë e papranueshme u vranë nga e njëjta dorë. Tre klerikë të nderuar që me vepren e tyre simbolizojnë për ne rezistencën e mbijetesën tonë në shekuj.

Shkodra u ka borxh një monument këtyre tre klerikëve të nderuar që nuk ndejtën thjeshtë në detyren kishtare, por vunë emrin e jetën në sakrificë; një monument i cili përfaqëson **REZISTENCEN E MBIJETESËN** shekullore të popullit tonë.

▪ Histori ▪

**Hamdi BUSHATI**

**LUFTA E KOPLIKUT (1920-1921)<sup>1</sup>**  
**(Kujtime)**

*Hymje*

Lufta e Koplikut asht trajtue nga historiografet tonë dhe unë nuk due të përsëris ato që janë thanë. Si pjesëmarrës i ngjarjeve të atyne muejve e pashë të arsyeshme që t'ia paraqes lexuesit kujtimet e mija e të ndonji tjetri bashkëkohës, në mënyrë që breznite e ardhshme, krahas ngjarjeve me randsi historike të njohin edhe ata persona qe kane luejte rolin e tyne të mire apo jo në këto ndodhina.

Trojet tona u kanë ngjallë gjithmone lakmite fqijve tanë e në mënyrë të veçante atyne të Veriut. Të pakënaqun nga trofetë e Luftës Ballkanike, ata u përpoqën të përfitonin nga kaosi që krijoi Lufta I Botnore. Kur po konstatohej disfata e ushtrise austro-hungareze në vitin 1918, serbo-rnalazetë u pergatitën me shti në dorë Shkodrën.

Mbasi u deshtuen përpjekjet e para u përpoqën me shfrytëzue agjenturën e tyne mbrenda Shqipnië e jashte saj. Veçanërisht aktivë ishin përkrahësit e Esat Toptanit në dispozicion të të cilëve ishin caktue subvencione të mëdha e të majme. Mbasi u dështoi tentativa me pushtue Shalën e Kelmendin, e gjithë vemendja iu kushtue Shkodrës. Mbështetës i këtyne ambicjeve sllave ishte edhe gjenerali francez Bardi

<sup>1</sup> Artikulli është botuar në revistën “*Seminari i dytë Ndërkombëtar Shkodra në Shekuj*”, vëllimi, I 1998

de Fortou, në përputhje me politikën filosllave dhe të vetë qeverisë frënge. Gjenerali freng komandonte në atë vit fuqinë ndërkombëtare, që administronin Shkodrën. Tue e parashikue largimin e afërt të ushtrive të hueja, frengu përgatiti terrenin që qytetin me ua lëshue serbëve që kishin xanë vend mbas Urës së Bunës, tue pasë nën zotnimin e tyne çka ndodhej matanë urës: jo vetëm bregun e djathtë të Bunës, por edhe të liqenit, me gjithë Taraboshin e Anën e Malit. Këtë lëvizje trupash ata e kishin realizue që në fillim të 1920-tës me qëllim që të ishin sa ma afër qytetit, kur te largoheshin trupat ndërkombëtare.

Me dinakëri e paramendim, Bardi de Fortou urdhnoi Musa Jukën, kryetar i bashkisë në atë kohë, që të përpilonte një petition të përfaqësve e të qytetit ku të kërkohej prania e ushtrisë serbe si mbajtëse e rendit dhe e qetësisë e jo si pushtuese. I pari që nuk pranoi të nënshkruente, që Sylço B. Bushati, madje edhe e grisi copë-copë.

E shohim me vend të hapim një parantezë: gjesti plot kurajo i Sylço Begut nuk qe i pari dhc i vctmi gjest i tij. Në vitin 1913, kur malazeztë patën pushtue Shkodrën, nënkryetari i bashkisë Pavli Vuçini, mbloodhi parinë e qytetit për ta binde që të firmosej një deklaratë, ku të kërkohej botnisht se dishirohej me u qeverisë nga malazeztë.

Ish nje grup filo serb (si R. Koplaku, A. L. e M. Shkreli, etj.) që nën parullën përçarëse “ma mirë me na sundue Krajl Nikolia se sa ipeshkvi i Shkodrës’ (?) përpiqeshin me ba presion psikologjik mbi pjesën e lëkundun të përfaqësuesve të mbledhun dhe me ia arrite qëllimit. Sylço Begu, që erdhi qëllimisht me vonesë, në mënyrë të preme deklaroi: Dona Shqipnina e kurrë nuk e pranojmë sundimin e Krajl Nikollës!”. Kjo deklaratë i çoi peshë të tjerët, trimnoi edhe të lëkundunit dhe në shumicë brohoritën. Salla u braktis në mënyrë demonstrative dhe mbahet mend se nga ata që pasuen Sylço Begun, pat edhe që deshën t’i puthnin duert e gjunjët në shenj mirënjohjeje. Ne fakt një qëndrim i tillë kaq krenar dhe i vendosun, në hundë të bajonetave malazeze, e pra me lloj-lloj pasojash të randa e të rrezikshme, meriton respektin e të gjithë brezave. Tue qenë e freskët jehona e ngjarjeve të masipërme, Sylço Begu kreu edhe nje hap tjetër mosnënshtrimi ndaj pushtuesit: Nuk pranoi me hjedhë firmë në telegramin që iu drejtue Krajl Nikollës nga autoritetet me rastin e Pashkwve.

Tue iu kthye temës së synimeve shoviniste të fqinjve, vemë në dukje se jugollavët nuk hoqën dorë nga kjo politike aneksioniste, pamvarëisht se patën dështime të njipasnjishme e që Shkodra ma në fund u bashkue

me shtetin amë. Për këtë qëllim shovinstët provokuen një incident të ulët kufitar: rojet kufitare jugosllave vranë 80 malësore nga Hoti e Gruda që me gra e me fëmijë po kalonin në anën shqiptare për t'iu largue këtij kufinit, persekutimit dhe dhunës. Mirëpo me anë të angjenturës së tyne, ata gënjyen një toge xhandaresh shqiptarë që reagues ndaj kësaj kasaphane dhe u vunë në ndjekje të vrasësve të huej tue kalue edhe kufinin shtetnor, çka iu krijoi preteksin fqijve me vue në veprim makinën e tyne ushtarake, që priste rastin për të kundërveprue. Formacione ushtarake jugosllave si dhe banda merceuaresh shqiptare (nën kryesine e A.L. Luk Luces, etj.) u hodhën në kundërsulm, kaluen kufinin dhe arritën deri në Kastrat.

Perflitej se edhe në rradhët e oficerëve shqiptarë, të huejt kishin rekrutue ndonjenin që me veprime adventureske të ndihmonte provokacionin, të ndërhyenin në rolin e arbitrit, qoftë edhe ushtarakisht. Nji provë e kësaj tentative qçllim keqç që edhe përpjekja që ndërmori konsulli i një shteti evropian në Shkodër për të korruptue Hamid Gjylbegun, komandant i njenit krah të forcave tona në Luftën e Koplikut. Oficeri shqiptar u ftue për një darkë plot salltanct, ku ia afruen 50 napolona ar me qëllim që t'u lihej shteg forcave shoviniste që të hynin në Shkodër, tue i krijue shtetit të huej një casus belli (shkak lufte) për ndërhyrjc ushtarakc. Hamidi jo vetëm që nuk u josh nga tundimi i florinjve por në luftën për mbrojtjen c Shkodrës u tregue edhe ma i vendosun.

Në këto çastc kritike pushteti lokal dërgoi në Tiranë Z. Z. Xhemal Bushati c Shuk Gurakuqi për të informuë qcverinë mbi situatën. Me të shpejtë në Shkodër arritën Imzot Zef Bumçi, pjestar i Këshillit të Naltë dhe Ahmet Zogu. Minister i mbrenshëm, i ngarkuem me drejtimin e përgjithëshëm të operacioneve ushtarake, tue emnue si komandant të forcave vullnetare Sylço Beg Bushatin, (që nga zv. Prefekt, pak muej ma parë e pat emnue prefekt)) si dhe Rexhep Shalën, komandant të veprimeve ushtarake të krejt frontit. Me 30 korrik në qytet u dha kushtrimi, vetë Sylço Begu doli lagje në lagje me rekrutue vullnetarë, "Nji pushkë për shtëpi".

U mbyll pazari. Si në qytet dhe në fshat, në bazë lagjesh, filloi organizimi i formacineve vullnetare dhe gatishmëria e vullnetarëve, qe e plotë dhe e menjëherëshme. Agjentura serbe, bani ç'bani, për të përhapë panik e mosbesim në masën e qytetarëve, por zanet e elernenteve të gënjyem u mbytën nga vendosmëria c përgjithme.

Edhe vete autoritetet qenë intransigjente e rigorozc në maksimum. Vetw Sylço Begu iu kërcnue me varje në litar një kushrini të tij, që shfaqti shenja hezitimi e përpjekje justifikimi.

Kështu, me 1 gusht, paradreke, u nis formacioni i parë me 500 vullnetarë nga qyteti, Me ta u bashkuen edhe malsorët e Mbishkodrës si dhe emigrantet podgoriçaj. Ushtria zuni vend përkohësisht ne Vrakë.

Edhe shtabi zuni vend në Vrakë. Përveç Sylço Begut e Rexhep Shalës në shtab ishin të pranishëm edhe Maliq Bushati, Muharrem Kazazi, Shuk Gurakuqi, Oso B. Kopliku, Can Mema. Kur shtabi u vendos, ma vonë, në një han në Çezme të Kolikut qe i pranishëm edhe majori i xhandarmarisë Malo B. Melgusha (Bushati).

Shtabi do të ndihmohej ma vonë në punën e tij edhe nga prania e A. Zogut, B. Currit, M. Krujës dhe korrierëve. Në qytet mblidheshin edhe të holla, armë e municione. Edhe gratë dhanë ndihmën e tyre: u organizuen në një shoqëni bamirëse me iniciativen e farnacistit Ndoc Ashiku dhe sillnin në front veshmbathje, cingare etj.

Ndihmë të madhe dha edhe mbrapavija: Musa Juka si kryetar Bashkije u dallue për organizimin e mirë e seioz të furnizimit të frontit me ushqime e ujë nga qyteti (me karroca). Gjithashtu shumë të rinj rmyslimanë e katolikë, tue lëvizë me bicikleta kryenin punën e korriereve. U dallue Simon Rranxi, Loro Nika, Kol Çuni, Muhamet Haxhija, Qazim Mesi etj.

Doktor Sadedini themeloi shoqatën “Hylli i Kuq” për me ndihmue të plagosunit.

Kur Ahmet Zogu erdhi pranë shtabit, u bane edhe, fotografi në Çezme të Koplikut. Kur konstatoi se ata të komandës sillnin ushqime nga shtëpia, urdhnoi që të sillej një kuzhinier dhe ata të furnizoheshin nga kuzhina e kampit.

Shtabi kishte dy sekretarë: Sait Bilalin dhe të dytë Hamdi Bushatin (i mbajton me ndërhyrjen e Hamid Gjylbegut për arsye shndetsore). Pranë Shtabit u mbajt edhe Zyhdi Baja, Elez Drishti dhe një roje, xhandari Mehmet.

Që në Vrakë rojet u ndanë në tri kolona: Krahas forcës kyesore vullnetarë që ishtc në qendër, njeni krah iu drejtue bregut të liqenit, tjetri iu mbështet rranxave Gruemirë-Grizhë. Në krye të kolonave të krahve ishin caktue dy ofcere me përvojë, Sylejman Shkodra dhe Hamid Gjylbegu. Ata të qendrës i drejtonte oficeri Taip Shkodra. Në pararojë të forcave të qendrës ishin batalioni shëtitës nën komandën



c Hasan Bushatit dhe nje kompani xhandarësh nën komandën e kapiten Ibrahim Mandiqit. Një detashment rezervë mbahej pranë shtabit.

Ne krahun e djathtë luejtën rol të ndjeshëm vullnetarët nga Rrjollit e Gruemira me Bajram Hysejnin ata të Postribws me në krye Adem Haxhinë.

Mbasi kreu nje aksion tue vra në Vrakë 3 malazezë që banin punën e informatorëve, kolona e mezit arriti po në mbramjen e datws 1 në Çezme të Koplikut.

Forcat e kolonës së qendrës ngadalësuen manovrën dhe në Koplík të Sipërm arritën me vonesë, sepse në Demiraj-Grizhë u ndalën afër Urës së Rrjollit tue dyshue në ndonjë pusi tjetër të anmikut. Pararoja e kolonës së qendrës (mesit) posa e pat pësue nga një llogaritje e gabueme e raportit të forcave, rrjedhim i informatave jo të sakta dhe e vetë besimit të tëpruar: ajo ndërmori një aksion sulmi të shpejtë tue shpresue tek elementi i befasimit, por rezultati qe krejt negativ. Në këtë rast sulmuesit tanë mbetën të rrethuem dhe krahas humbjeve në njerëz e materiale lanë rob në duert e anmikut një togë 6 vetësh me oficerin Ibrahim Mandiqin në krye (të vetmit rob gjatë krejt luftimeve).

Në javën e parë të gushtit erdhën në Shkodër 300 vullnetarë nga Kruja e Kavaja nën udhëheqjen e Mustafa Krujës dhe të Abaz Kupit. Me ta u bashkuen edhe emigrantë kosovare, që Bajram Curri i kishtë mbledhë shpejt e shpejt.

Një ndihmë të madhe jepnin aksionet e shpejta të çetave shqiptare në mbrapavija. Në këtë veprimtari u shquen vullnetarët e Hotit me në krye Deli Metën, si dhe postribasit e kosovarët, të cilët arritën nga data 10 gusht deri te Kodra e Bajrakut.

Luftimet më të mëdha u zhvilluen me datën 2 dhe 9 gusht. Gjithashtu duhet të shënohet edhe 5 shtatori, kur u vranë shumë anmiq dhe u zu rob një komandant me ma se 100 rob.

Gjatë këtyne luftimeve u shkruen faqe heroizmi e trimnie si nga qytetarët, si dhe vullnetarët matjanë, postribas, kosovarë e podgoriçaj. U shque oficeri Hamid Gjylbegaj, që në maje të kalit e pa iu trembë syni, vraponte në vijat e para të sulmit për të inkurajue trupat. Përmendet vendosmënia e çetës së Meto B. Tepes (Ahmet Bushati) në betejën rreth kodrave të Moksetit të Kastratit.

Me 17 gusht nga krahu i liqenit, në Kamicë, jugosllavët tentuen me qitë në breg: një top, dy mitraloza si dhe ushqime e bukë, por barka u kap së bashku me 5 ushtarë serbë.

Plaku Abdulla Kazazi, tue folw mbi luftën e Koplikut tregonte jo vetëm se si e bajti në shpinë Nut Balën e plagosun, ndonse shumë madhosh, vetëm e vetëm për ta shpetue nga masakrimi barbar që u rezervohej robëve nga serbët, por edhe me çfarë vetmohimi një grup vullnetarësh, ngarkue në lundra, do të kalonte ujën për t'u shkue në ndihmë vllazënve të rrethuem: plumbat e anmikut shponin lundrat me vullnetarë dhe ata nuk ruanin kokat, por, për të pengue futjen e ujit nga vrimat, vendosnin shami e ç'të gjenin në xhepa për t'i mbyllë ato.

Po kështu janë të paharrueshëm Luc Nishi e Zef Prel Martini me sa hotjanë të tjerë, që vdiqën në mënyrë herioke. Nga qyteti mbetën të vramë Ali Rexhep Spahia, Mustaf Alivodi kurse të plagosun njifen Nut Bala, Rrustem Bërdica, Rasim Gjyrezi, Mustaf Shpuza e Sheh Alja që u plagos në vetull dhe humbi synin nga një cifel predhe. Nga malcia: Can Osmani, nga Postrriba (Ura e Shtrenjtë) Zeqir Zeqja, Islam Hajdari (Lepurosh), Oso Met Beqiraj (Egerç-Rrjoll), Bisho Abdyl Sulej (Gruemirë), Sulejman Bajrami (Koplik).

Komanda i pat dhanë randësi ndërlidhjes mes reparteve e qendrës e për këtë ishte i ngarkuem oficeri rezervë Oso B. Kopliku. Problem ishte edhe rruetja e Bregut të Bunës, prandaj nën drejtimin e vullnetarëve ishte caktue Xhemal Bushati, kurse Muharrem Kazazi kontrollonte zonën e Zadrimës nga ndonji turbullim që përpiqeshin me krijue anmiqt e vendit. Në një ndeshje mbet i vramë Beqir Dedja. Raprezaljet e anmikut në zonën e pushtueme qenë të mëdha, shumë plaçkitje e djegie shtëpish. Në një letër dt. 14.09.1920 të H. Kadriut Ministër i Drejtësisë, dërgue Sylço Begut i sugjerohej komandës që të thirrej foto Marubi e të angazhohej me fotografue shtëpitë e djeguna në mënyrë që materiali të përdorej me denoncue krimet e shovinistëve para botës së qytetnueme.

Lufta pat marrë fund më 14 shkurt 1921, por të tërheq vemendjen ky fakt: midis ushtarëve serbë kishte edhe mjaft ushtarë të rekrutuem si mish për top, nga viset e aneksueme prej serbëve si nga Maqedonia, Bosnja etj. Kjo vertetohet nga një raport dërgue komandës sonë nga oficeri Sulejman Haki me dt. 12.11.1920 ku thuhet:

“ ... Dje në mëngjes, dy ushtarë, njëni prej lagjes së re të Manastirit, i quejtun Xhemal Ademi, e tjetri prej Hersekut, i quejtun Haxhi Deçiq janë ulë prej kodrës së Veleçikut e me vullnetin e tyne kanë ardhë drejtë për drejtë dhe u janë dorzue rojeve tona... Mbi Veleçik janë kund 30 vetë si pararojë... janë nën urdhnin e një kapteri, shumica janë myslimanë. Dezertorët janë shty me ikë nga mosdashja me luftue e nga uria”.

Tue e dijtë se kujtimet e atyne që moren pjesë në ngjarje e pasunojne historinë, po riprodhoj pjesë nga regjistrimi që u pata ba tri kujtimeve të tilla.

### 1. Nga kujtimet e një bashkëkohësi:<sup>3</sup>

Ishte vjeta 1920 kur Shqipnia ndodhej para një rreziku të madh, e kërcënueme prej manevrave politike të disa shqiptarve, bjerrë ndjesinash atdhetare, të bame vegla të verbta të të huejve që në ato kohna shpresojnin m 'e përmbysë e me e pjestue atdheun tonë.

Disa shqiptarë, të rrejtun mbas pares se huej, pranuen pa farë turpi me bajtë dangën e tradhëtis në ballë kinse po ngrehin qeveri në vedi, shtinë ma parë disa malësorë të Kastratit: Mirash Lucën e Lek Mirashin, Nikoll Deden me shokë me ngrehë flamurin kombëtar në shtëpi të Mirash Lucës. Me ngritjen e flamurit, çeta tradhëtare deklaroi shpalljen e një qeverie të re, u shfaq kryengritja ndaj shtetit shqiptar aktual.

Prefektuara e Shkodrës për me i dalë para kësaj çështjeje me të shpejtë

dërgoi sergjerden Man Hotin bashkë me këshilltarët e vet, krenë malesh, xhandarë nën komanden e toger Sef Serreqit dhe batalionin shetitës nën komanden e Hasan B. Bushatit.

Komisioni i Xhibalit, në vend që me lajmëruë Prefekturën e Shkodrës për çdo eventualitet, simbas urdhnit që kishte marrë, jep një vendim per me i ndjekë kryengritësit edhe tej kufinit (?!). Ky vendim dhunues u ra për shtat intrigantëve e Gjelosh Gjoka me këtë rast i nxiste emigrantët nga Hoti, Gruda e Tuzi etj. që ishte dita me u marrë hak, për krimet, serbo-malazezve dhe me shkue mbas Zef Serreqit, që kishte marrë guximin me kapërcye kufinin në ndjekje të kryengritsave, pa u ndalë deri në Srebenicë. Vetë Hasan Bushati me një xhandar qëndroi në kufi, ndërsa krejt batalioni, pa leje, kishtë ndjekë shembullin e Zef Serreqit. Prej Shkodre u nisën Maliq Sokoli dhe Oso B. Kopliku për me hetue gjendjen, dhe po sa u kthyen këta, u dërgue edhe Xhemal B. Bushati. Në Malsi mbizotnonte paniku, sepse forcat rebele të A. Lohes, Lul Lukës, Mëhill Spasit etj. së bashku me ushtarë dhe oficerë serbë, tue përfitue nga epërsia numerike dhe armatimi, kishin vue para xhandarët e shpërndamë që tërhiqeshin pa rregull. Xhemal Bushati e Maliq Sokoli sollën lajmin në Shkodër se anmiku ndodhej në Çezme-Koplik, shtëpitë e kundërshtarëve po digjeshin dhe përgatitej sulmi mbi Shkodrën.

Drejtuesit e prefekturës, Sylço B. Bushati dhe Shuk Serreqi mblodhën këshillin e administratës që përbahej nga Shaqir Gjylbegu, Maliq Sokoli, Ndrek Kiçi e Shan Deda, u lajmërua edhe Tirana dhe u mblodhë paria e qytetit. Ndërkohë ia mbërritën në Prefekturë tre krenë me të vërtetë patriotë: Bajram Hyseni, Adem Haxhija e Dul Grizhja. Ata shprehën sigurinë se Malcia s’do të rrinte duerkryq, sikur në ballë të luftës të dilnin Sylço Begu me shokë. Sylço Begu iu dha fjalën dhe çështja u bisedue gjatë e gjatë në mbledhjen e madhe që u zhvillue në sallonin e Prefekturës me përfaqësuesit e dy besimeve. Pat edhe hezitime për veprime luftarake tue mbiçmue forcat anmike; disa si Tef Curani qenë të rëndimit, të shfrytëzoheshin rrugët diplomatike mbasi konsulli jugosllav kishte kërkue tri ditë afat, por fitoi pala e vijës së fortë e propozueme nga Sylço Begu e Ahmet Zogu”.

## 2. Nga dëshmia e Rrustem Bërdicës

(Pjesmarrës në Luftën e Koplikut. Shënimet janë të datës 12.7.1967).

Në Vukpalaj të Kastratit kena kenë dy mehallë: Perash e Parrucë, dy Rusët (Rusi Madh e Rus i Vogël-H.B.) dhe disa podgoriçaj me në krye Bajram Gramshin - kund 180 pushkë, ishin me ne Luigj Rasku (kapiten), Sait Rraboshta e Sadik Lacja. Komita ishte përqëndrua në shtëpinë e Dedush Marashit, në katudin Vukpalaj, dhe kishte rrethue nja 14 hotjanë: një nuse ere prej asaj shtëpije u bani za hotjanëve të rrethuem: “Qindroni burra, se iu erdhi ndihmë Shkodra!”, Atëherë shkjetë e vranë. Me ne që ishim ngulë në Aliaj të Kastratit, ishin edhe Dr.Sheldija, Hile Jaku me shokë etj. Kodrën e mësyen nja 10 vetë: Sheh Alja, Taip Gavoci, Jonuz Hamzi, Sabri Bushati, Sulja i Abdulla Agës. Halil Beqi prej Tuzit etj. Na gjuajtën me top prej Nenhelmit: prej një copë u plagos në vetull Sheh Alja. Në gjysë të natës na kemi ba një mësymje: Nut Bala u plagos dhe e shpëtoi Abdulla Kazazi, që e bajti në shpindë, i ndihmuem edhe prej meje e Pjetër Gjeloshit. sepse Nuti ishte i madh me trup dhe i shtriheshin kambët për tokë. Një natë përpara ishte plagosun Rasim Gjyrezi, kurse unë u plagosa rrugës.

Në Suka të Moksetit ishin posttribsit: këtu mbët i vrame i nipi i H. Ahmet Dervishit, u plagos Asllan Bajrami nga Ura e Shtrenjtë, Ymer Beqiri nga Boksi, Hasan Ahmeti vetë i trete prej një shtëpije. Prej Hotit mbeti i vramë Luc Nishi vet’ i njimbëdhjetë. Kanë kenë edhe disa podgoriçaj. Me vullnelarët ishin edhe tre djelmët e Shuk Serreqil: Gjoni. Luigji e Zefi”.

### 3. Nga dëshmia e ish oficerit Asim Kopluku

“Ibrahim Mandiqi u zu rob me Sul Çukën. Salë Krajen etj., por u liruen mbas një mueji. Thuhet se i ka ra shputë A. Lohja. Nga sulmi mbi sukat e Moksetit janë plagosë: Nut Bala, Sheh Alja, Rrustem Bërdica, Mustaf Shpuza. Një posttribasi i kishte mbetë djali i vramë e nuk e çoi djalin e vramë në shtëpi për të mos u shkëputë nga shokët.

### REFERENCA

- 1) Materiali u redaktua nga Nexhmi Bushati.
- 2) Në kapitullin që flet për mbrojtjen e Shkodrës (1912-1913), asht çekë kundërshtimi i Sylço Begut, që i pat ba Esat Toptanit, kur ky i fundit kishte vendosë dorëzimin e qytetit me preteksin e mbarimit të rezervave ushqimore.
- 3) Bashkekohesit nuk i lexohet emni (N.B.)

▪ **Histori arsimit** ▪

**Nikollë LOKA**

**HAPJA E INTERNATIT “MIRDITA” NË OROSH  
SI NEVOJË E KOHËS**

Për shkak të veçorive të saj politike dhe shoqërore, treva e Mirditës ishte gjatë pushtimit osman shumë e prapambetur. Shteti shqiptar kishte marrë përsipër themelimin e arsimit kombëtar e laik në të gjitha trevat e vendit. Më problematike ishte gjendja në trevat malore, si Mirdita, ku përqindja e analfabetizmit ishte më e lartë. Atje, për shkak të varfërisë, kushteve të vështira të jetesës etj., kishte pengesa në hapjen e shkollave, por edhe në rastet kur ato hapeshin, kishin paqëndrueshmëri dhe pothuajse asnjë prej tyre nuk kishte arritur të nxirrte nxënës që e kishin mbaruar ciklin e plotë të arsimit fillor. Në ato kushte, si alternativa më e mirë për të përgatitur një grup djemsh të arsimuar për çdo fshat u pa internati (shkollë me konvikt) i cili do të mblidhte nxënës nga të gjitha fshatrat e krahinës.

***Lënia e Mirditës jashtë rrjedhës së zhvillimeve social-ekonomike***

Mirdita erdhi deri në Kongresin e Lushnjës me tregues të ulët në arsim. Krahas faktorëve objektivë të prapambetjes arsimore, që ishin: izolimi i gjatë, varfëria e tejskajshme ekonomike, terreni i thyer malor, mungesa e rrugëve dhe urave, në prapambetje ndikuan edhe faktorët subjektivë. Mungesa e përpjekjeve për integrimin në shtet ishte njëri nga faktorët që e la Mirditën jashtë proceseve zhvilluese në

vend. Për shkak të vështirësive, vetë shteti hoqi dorë për disa kohë nga detyrimet që kishte ndaj trevave malore. Edhe mungesa e një qendre urbane, ku të vendosej administrata, të hapej një shkollë qendrore e të punonin bashkë një grup njerëzish të shkolluar e la Mirditën pa një model zhvillimi brenda saj.

Në vitin 1924 Abati i Mirditës, Imzot Zef Gjonali, ndër faktorët që pengonin zhvillimet arsimore përmend largësinë e madhe të lagjeve dhe katundeve nga njëri-tjetri, çobaninë që e ndiqnin fëmijët, pasi mbushnin moshën shtatë vjeç kur fillonte shkolla dhe mungesën e kuptimit të vlerës praktike të arsimit për jetën, që shprehej me mungesat e shumta nga orët e mësimi (AQSH, F.368, V.1924, D.2, f.1). Në perceptimin negativ të krijuar për shkollën kishte ndikuar dhe mungesa e përfitimit ekonomik. Në ato kushte, mirditasi i thjeshtë dhe analfabet mendonte se fëmija i tij kishte nevojë për shkollë aq sa të lexonte dhe të shkruante ndonjë letër, apo të kryente llogaritje të thjeshta aritmetike.

Edhe Inspektoria e Arsimit në Shkodër i kërkon Ministrisë së Arsimit hapjen e shkollave: “Në qoftë se hapja e internatit në Orosh vonon, të hapen edhe disa shkolla të tjera në atë rajon, ku nevoja për arsim është e madhe, për me mujt me shpëtue nga errësira ku ndodhet atë popull“ (Prendi, 2014: 44).

### ***Hapja e Internatit “Mirdita” si zgjidhja më e mirë për shkollimin në Mirditë***

Si rezultat i ngjalljes së interesit për arsimim, mirditasit, të pakënaqur me gjendjen, iu drejtuan shtetit me kërkesën që të hapen shkolla dhe protestuan në mënyrë të organizuar, kur u mbyllën disa shkolla që më parë kishin funksionuar. Të vetëdijshëm për vështirësitë nëpër të cilat po kalonte vendi, përgjithësisht banorët e fshatrave kishin marrë vetë përsipër sigurimin e bazës materiale të shkollës, nganjëherë dhe të rrogës së mësuesit (Gogaj, 1972: 3). Përballë kërkesave të vazhdueshme të banorëve për hapjen e shkollave, Kongresi i Parë Arsimor vendosi që në treva malore të ngrihen internate të shkollave fillore. (Historia e arsimit, 2003: 381). Në internate, ku bëhej jetë e organizuar, synohej t’u jepej djemve edukim moral, intelektual e fizik, që të formoheshin si qytetarë të virtytshëm, të dijshëm dhe të shëndoshë (Kazazi, 2014: 125). Ata dilnin nga mjedisi i ngushtë i fshatit të tyre, mësoheshin me jetën kolektive, zhvillonin frymën e solidaritetit dhe të tolerancës, mësonin kulturën e vetëshërbimit dhe të disiplinës.

Numri i shkollave në Mirditë ishte i vogël dhe në ndryshim nga shumica e nënprefekturave të tjera në vend, numri i shkollave në vitin 1920 ishte më i vogël se në prag të pavarësisë. Zhvillimin normal të arsimit e pengonte gjendja tepër e vështirë ekonomike, largësia e shtëpive nga njëra tjetra, terreni i thyer malor, lokalet shkollore të papërshtatshme, mungesa e mësuesve vendës dhe mungesa e kushteve të jetesës për mësuesit e ardhur. Këto vështirësi i njihte patrioti Luigj Gurakuqi, i cili që në vitin 1918 i kishte kërkuar administratës austro-hungareze ngritjen e një internati në Mirditë, me nxënës nga të gjitha zonat e saj. Ngritja e internatit u pa si mundësi për t'u dhënë arsim të plotë fillor disa fëmijëve nga të gjithë fshatrat.

Qeveria shqiptare, pas vitit 1920 e shyrtoi alternativën e ngritjes së disa internateve në vend, përmes të cilave do të realizonte politika sociale në ndihmë të trevave në nevojë. Vendet ku do të ngriheshin internatet konsideroheshin edhe si qendra të përshtatshme administrative. Internatet që po ngriheshin në qendrat e prefekturave dhe nënprefekturave u shtonin këtyre qendrave një shkollë sipas kërkesave të kohës, mbledhnin së bashku disa intelektualë dhe shërbenin si qendra arsimore dhe kulturore (AQSH, F.295, V.1926, D.1, f.121). Po kështu, në internate do të shkonin shpesh prindërit e fëmijëve dhe ata do të përfitonin diçka në pikëpamje të jetës shoqërore. (AQSH, F.295, V.1926, D.1, f.122).

Nga propozimi, planifikimi dhe deri te ngritja e internatit të Oroshit në Mirditë kaluan disa vite. Realizimi i projektit ndeshi në vështirësi për shkak të mungesës së lokaleve mësimore dhe të kushteve për mësuesit. Hapjen e internatit e kishte kërkuar edhe kleri katolik vendës. Me 7 korrik të vitit 1924 Ipeshkëv-Abati i Mirditës, Imzot Zef Gjonali kërkoj hapjen e një internati në Mirditë "...në vend të disa shkolla në disa vendbanime të Mirditës, të ngrihet një konvikt, në të cilin të merrnin dije një numër fëmijësh prej komunave të kësaj nënprefekturë". Sipas tij "edhe konvikti kërkonte shpenzime, por jo më shumë se në rastin kur do të ngriheshin disa shkolla, të cilat llogariten, të paktën në 22 për të zhdukur në njëfarë mase analfabetizmin në Krahinë". Por po të ngriheshin shkollat sipas modelit të atyre ekzistuese, "rezultati do të ishte thujse zero, pse a kishin me përparue nja 30 fëmijë, sa kishte me përparue ma i paafti në një konvikt me pak klasa". (AQSH, F.368, viti 1924, D2, f.1).

Atë ditë që mori letrën e Imzot Gjonalit, Inspektoria e Arsimit në



Shkodër i kërkoi Ministrisë së Arsimit hapjen e një internati në Mirditë (AQSH, F.358, D.2, viti 1924, fl.1), por Ministria e Arsimit, për mungesë buxheti, e parashikoi internatin për vitin e ardhshëm shkollor (Prendi, 2014: 47-48), kështu që mbeti të hapej në vitin shkollor 1925-1926.

Megjithëse qendra e Nënprefekturës nuk ishte në Orosh, ky fshat ishte vendi ku jetonin krerët më të rëndësishëm dhe drejtuesit e klerit vendës, prandaj me të drejtë vazhdoi të konsiderohet “de facto” si qendra e Mirditës, edhe pse qeveria e kishte vendosur qendrën administrative në vendbanime të tjera.

Hapja e internatit në Orosh e la Repsin, qendrën e Nënprefekturës, pa shkollë, duke krijuar një mangësi në projektet për urbanizimin e tij. Por shteti, më shumë se për perspektivën e një qendre administrative, po mendonte për të zgjidhur problemet e ngutshme të integritit të Mirditës në shtet, ku shkollimi do të luante një rol të veçantë (Loka, 2021:110).

Me hapjen e internatit, u realizua zbutja e analfabetizmit, megjithëse fare pak nga nxënësit mundën të vazhdojnë shkollimin më tej, pasi nuk i patën mundësitë ekonomike dhe shteti nuk zbatoi politika të diferencuara me bursat e studimit për shkollat e mesme që do të favorizonin trevat e prapambetura, megjithëse administrata e Nënprefekturës, komunave dhe mësuesit e shkollave ishin pothuajse të gjithë nga rrethet e tjera. (Loka, 2021:110).

Internati ishte e vetmja shkollë me klasa të veçanta në Mirditë, por dhe shkolla e vetme që siguronte kushte normale për atë kohë, megjithëse dhe ai pati problemet e veta. Mësuesit vinin nga jashtë trevës dhe u ndërruan shpesh. Sapo një mësues fillonte punën, mendonte për transferimin. Në Internat, gjatë gjithë funksionimit të tij nuk pati asnjë mësues vendës. Nuk u bënë përpjekje për t’i përgatitur në shkolla normale nxënësit që kishin përfunduar internatin me rezultate të larta dhe normalistët e paktë mirditas, nuk u emëruan në internat dhe vetëm disa prej tyre punuan në shkollat e tjera në Mirditë. Nga ana tjetër, pothuajse asnjë nga ata që kishin përfunduar vetëm internatin nuk u përfshi në sistemin e arsimit para vitit 1945, ndërkohë që mësues me arsimin fillor kishte kudo në vend (Loka, 2021:111).

Internati ishte e vetmja shkollë në Mirditë me vijimësi pandërprerje nga viti 1925 deri në vitin 1942, si dhe e vetmja shkollë me klasa të veçanta, ku përgjithësisht jepte mësim një mësues në një klasë dhe për të pesë klasat kishte katër ose pesë mësues. Internati kishte kushte shumë

më të mira se kushtet familjare të fëmijëve. Krahasuar me jetën në familje, jeta në internat ngjante si një oaz kulture dhe qytetarie, jashtë vrazhdësisë së jetës në male.

Ndonëse ishte njëra ndër shkollat më të mira në vend, internati i Oroshit u përdor vetëm për të përgatitur kontingjente nxënësish që dinë të lexojnë e të shkruajnë dhe të kenë disa shprehje praktike për jetën, të cilat do t'i zbatonin në punët bujqësore dhe blegtorale dhe në mënyrën e tyre të jetesës. Internati i Oroshit nuk u pa në funksion të formimit të shtresës së kuadrove që i duheshin Mirditës.

### **Burimet dhe literatura**

AQSH, F.295, viti 1926, D.1.

AQSH, F.358, viti 1924, D.2.

AQSH, F.368, viti 1924, D.2.

Gogaj, Iljaz(1972).Aspekte të arsimit në Shqipëri në vitet 1912-1939. Revista Pedagogjike, Nr.3, maj-qershor.

Kazazi, Njazi(2014). Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër (nga fillimet e tij deri në vitet '20 të shekullit XIX). Shkodër, botimet "Rozafat".

Loka, Nikollë (2021). Veçori të zhvillimit të Arsimit në Mirditë (disertacion), Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Prendi, S. (2014). Historia e Arsimit dhe shkollës shqipe në Mirditë, Tiranë, botimet "ihpvka&okult".

**Bora LOGU**

**NJË PJESË HISTORIE E RËNDËSISHME NË FILLIMET  
E SHKOLLËS SHQIPE NË SHKODËR**

*- Në nderim të mësueses Kushe Micja, dokumentuar mjeshtërisht  
prej penës së z. Tomë Gjyshja -*

Shkurt 2022. Në Bibliotekën e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, bibliotekarja e pasionuar me librin, me dijen, e punën e përkushtuar, zj. Olimpia Kakarriqi, më ofron papra materiale për të më ndihmuar në punën kërkimore që kam në dorë. Në mes periodikëve, më tërheq vëmendjen revista “SHKODRA”, organ i përkohshëm i Shtëpisë së Kulturës dhe i Krijimtarisë Popullore.

Filloj e shfletoj me andje revistën “Shkodra”. Më pëlqen çdo artikull që lexoj. Shqipja është shkruar bukur prej autorëve. Diku në mes andjes e kureshtjes, ndalem fort në artikullin e z. Tomë Gjyshja, me titull “Qendra mësimore e Kushë Mices në Shkodër gusht 1859”. Më rrëmben gjuha e përpunuar, stili i zhdërvjelltë, por edhe informacioni për mua krejt i ri: shkolla e parë laike në qytetin tim, e themeluar, e drejtuar prej së përndriturës mësuese Kushe Micja.

E falenderoj me zemër, e me sytë kah qielli, mësues z. Tomë Gjyshen! Me një frymë vendosa me bashkënda në kujtim e nderim të figurave të spikatura në fushë të arsimit e të dijes këta rreshta.

Në artikullin e z. T. Gjyshes kushtuar figurës së mësuese Kushe Mices mëson për faqe të ndritura, e figura thuejse aspak të njohura në historinë e shkollës e kulturës shqiptare.

Mësues T. Gjyshja me thjeshtësi, saktësi e ndershmëri njerëzore e intelektuale, duke dashur të nxjerrë në dritë bukur e mirë vlerën e kësaj shkolle, edhe deri më sot thuhet e panjohur, në mes tjerash shkruante: "... Mos të mendojë kush se shkolla e Kushe Mices u quejt shkollë për të mbledhë pak nxanës sa me kalue kohën, për të mësue disa shkronja sa me njohtë alfabetin, për të bubrrue ndopak punë-dore sa me zbavitë vajzat. Të flasësh për mësuese Kushe Micja do të thotë të njihesh me një vajzë të kulturueme që karrierën e mësuesisë e filloi në moshën 27 vjeçare dhe që për vullnet të popullit të Shkodrës dhe me iniciativën e tij, hapi të parën shkollë shqipe në Shkodër me qëllim që të ngrejë çetën femnore në lamin e arësimit e të kulturës. Nën parullën: KURRGJA PËR VEHTE DHE GJITHÇKA PËR TË TJERËT- ajo mblodhi për 45 vjet me radhë vajza nga shtesa të vorfna të popullit, ua zhvilloi mendjen, ua edukoi shqisat, ua praroi duart." ( T. Gjyshja, "Qendra mësimore e Kushë Mices në Shkodër gusht 1859", "Shkodra", nr.1, 1961, fq. 193).

### ***Kush ishte mësuese Kushe Micja?***

Nga pena e T. Gjyshes mësojmë, se Kusha u lind më 16 qeshor 1832. Fisi i saj qe dukagjinas, ardhë në Shkodër për shkak gjaqesh. I ati quhej Mic Jaku. Kusha pati edhe një vëlla, Ndreka Micin, i cili e ndihmoi shumë të motrën në çështje administrative. Kusha mori mësimet e formim për 10 vjet rresht te Shjor Markja, farmacist venecian, ardhë në Shkodër për arsye politike. Ndër ata vite, në Shkodër, ky zotëri merrej me profesionin e tij, por edhe me mësimet me pagesë në disa familje. Kushe Micja mori mësimet e rregullta, duke mësuar në mes tjerash gjuhën frënge e italiane. Në mes tjerash, Gjyshja shkruante për mësuese K. Micja: "... Trashigues vetitë bujare të fisit të vet, bashkoi me to edhe kulturën e gjanë që muer si nxanëse shkolle. E fortë fizikisht, e hieshme në fytyrë, e naltë me shtat, me një sjellje shembullore dhe e paisun me një inteligjencë të mprehtë, populli i Shkodrës shikonte tek ajo, mësuesen e ardhëshme të fëmijëve të tij." ( Po aty, fq. 194)

Kushe Micja punoi mësuese deri në moshën 72 vjeçare. Ajo kaloi në amshim, më 3 mars 1913, duke lënë pas një model të spikatur të mësueses shembullore, të atdhedashëses e të njeriut të mirëformuar me vlera të posaçme shpirtërore, karakteristika këto fort të vyeshme, por mjerisht fort të dëmtuara prej stuhive të motmoteve ra ndër ne, duke shkaktuar dëme sot e gjithë ditën në tharmin tonë njerëzor.

### ***Si ishte e organizuar shkolla e Kushe Mices?***

Shkolla ishte vendosë në shtëpinë e Kushe Mices. Një shtëpi dykatëshe në rrugëzën (kjo fjalë është përdorë nga autori Gjyshja-shënimi im B.L.) Vasijej, në lagjen Serreq. Ashtu sikurse e nënvizuar

në hyrje, artikulli i Gjyshes meriton të vlerësohet edhe për organizimin gjuhësor. Bie në sy struktura morfo-sintaksore e mirëmenduar e fjalive dhe e paragrafëve, si dhe një fjalor i pasur. Ndërtesa ku nisi veprimtarinë shkolla e K. Mices, nuk ekziston, sepse pas një shekulli e gjysmë, në maj të vitit 1961, e shembën për rregullim të planit të qytetit. Shtëpia kishte një oborr me lule, një kopsht me pemë frutore e parcela të vogla mbjellë me perime e zarzavate, në funksion të punës mësimore e edukative, që zhvillohej në shkollë. Sa mjeshtërisht në pikëpamje arkitekturore, por edhe didaktike na jepet mjedisi i shkollës. T. Gjyshja shkruante: "... dritaret zbkuroheshin me saksi karafilash e falsigenash, lule këto të njohuna e të përhapuna në Shkodër për erën e tyne të kandëshme." (Po aty, fq. 195). Më poshtë thuhet: "... orenditë e shkollës ishin të pakëta e të thjeshta. Mësuesja kishte për vehte tryezë e karrigë, ndërsa nxënëset përdorshin banka të gjata me një dërrasë pështetëse mbrapa..."

Në këtë shkollë mësonin mbi 50 nxënëse të moshës 9-14 vjeç. Dita shkollore ishte organizuar me orarin e paradites 8.00-12.00, e mbasdite dita vazhdonte me mësimin e këngës e të punës së dorës.

Lëndët mësimore ishin: 1) Shkrim; 2) Këndim; 3) Numratorë; 4) Vizatim; 5) Kangë; 6) Punë-dore.

Një karakteristikë tjetër e penës së Gjyshes është përshkrimi i kujdesëm i përmbajtjes lëndore të secilës disiplinë, duke u ndalë në detaje të metodologjisë e strategjisë së përdorur prej mësuese K. Mices. Po japim të plotë sipas autorit, disa prej disiplinave, si p.sh:

*"Shkrimi: Si metodë pune me shkrim, Kusha e ndau mësimin në tri faza:*

*Faza e parë: Njohja e shkronjave t'alfabetit veç e veç që nga fillimi e deri në fund, shkrimi i tyre me bojë. Mbas shkrimit të çdo shkronje bahej edhe leximi i saj. Shkronjat i kishte nda në grupe dhe mbas çdo grupi bante përsëritjen e tyne.*

*Faza e dytë: Bashkimi i shkronjave dhe formim fjalësh. Për këtë përdorej metoda e vjetër e të mësuemit. be+a=ba, etj....*

*Faza e tretë: Formim fjalishë dhe diktim vjershe me karakter fetar të cilat ma vonë mësoheshin përmendësh.*

*II. Këndimi: Edhe këndimi u përmbahej tri fazave të shkrimit:*

- 1. Këndimi i çdo shkronje veç e veç*
- 2. Këndimi i fjalëve të formueme në mësimin e shkrimit*
- 3. Këndimi i fjalive e i diktiveve..." ( Po aty, fq.195).*

Është e vyeshme të nënvizojmë, se në të dhënat didaktike të metodologjisë së ndjekur prej mësuese Kushe Mices, autori përshkruan edhe tekstet që përdorshin, si dhe veçoritë fonetike e fonologjike të alfabetit, me të cilin punohej në lëndët shkrim e këndim. Duke ndjekur

hapat e organizmit të mësimit shkrim e këndim vërehet përpikmëria didaktike e mjeshtëria e mësueses në procesin udhërrëfyes të të nxënit, si dhe bashkërendimi ndërlëndor në disiplina të tilla, si: shkrimi, këndimi e mësim besimi.

Përmbajtja lëndore e viteve të largëta, kur daton kjo shkollë e përgjatë viteve që ka zhvilluar veprimtarinë e saj, përbën një model korrekt të mësimit të gjuhës amtare në historinë e shkollës shqiptare.

Modeli i shkollës së Kushe Mices në Shkodër është përshkruar me të gjitha hollësitë për të gjitha lëndët mësimore të ekspozuara, duke i dhënë një vend të veçantë edukimit të nxënësve me shprehitë e duhura kulturore, shpirtërore e qytetëse.

Shkolla e Kushe Mices e puna e saj vetëmohuese përbën një model në historinë kombëtare të shkollës shqipe. Model që na vjen falë mendjes e penës së mësuesit, z. Tomë Gjyshja. Sot e gjithë ditën modele mësuesish e shkollash të tilla bëjnë dritë në rrugën fort të vështirë, nëpër të cilën ka ecë shkolla shqiptare, historia jonë ende e panjohur thellë, e pashkruar qartë, e pambarështruar me kritere të pastra shkencore në të gjitha fushat e dijes e posaçërisht në lëmin e shkencave humane e filologjike.

**Dieleta PERLLESHI,**  
**Ermira ALIJA**

**INDOKTRINIMI I ARSIMIT GJATË REGJIMIT KOMUNIST.  
 TEKSTET E LEXIMIT TË TETËVJEÇARES (1964-1986)  
 NË FUNKSION TË EDUKIMIT POLITIK TË NXËNËSVE**

Duke qenë se një rol të rëndësishëm në formësimin e njeriut ka shkolla dhe arti, ato u përdorën fuqimisht në periudhën e sistemit komunist në Shqipëri. Shqipëria ishte vend monopartiak dhe shkolla shihej si vegël e partisë, në funksion të ndërtimit të socializmit: *Partia këshillon vazhdimisht që i madh e i vogël të venë në shkollë, të mësojnë. Në sajë të kujdesit të partisë shkolla në vendin tonë është bërë si jetë e dytë për njerëzit, si ushqim i përditshëm... Ky është një sukses i madh për partinë, e cila i ka hapur perspektiva të gjera popullit dhe e ka bindur atë se pa dituri, pa mësim... nuk mund të ndërtohet socializmi, prandaj shkollat janë përhapur në të katër anët e vendit<sup>1</sup> .*

Edukimi shkollor barazohej me edukimin komunist e socialist dhe shikohej si proces politik, i udhëhequr nga Partia. Edhe mësuesi shihej si mjet për këtë qëllim: *Partia nuk do t'ju qortojë, po do t'ju lavdërojë po të bëni një punë metodike marksiste-leniniste, përkundrazi do t'ju heqi veshin, në qoftë se do të ketë çfaqje anarshie në zbatimin e programit, dmth tendencë të ecet nga secili sipas qejfit në zbatimin e programit shkollor<sup>2</sup> ...*

<sup>1</sup> “Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë” (Fjalime dhe referate) SHBLSH, Tiranë, 1969, fq.7.

<sup>2</sup> Po aty. fq. 16.

Po kështu edhe koncepti i letërsisë, shikohej si shërbim social dhe jo si trill, jo si art me pavarësinë e vet. Në FGJSSH, 1980 letërsia shpjegohej, si: *Një ndër format e ndërgjegjes shoqërore, lloji i artit që e pasqyron jetën nëpërmjet figurave artistike të krijuara me anën e fjalës, duke shprehur një qëndrim ideor dhe emocional të caktuar.*<sup>3</sup> Duke e trajtuar letërsinë si “një ndër format e ndërgjegjes shoqërore”, bëhej përpjekje për ta përdorur ndikimin e saj mbi shoqërinë, bile mbi këtë ndikim përcaktohej edhe *vendi i letërsisë.*<sup>4</sup> Metafizika e letërsisë si art, që ... *herë-herë e ka marrë frymëzimin nga fushat e tjera artistike, si skulptura, piktura madje edhe muzika...*<sup>5</sup>, ose ... *si ndërtuese dhe shkatërruese e idealizmit*<sup>6</sup>, nuk merrej në konsideratë.

Ky trajtim tërësisht sociologjik i letërsisë e jo vetëm përdorej edhe në shkollë në funksion të edukimit.

Nuk është e vështirë sot që në të gjitha këto këndvështrime, të vihet re deformimi i disa të vërtetave dhe raporteve që qëndrojnë në themel të shikimit të njeriut, të atributëve mendore e psiqike që e përbëjnë atë, si dhe të raportit të tij me shoqërinë.

Në kohën e sotme tipet e organizmit të orës së mësimi bëhen mbi bazën e qëllimeve didaktike, që në ndryshim nga qëllimet propagandistike, *synojnë rritjen e rendimentit e të cilësisë së procesit mësimor; ... forcimin e rolit të mësuesit si organizator e drejtues ... rritjen e rolit të nxënësit si palë në këtë proces.*<sup>7</sup>

Pavarësisht se udhëzimet e sotme për kurrikulën, për elasticitetin e saj në raport me programin shprehin të kundërtën e programimit të ngushtë të sistemit komunist, ne kemi vëzhguar mënyrën se si janë funksionalizuar politikisht tekstet e detyrueshme shkollore. Kjo analizë mendojmë se është e vlefshme për çdo kohë, pasi shoqëria është në një proces demokratizimi të përhershëm dhe raportet me tekstet e leximit mbartin në vetvete gjithmonë një lloj “rrezik indoktrinimi”.

<sup>3</sup> “Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe”. Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë 1980, fq. 986.

<sup>4</sup> Wellek. René; Warren. Austin, “Teoria e letërsisë”. ShB Onufri, Tiranë, 2007, fq. 95

<sup>5</sup> Po aty. Fq.126

<sup>6</sup> Alija. Ermira. “Letërsia shqipe si metafizikë dhe transhendencë”. Sh. B. Naimi, Tiranë, 2018, fq. 280.

<sup>7</sup> Dibra, Gëzim; Taipi. Mirjam; Halluni, Eranda. “Mësuesi dhe mësimdhënia” ShB Vllamasi, fq. 96



Kemi shqyrtuar konvencionalisht botimet e viteve: 1964-1986. Kemi shqyrtuar tekstet e këndimeve, leximeve të arsimit 8-vjeçar, që përbënin qasjen e detyrueshme shkollore që u ofrohej fëmijëve deri në periudhën e adoleshencës. Por, duke e pasur të pamundur të analizojm tërësinë e të gjitha pjesëve të leximeve, për arsye sasiore, i kemi referuar temës së drejtpërdrejtë politike. Kjo, edhe për arsyen tjetër se, edhe po të analizojm librin e leximit të një klase të caktuar, nuk do të mund të përshkruajm ndikimin e shkollës, vetëm nëpërmjet një klase. Po të merrnim librat e gjithë klasave, materiali do të ishte shumë i gjerë dhe do të përpunohej me vështirsi, pasi do të na nxirrte në pah një tërësi të madhe problematikash. Për këtë arsye kemi reduktuar vetëm në temat e mirëfillta politike<sup>8</sup>, të shtrira përgjatë gjithë teksteve të leximit të 8-vjeçares.

Gjatë shqyrtimit të teksteve të leximit të arsimit fillor (nga klasa I deri në klasën IV), kemi vënë re se:

- Pjesët me përmbajtje politike janë didaktike, kryesisht të krijuara nga autorët e teksteve, por ka një përqindje të vogël të tyre, të shkruar edhe nga shkrimtarë, si për shembull: Kadare, Dritëro Agolli, Nasho Jorgaqi, Bedri Dedja, Andrea Varfi etj..
- Një pjesë e krijimeve kanë objekt të drejtpërdrejtë Enver Hoxhën. Kulturi i tij në të është aq i fuqishëm, sa Partia nuk shihet si grupim, ku kryetari mund të ndërrohet, por identifikohet me të. Shkrimet për Enver Hoxhën e idealizojnë atë, aq sa ka poezi që e lidhin pazgjidhshmërisht edhe me atdheun.
- Ka tekste ku kulturi i Enver Hoxhës rritet tërthorazi, pasi del si autor, si shkrimtar.
- Në krijimet që i kushtohen Partisë, heroi lirik që paraqitet në këto pjesë është ai që dashurinë më të madhe në jetë ka Partinë. Partia shihet si gjëja më e shtrenjtë dhe vendoset edhe mbi marrëdhëniet e ngushta familjare. Asosacionet intime: nënë-fëmijë paralelizohen ose zëvendësohen me Parti-nënë. Nxirret në pah ideja se për çdo gjë njeriu i detyrohet Partisë e cila identifikohet me udhëheqësin e saj.
- Shumë tema e objekte politizohen:

Tek “Viti i ri shkollor”, nuk urohet për një vit të mbarë, por urohet Partia.

Festa e punëtorëve humbet objektin historik dhe lidhet me Partinë dhe Enverin.

<sup>8</sup> Me tema të mirëfillta politike kemi parasysh përmendjen e hapur të simboleve politike të kohës.

Figura e Qemal Stafës lidhet me ndjenjën e sakrificimit për Partinë. Ideali i njeriut bëhet sakrificimi deri në vdekje për Partinë.

Quhet një gjë normale mohimi i të drejtës individuale të pronës, mbasi Partia konsiderohet pronarja, mbartësja dhe menaxhuesja më e mirë e mundshme e çdo pasurie.

- Në tematikat sociale, si në poezinë me titull “Pas tërmetit”, nuk i kushtohet rëndësi ndjenjave individuale të humbjes së njeriut të dashur, apo detajeve të tjera të ngjashme; objekt i shkrimeve bëhet vetëm optimizmi dhe besimi te Partia dhe udhëheqësi.

Gjatë leximit të teksteve të leximit të arsimit të mesëm të ulët (nga klasa V deri në klasën VIII), kemi vënë re se:

- Edhe në tekstet e leximit të ciklit të Ciklit të Mesëm të Ulët, temat e ideologjizuara të pranishme domosdoshmërisht vazhdojnë të mbeten: tema e Partisë dhe e Enverit
- Fillon të zërë vend gjithnjë e më të madh edhe proza me temë politike.
- Partia vazhdon të paraqitet si burim i të gjitha llojeve të të mirave (bashkimit, energjisë elektrike, ndryshimeve ...). Ajo paraqitet si një mekanizëm që nuk gabon kurrë dhe së cilës i duhet besuar gjithmonë pa mëdyshje.
- Masa e lumturisë së personazheve matet me shërbimin ndaj Partisë.
- Idealizimi i Enver Hoxhës vazhdon të bëhet me lëvdata të panumërta, duke e paraqitur si ndikues në ngjarje të ndryshme dhe duke e konsideruar si bekim për të gjitha të mirat.
- Puna e mirë identifikohet vetëm me ndërtimin socialist me në krye Partinë.
- Ka një tendencë që vjen në rritje te leximet e shkollës së mesme të ulët, për të pasur gjithnjë e më shumë shkrimtarë, si: Adelina Mamaqi, Shevqet Musaraj, Nasho Jorgaqi, Lllazar Siliqi, Dhimitër Shuteriqi, Dritëro Agolli, Andrea Varfi, Aleks Luarasi, Ismail Kadare, Petro Marko etj., mundësisht me temën politike. Kjo shoqëron tendencën për të zgjedhur më me kujdes krijimet propogandistike, për të zvogëluar notat e hapura retorike e patetike dhe për t’i zëvendësuar me detaje jetësore në shërbim të idesë politike.
- Mendimet e veçanta të personit apo bota e brendshme e tij nuk përbënin objekt shkrimesh, përveç diktimeve të Partisë.
- Edhe fenomene të caktuara, si: rregulla të kanunit, apo të zakoneve

të dikurshme të jetesës dogmatizoheshin dhe shikoheshin bardh e zi, në funksion të naltimit të Partisë.

Nga vëzhgimi dhe analiza e të gjitha teksteve ne vëmë re se kemi:  
-shpërpjesëtim mes standardeve të jashtme dhe të brendshme të individit;

-vendosjen e standardeve të rreme;

-presione të jashtme shumë të fuqishme dhe aspak aksidentale, por të menduara mirë.

Nuk është e vështirë të kuptohet presioni ideologjik i teksteve të tilla mbi formimin e njeriut. Ne i kemi vëzhguar për të përshkruar dhe analizuar standardet shoqërore dhe psikologjike të tyre. Dihet se duke vendosur standarde të manipuluar dhe duke i idealizuar vazhdueshëm ata si elementet e të vetmit ideal të bukur e pa asnjë tjetër alternativë, mundësia e ndikimit të lexuesit është shumë e madhe, duke pasur parasysh se presioni i madh i standardeve të jashtme injoron nevojën për të matur veten nga brenda.

Të gjitha këto, kanë prishur shumë elemente psikologjike e sociale që qëndrojnë në themel të ndërtimit të njeriut dhe të elementeve të vetëperceptimit, qoftë: të konceptit për veten, të njohjes së vetes, të përvojës së vetes (si përvojë e jashtme dhe e brendshme), të vlerësimit të vetes e kështu me radhë. Kjo gjë ka shkatërruar njeriun, në emër të ndërtimit, duke e larguar atë nga biologjikja dhe e vërteta.

Me këtë shpjegohet fakti që një pjesë e mirë e njerëzve që qanë për Enver Hoxhën, shkuan ta rrëzojnë atë. Ndodhi sepse njerëzit njohën standardet e rreme të vendosura mbi ato të vërtetat. Kjo është diçka që del më lehtë në pah, po strukturat e vetvetes të formatuara e rrënjosura me vite a mund të rindërtohen aq lehtë? Jo, sigurisht që jo. Ato, së bashku me problemet që sjell çdo kohë e re, vazhdojnë me siguri të kontribuojnë në një pjesë të problemeve të mëdha që reflekton shoqëria shqiptare edhe sot.

▪ Letërsi ▪

**Xhuljana GURI**

**POEZI**

**Xhuliana Guri** është studente në vitin e parë të programit të studimit Bachelor në Gjuhë-Letërsi në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Ka marrë pjesë në konkurse të ndryshme letrare, ku në vitin 2020 është vlerësuar edhe me çmimin e parë për shkollat e mesme. Gjatë kohës së lirë i pëlqen që krahas leximit dhe krijimtarisë letrare të merret dhe me sportin, kryesisht me volejbollin, i cili ka qenë dhe vazhdon të jetë një ndër pasionet e saj. Përsa i përket jetës së përditshme ajo bën një jetë mjaft aktive, pasi merret me aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe fetare. Në këtë cikël me poezi janë shqetësimet, ëndrrat, sinqeriteti dhe bota e një poeteje të re që sapo ka hyrë në rrugën e gjatë dhe të bukur të poezisë.

**Mosmirënjohës**

Ndër duart e botës u rrite,  
nga djersa e të tjerëve u shtrua rruga jote,  
duke shkelur mbi shumë gjëra majën arrite,  
arrite majën e cila do të verbonte.

Harrove rrugën nga ku kalove,  
harrove çdo mund e sakrificë.  
Preke atje ku dikur veç ëndërrove,  
e pluhur i hodhe rrugëtimit tënd,  
pluhur me shumicë...

Tani e vogël të duket çdo gjë nga ajo “majë”,  
pamja prej triumfatori të ka droguar.  
Për ty nuk di njeriu a duhet të qesh apo të qajë,  
teksa të sheh me këtë zemrën e re, të ngurtësuar.

Nuk të bie shkëlqimi nëse me sy na shikon,  
nuk të kushton asgjë me gojë të na flasësh.  
Sado të arrish, për dikë ke nevojë gjithmonë,  
përtej çdo stuhie të kesh një degë ku të mbahesh.

Tani po eksploron qiellin, por tokën mos harro,  
Çdo gjë rrotullohet, nuk i dihet botës...  
Në qofsh i zoti, edhe universin sundo,  
Por, mos ji mosmirënjohës!...

### **Peng i zgjedhjeve të tua**

Kisha frikë nga dështimi,  
e u ndala pa bërë asgjë.  
Ruhesha nga zhgënjimi  
nga vetja ia mbathja gjithnjë.

I trembesha humbjes dikur,  
e fitoren dot s’e provova.  
Brenda vetes ngrita një mur,  
përmes të cilit dot s’depërtova.

Arritjet e të tjerëve admiroja,  
të atyre që nuk u ndalën, por guxuan.  
Ndërsa unë te aftësitë e mia dyshoja,  
e kështu fjalët e mosbesimi më dënuan.

Tani i heshtur me veten analizoj,  
 e di mirë se ku gabova.  
 Frika ime rëndë më kushtoi,  
 Mund t'ia dilja, por s'rrezikova.

### **E pandryshuar**

Gjeta dritë në ngrehinën e errësirës,  
 gëzim në rrënjët e trishtimit.  
 Pashë mirësi në zemër të smirës,  
 hare në plagët e mjerimit.

Kishte buzëqeshje në pikë të lotit,  
 Një univers të tërë në zbrazëti.  
 Gjeta zjarr që mbulonte të ftohtit,  
 Dhe besim në angështi.

Preka shpresën në mes të dëshpërimit,  
 Paqen në luftën e mendjes.  
 Çeli buzëqeshja në hije të pikëllimit,  
 Dashuria në prangat e urrejtjes.

Nga varret e dhimbjes nxitimthi kalova,  
 kishte akoma jetë, jetë në plogështi.  
 Copëzat e vrerit të njeriut shikova,  
 Në to kishte një të përzier ndjesi.

Takova të bukurën në radhët e neverisë,  
 ëmbëlsi të strehuar në hidhërim.  
 Gjeta njeriun në kthetrat e tiranisë,  
 përbindëshi që krijuam preku shpirtin tim.

Në arkivat e harruara ku unë u zhyta,  
 Gjeta shumëçka njeriun për të kuptuar.  
 Për një çast mendova se u mbyta,  
 Por brenda njeriut, njeriu s'qenka shuar.

### **E dashur mike**

Zgjodha që njerëzit pranë vetes t'i afroja,  
ndër vite m'u bënë miq, gjoja miqtë e mi.  
Me zemër unë i desha e i respektoja,  
ama miqësia që besoja, ishte thjeshtë fantazi.

U zhgënjeva, edhe pse zemra në heshtje i kalonte,  
Thoshte: "Duhet t'i pranoj siç ata janë."  
Mendja e shkretë fliste, por zemra s'pranonte,  
e pasojat një nga një mbi mua ranë.

I shihja të gjitha, të gjitha i kuptoja,  
ama hakmarrjen nuk e pashë kurrë si zgjidhje.  
Ndaj dyert që mbylleshin rrija e vështroja,  
thjeshtë shqyrtoja veprimet e tyre pa lidhje.

Më qeshin e përqafojnë, por nuk janë të sinqertë,  
çdo veprim që bëjnë të sforcuar e kanë.  
E ata që i desha si miq, si miq të vërtetë  
shumë poshtë para syve të mi sot ranë.

U mërzita nga ikja e tyre, dot s'e mohoj,  
ama për vete gjeta dhe një ngushëllim.  
Ndonëse me kujtimet e mbetura rri e vajtoj,  
Unë humba kohë për ata që s'i kisha që në fillim.

Me ikjet e shumta dhe në botën plot mendime,  
vetëm ti e dashur qëndrove, nuk ike.  
Renda ngado, por s'u tradhëtova nga vetja ime,  
Më qëndroi pranë si më e shtrenjta mike.

### **Kroi i jetës**

Lëndë e pastër, e kulluar,  
jelek shpëtimi për njerinë.  
Ilaç për shpirtin e robëruar,  
finesë që vesh vetë mrekullinë.

Në ty si lumë vërshon dashuria,  
lumturia nuk është thjesht emër.  
Në ty muzikant bëhet vetë qetësia,  
gëzimi të ofrohet me gjithë zemër.

Ngadalë-ngadalë paqja rrëshqet,  
kapur për dore me harmoninë.  
Këtu bashkëqeveriset e nuk ka mbret,  
por, të gjithë bashkohen me mirësinë.

Në ty inatit e smirës u bie vlera,  
e shoqja xhelozit zbehet ngadalë.  
Në zemër të dimrit lulëzon pranvera,  
e zeza vishet me të bardhë.

Virtytet e veset se bashku rrinë,  
flasin e qeshin pa e tepruar.  
Të dyja janë për njerinë,  
ujë për njeriun që etjen do shuar.

Është në dorën tënde të zgjedhësh burimin,  
të rendesh drejt së mirës apo së keqes.  
Sado i lodhur mos bëj me faj rrugëtimin,  
ka dhe për ty ujë te kroi i jetës.

### **Jetë e skllavëruar**

Vjedhurazi dielli rrëshqet mbi botën e errësuar,  
me rrezet e tij nuk di se çfarë të mbulojë.  
E ka humbur shkëlqimin në shpirtin e egërsuar,  
ndonëse në gërmadha kërkon të depërtojë.

Në këtë realitet dielli u ftoh keq, i tëri ngriu,  
në fushë tani u sul bora si e tërbuar,  
Papastërtitë dot në vete nuk i përpiu,  
iku dhe ajo e lodhur nga kjo, e shkatërruar.



U ngrit era me inatin veshur,  
me vete fryu e shfryu sa kishte fuqi.  
Në botën dikur të hareshme e të qeshur  
tashmë sulmon pa kursyer asnji...

E lodhur retë mblodhi lart në qiell,  
e papritur filloi të binte shi litar.  
Por, e keqja ngado ishte mbjellë,  
as uji s'arriti «shpirtin» për t'ia marrë.

E në mes të këtij kaosi ku natyra u dorëzua,  
njeriu i mjerë, vuan sa me fjalë nuk thuhet.  
Eh, kur të çmendurit të drejtojnë iu besua,  
me jetën e njerëzve lehtë *kumar* do luhet.

### **Përqaqim.**

I brishtë e i sinqertë,  
i ëmbël si një fëmijë.  
Veshje për një dashuri të zbehtë,  
edhe akullnajat arrin t'i shkrijë.

I ftohtë që brenda vetes digjet,  
largësi pa distancë.  
Mall që si indiferent hiqet,  
aktorë të dobët në performancë.

Në të vërtetë i qetë si vetë paqja,  
aromë prindi që ty të vesh.  
Në mes të ferrit parajsa,  
lotit t'i buzëqesh.

Të mbështjell me gjithë emocione,  
lumturi apo i gjallë trishtim.  
Të fortë a në dobësi mbesim po ne,  
E ai i shtrenjti thjeshtë përqaqim.

### **Dimër shpirti**

U bë kaq ftohtë sa dhe fryma u ngurtësua,  
 Jeta po përpëlitet nën akull e ngricë.  
 Edhe rrezet e diellit u ftohën në mua,  
 Në sytë e tyre dukeshin si një shoqe llasticë.

Kristal u bë e bukura fytyrë ylber,  
 fortesa e saj u bë copë e çikë.  
 Zemra sikur ishte shtruar në mermer,  
 ndërkohë që mendja kishte fituar pikë.

E ndieja sesi qenia ime kishte ngrirë,  
 ndonëse nga temperatura po digjem.  
 Shpirti i tharë si kufomë rri shtrirë,  
 në këtë faqe të re, ku me veten zihem e piqem.

E bota në anën tjetër me të madhe qesh,  
 edhe një tjetër pranë vetes tërhoqi.  
 Është e lumtur në këtë furtunë e rrebesh,  
 e lumtur që edhe një pranverë tjetër dogji.

E në mua akulli vazhdon shtresëzimin,  
 ashtu sikurse në maje malesh dëbora.  
 E penduar unë vuaj dënimin,  
 E lodhur për vdekje nga rruga që mora.

Heshtur, në filxhanin me çaj lotët më rrëshqiten,  
 për një çast shkëmbyem vendet pa e ditur se si.  
 Teksa çajin përzieja mendimet peshë u ngritën,  
 Çaji plus sheqeri, baraz njeri.

### **Ngeca**

Në mashtrimet e miqve unë ngeca brenda,  
 u mashtrova nga përqafimet plot tradhëti.  
 Të vërtetën t'ia pranoja vetes s' ma kishte ënda,  
 por, e pashë se s' mund të kisha besim te ju, te ti.

Gabova dikur, jo se të vërtetën s'e kuptoja,  
Desha të besoja se edhe ju jeni si unë.  
Por, u lodha e kështu më s'mund të vazhdoja,  
për të gjetur miq të vërtetë paskam punë.

E binda veten të mos ju urrej, s'do marr hak,  
shumëfytyrësinë tuaj do e vesh me mirësi,  
Do e marrë secili atë që meriton pa merak,  
do sillem aq mirë, sa nga vetja, t'ju vijë neveri.

### **Ujë në shkretëtirë**

Hapa që rëndojnë në pluhurin e vetmisë,  
në territorin ku era të përllanë.  
I tretur tutje, në labirintet e njerëzisë,  
ushqim për egërsirat, që veç duan të hanë.

I lodhur nga të panjohurat dhe pse-të e shumta,  
me peshën e rëndë që shpatullat t'i dërrmoi.  
Hije e ambienteve e çasteve të zymta,  
Inekzistencë në ekzistencën që rëndë të kushtoi.

Gjakosur nga kurthet e rrugëtimit tënd,  
ftohur keq nga shumëfytyrësia.  
Në çdo hap që hedh së pari kalon me mend,  
duke studiuar rastet që të dhuroi pabesia.

Duke rënkuar i mbytur në strehën e harresës,  
shpresën për një mik të vërtet ti mban.  
I përhumbur zhytesh në detin e pendesës,  
Se uji i shkretëtirës etjen dot s'ta thanë.

## Fajtoje pa faj

Fajtoje për ligësinë që strehohet në zemër,  
fajtoje për moralin e gënjeshtërt.  
Fajtoje që dashuria sot është thjeshtë një emër,  
në rrugët e drejta ku ecet shtrembër.

Me faj se s'ka paqe e harmoni,  
me faj që sot lulëzojnë lotët e tradhëtia.  
Për të pandehurën botë kërkohet drejtësi,  
E akuzuar me fajet që ka njerëzia.

Ç'faj ka bota o njeri? Ç'faj ka?  
Bota s'është njeri, bota jemi ne.  
Për çdo gjemb që në përbërje të saj ka,  
s'është faji i saj, e kurrë i tillë nuk qe.

Për çdo mbeturinë botën bëjmë me faj,  
gishtin e drejtojmë drejt saj pa hezitim.  
Është më e lehtë për ne prandaj,  
s'mund t'ia pranojmë vetes që ky ishte faji im.

Ndaj përpara se të akuzosh, ktheju vetes,  
Aty do të zbulosh atë që ti ke frikë,  
Mjaft u bëre kritik i botës, kritik i jetës.  
Bota do ish më e bukur në *universin* autokritikë.

## Më merr malli

Më merr malli për kohën e shkuar,  
kur mendoja e jetoja si fëmijë.  
Më merr malli për lodrat që kam shkatërruar,  
ato dikur ishin shokët e mi.

Më merr malli për shtëpinë e vjetër që kishim,  
aty ku kisha hedhur hapat e mia të para.  
Më merr malli për ëndrrat prej fëmije që ishin,  
sado të çuditshme mbeten të papara.

Më merr malli për kopshtin me lulet erëmira,  
në të cilin luanim për orë të tëra.  
Më merr malli për fushat e gjëra,  
sidomos në kohën kur trokiste pranvera.

Më merr malli për atë parajsë,  
ku linda dhe u rrita me dashuri...

### **Hije dyshimi**

Një ndjesi e çuditshme më kish kapluar zemrën,  
në mes të mjegullës mendja u gjet e dorëzuar.  
Ashtu e hutuar s'po arrinte të analizonte gjendjen,  
arsyeja që mbytur e sytë ishin verbuar.

Në mes të mjegullës ku ujku humb gjurmët,  
po luftoja të gjeja kuptimin e gjithë kësaj.  
Për një çast duhet të lëvizeshin gjithë gurët,  
nën rrënoja dëgjohej zëri i një shpirti të pafaj.

Kishte shumë zëra, shumë pikëpyetje,  
goditje që s'kuptohej se nga vinin për tek ty.  
Një veprim i çastit shkaktoi përmbytje,  
e vërteta po më bezdiste si kripa në sy.

Diçka si pa kuptuar nga brenda po më gërryente,  
asgjëja dhe gjithçkaja me mua po luanin hapur.  
Edhe pse përfundimi e dija se s'do më pëlqente,  
një shpresë gjysmë e vdekur në mua që kapur.

Sa qetësohesha paniku më mbërthente nga fyti,  
s'duhej të ishte e gjitha kjo e vërtetë.  
Dyshimi në heshtje mendjen e zemrën m'i mbyti,  
Dhe pyetja: "Po sikur vërtetë kështu të jetë?"

▪ Projekti “Nxitja e talenteve tek të vegjlit”<sup>1</sup> ▪

**POEZI**

**Ebril Brahimi**

*Gjyshja ime*

Gjyshja ime e dashur  
Sa fort që të dua  
Ti me dashuri  
Më ke rritur mua.

Ti më ke mësuar  
Dhe më edukon  
Dora jote e butë  
Gjithmonë më ledhaton.

**Xhesa Haxhija**

*Për mësuesen time*

Këto vargje të thjeshta  
Ty mësuese ti kushtoj  
Zemra më dridhet  
Tani që po i recitoj.

---

<sup>1</sup> Projekti “Nxitja e talenteve tek të vegjlit” realizua nga Biblioteka “Marin Barleti” në kuadrin e nismës “Të shkruajmë për fëmijë”, miratuar në programin e Bashkisë Shkodër për vitin 2021. Lektorja e projektit Elinda Dibra Ramadani, përzgjedhi poezitë e krijuara nga fëmijët pjesëmarrës të cilat po i botojmë në këtë numur të revistës “Gegnia”.

Të flasësh për ty  
Nuk është e lehtë  
Se ti je prind i dytë  
Dhe i vërtet.

Ditën e parë kur të takova  
Unë shumë u gëzova  
Ti mësuesja ime e parë  
Gjithmonë do të kujtoj me mall.

Shumë vite do të kalojnë  
Unë ty do të kujtoj  
Dhe nga zemra ime  
Kurrë nuk do largoj.

## **Elsida Çobaj**

### *Një buqetë për mamin*

Një tufë me lule  
E mblodha sot  
Mamit të dashur  
T’ia dhuroj.

Sot me 8 Mars  
Ty ta dhuroj  
E shtrenjta ime  
Dhe të uroj.

Qofsh e lumtur  
Mami im  
Nga zemra ime  
Del ky urim.

▪ Arkiv ▪

**Filip KRAJA** (1857-1933)

**NJI BA-MIRS I HARRUEM**

Në të gjith boten asht gadi e njoftue si një detyr shejte ajo qi me nderue te dekunit e me i permend t'mirat qi të ken ba. Per ato qi lân shkaike ankimesh, thohet se “para te dekunit hetit çdo e keqe anmike”.

